



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1993/9 prot

Datë 03.08.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 937/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                |            |
|----------------|------------|
| Ismail Shehu   | Kryetar    |
| Gjergj Mersini | Nënkryetar |
| Edvin Simo     | Anëtar     |
| Nertil Kanina  | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 03.08.2026 shqyrtoi kërkesën me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “SoLed” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE për secilin lot), Mallra”, me nr. REF-89789-06-11-2026, me objekt: “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme dhe kirurgjikale për nevoja spitalore” e ndarë në dy lote”, me fond limit 2,723,256,110.67 (dy miliardë e shtatëqind e njëzet e tre milionë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dhjetë presje gjashtëdhjetë e shtatë lekë) lekë pa tvsh ose 28,650,774.44 (njëzet e tetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër presje dyzet e katër) euro pa TVSH, “LOT 2 - Blerje materiale mjekimi konsumi kirurgjikale MM2”, me nr. REF-89793-06-11-2026 me fond limit 1,316,642,915.80 (një miliardë e treqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë nëntëqind e pesëmbëdhjetë presje tetëdhjetë lekë) lekë pa tvsh ose 13,852,108.53 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetë presje pesëdhjetë e tre) euro pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar në datën 13.07.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të mësipërme

**Ankimues:** Operatori ekonomik “SoLed” SHPK me NIPT M42026032D dhe adresë: Kompleksi Lake View, Rruga Kristo Luarasi, Godina B, Kati 4, Hyrja B03, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.  
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraparak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12.06.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE për secilin lot), Mallra”, me nr. REF-89789-06-11-2026, me objekt: “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme dhe kirurgjikale për nevoja spitalore” e ndarë në dy lote”, me fond limit 2,723,256,110.67 (dy miliardë e shtatëqind e njëzet e tre milionë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dhjetë presje gjashtëdhjetë e shtatë lekë) lekë pa tvsh lekë pa TVSH ose 28,650,774.44 (njëzet e tetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër presje dyzet e katër) euro pa TVSH, “LOT 2 - Blerje materiale mjekimi konsumi kirurgjikale MM2”, me nr. REF-89793-06-11-2026 me fond limit 1,316,642,915.80 (një miliardë e treqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë nëntëqind e pesëmbëdhjetë presje tetëdhjetë lekë) lekë pa tvsh ose 13,852,108.53 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetë presje pesëdhjetë e tre) euro pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar në datën 13.07.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

II.2. Në datën 22.06.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6858; dhe me nr. 1993 prot., datë 22.06.2026 e operatorit ekonomik “SoLed” SHPK me anë të së cilës ka kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi si më poshtë:

*[.....] Në dokumentat e tenderit është përcaktuar:*

*2.6 Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:*

*Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e përzgjedhjes:*

1. *Lidhur me prokurimin e këtij objekti, janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të marrëveshjes kuadër të tilla si artikujt, specifikimet e sakta teknike, kushtet e rëndësishme levrimit si dhe sasitë e pritshme të mallrave të kërkuara.*

2. *Duke qenë se në kete marrëveshje Kuader përfaqësohen shumë autoritete kontraktore, për arsye teknike dhe organizative, levrimit nga operatore të ndryshëm ekonomike nuk do të ishte i favorshëm, pasi jo vetëm mund të shoqërohej me vështirësi për mosperputhjen e artikujve që funksionojnë sistematikisht, por shoqërohet edhe me kosto shtesë dhe vonesa të furnizimit, për kryerjen e procedurave të minikonkurimit nga AK, pa e kësaj MK.*

3. *Ndryshimi i OE në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE për secilin lot (pra rrjedhimisht ku jo të gjitha kushtet do të ishin të përcaktuara) do të shkaktonte kosto shtesë, pasiguri dhe konfuzion për OE të suksesshëm, gjë që do të shoqërohej me rritjen e afateve të*

*levrimit. Lidhja e MK me një OE, do të shoqërohej me mireorganizimin e këtij të fundit për sigurimin e mallrave në kohe, sigurimin e një rezerve dhe furnizimin në kohën e kërkuar nga AK. Gjithashtu siguria për kontratat që parashikohet të lidhen i jep mundësi OE të ulë kostot e ofertes.*

4. Organi Qendror Blerës është në gjendje të krijojë një ide të plotë dhe të saktë mbi të gjitha transaksionet që kryhen në bazë të MK-së, si dhe vështirësine për të komunikuar dhe për të monitoruar autoritetet kontraktore të përfshira që do të bënin thirrjet potenciale për kontratat individuale. Ekziston gjithashtu risku sa i takon organizimit kompleks të MK-ve që njohuria mbi mënyrën se si funksionon sistemi i MK dhe procedurat e thirrjeve për kontrata individuale do të mbeteshin të paqarta për shumë autoritete kontraktore periferike.

5. Nga eksperiencat e mëparshme të prokurimit të këtij objekti, ka rezultuar se numri i OE lokal pjesëmarrës ka qenë i kufizuar dhe për këtë arsye me qëllim hapjen e konkurrencës është përdorur procedura e hapur mbi kufirin e lartë monetar.

6. Duke qenë se Shqipëria është një treg i vogël dhe mallrat objekt i MK janë mallra importi pra nuk ka prodhim vendas (me përjashtim të shumë pak artikujve), me qëllim garantimin e furnizimeve në afatet kohore të përcaktuara për secilin AK përfitues si dhe duke marrë në konsideratë numrin e madh të këtyre të fundit, MK me një OE të vetëm fitues për secilin lot do të garantonte sigurinë e furnizimeve sipas kushteve të përcaktuara dhe brenda afateve të kërkuara duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratave dhe të nevojave të AK.

Nga analiza e dokumenteve të tenderit rezulton se Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka bashkuar në një procedurë të vetme nevojat e 34 spitaleve dhe institucioneve të ndryshme shëndetësore publike për një periudhë 24-mujore, me vlerë mbi 1.3 miliardë lekë pa TVSH vetëm për lotin MM2. Kjo qasje përbën një ndryshim të rëndësishëm nga praktika e viteve të fundit, ku furnizimet janë zhvilluar në nivel spitali ose në procedura të ndara, duke krijuar mundësi reale pjesëmarrjeje për një numër më të madh operatorësh ekonomikë.

Autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë analizë ekonomike apo studim tregu që të justifikojë përse nevojat e 34 institucioneve me profile, volume dhe kërkesa të ndryshme duhet të bashkohen në një procedurë të vetme.

Vetë dokumentet e tenderit tregojnë se nevojat e spitaleve janë të ndryshme dhe të identifikuar individualisht, pasi fondet janë llogaritur veçmas për secilin institucion përfitues. Në këto kushte, ndarja e procedurës sipas spitaleve ose sipas grupeve funksionale të spitaleve është jo vetëm e mundur teknikisht, por edhe më në përputhje me parimin e konkurrencës efektive.

Ligji nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik detyron autoritetet kontraktore të respektojnë parimet e konkurrencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe përdorimit efektiv të fondeve publike. Struktura aktuale e procedurës prodhon efekt të kundërt, pasi rrit artificialisht prapenësin ekonomik dhe financiar të pjesëmarrjes dhe përjashton operatorë që kanë kapacitet të furnizojnë një ose disa spitale, por jo të gjithë sistemin spitalor kombëtar.

Në dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor justifikon zgjedhjen e një operatori të vetëm fitues për secilin lot me arsye organizative dhe teknike. Megjithatë, nuk jepet asnjë analizë konkrete që provon se furnizimi nga disa operatorë ekonomikë do të krijonte probleme reale, ndërkohë që për vite me radhë procedurat janë zhvilluar në mënyrë të fragmentuar sipas institucioneve pa u evidentuar një problematikë e tillë.

Veçanërisht shqetësues është fakti se autoriteti kontraktor pranon vetë në dokumentet e tenderit se në eksperiencat e mëparshme numri i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës ka qenë i kufizuar. Në këto kushte, masa që logjikisht do të rriste konkurrencën do të ishte ndarja e mëtejshme e procedurës në lote më të vogla dhe jo bashkimi i nevojave të 34 institucioneve në një procedurë të vetme me vlerë shumë të lartë.

Për pasojë, lind dyshimi i arsyeshëm se struktura aktuale e tenderit nuk është projektuar për të zgjeruar pjesëmarrjen në treg, por ka efektin praktik të kufizimit të konkurrencës duke favorizuar operatorët ekonomikë me pozicion dominues dhe me histori të gjatë pjesëmarrjeje në këto procedura, konkretisht bashkimin e operatorëve ekonomikë “O.E.S Distrimed” shpk dhe “Euromed” shpk, të cilët janë dhe fituesit e paracaktuar.

Në mungesë të një arsytimi të plotë, proporcional dhe të dokumentuar për mosndarjen e procedurës sipas spitaleve, kërkojmë rishikimin e dokumenteve të tenderit dhe ristrukturimi i procedurës në lote të veçanta sipas institucioneve përfituese, me qëllim garantimin e konkurrencës reale dhe përdorimin më efikas të fondeve publike

Kërkojmë të ndahet sic ka qenë, e ndarë në spitale. Pasi dhe sasi të janë të ndryshme nga spitali në spital. Nuk është normale që nga një produkt që mund të kërkohet vetëm nga Qsut, të bllokosh të gjithë spitalet e tjera të vogla sic janë Përmeti, Skrapari, Puka, Tepelena e shumë e shumë të tjerë. Për sa i përket shprehjes së AK “Nga eksperiencat e mëparshme të prokurimit të këtij objekti, ka rezultuar se numri i OE lokal pjesëmarrës ka qenë i kufizuar dhe për këtë arsye me qëllim hapjen e konkurrencës është përdorur procedura e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, nga analiza e zhvillimeve të tregut dhe mënyrës së ndryshimit të sjelljes së kërkesës, konstatohet se situata nuk është në përputhje me pretendimin për nevojë të thjeshtë teknike, por paraqet një dinamikë të kundërt konkurruese.

Në momentin kur në treg u shfaq konkurrencë reale dhe operatorë alternative (shoqëria jonë) filluan të ofrojnë produkte dhe shërbime të krahasueshme, duke sjellë si pasojë humbjen e pozicionit dominues të operatorit që më parë kishte akses të konsoliduar në zonën e Korçës, pra Spitalit Rajonal Korçë, kërkesat teknike dhe konfigurimi i specifikimeve u formësuan në mënyrë të tillë që ngushtojnë sërish hapësirën e konkurrencës.

Në këtë kontekst, vlerësojmë se ndryshimet në specifikime nuk janë neutrale nga pikëpamja e tregut, por kanë efekt praktik në rishpërndarjen e aksesit në treg, duke e orientuar atë drejt një strukture të mbyllur dhe aspak konkurruese. Kjo sjellje krijon përshtypjen se qëllimi funksional i specifikimeve nuk është thjesht garantimi i performancës teknike, por edhe konsolidimi i mëtejshëm i një pozicioni të favorshëm tregu, në dëm të konkurrencës së lirë dhe pjesëmarrjes së operatorëve të tjerë ekonomikë.

Si rezultat, këto specifikime kanë efekt kufizues në konkurrencë dhe kontribuojnë në forcimin e një strukture të ngjashme me monopol ose dominim të përqendruar tregu, duke reduktuar mundësinë e ofertimit të gjerë dhe të barabartë nga operatorët e tjerë ekonomikë. Për sa më sipër, kërkojmë:

1. Shfuqizimin e përcaktimit të pikës 2.6 të Dokumenteve të Tenderit, në pjesën që parashikon lidhjen e marrëveshjes kuadër me një operator të vetëm ekonomik për secilin lot.
2. Rishikimin e strukturës së procedurës së prokurimit dhe ndarjen e saj sipas institucioneve përfituese ose sipas grupeve funksionale të spitaleve, në përputhje me nevojat reale të secilit autoritet kontraktor.
3. Parashikimin e mundësisë së lidhjes së marrëveshjeve kuadër me më shumë se një operator ekonomik ose zhvillimin e procedurave të veçanta sipas spitaleve, me qëllim garantimin e pjesëmarrjes sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë dhe përdorimin më efikas të fondeve publike.

Në dokumentat e tenderit është përcaktuar:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po      X      Jo      ?

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera për pikën 1 (furnizimet e mëparshme të ngjashme) dhe pikën 6 (licencë / autorizimit për tregtim të pajisjeve mjekësore) të seksionit 2.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim të kërkuara në DT.

Ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera për pikat si më sipër, pasi përvoja e mëparshme për të zbatuar kontratën dhe disponimi i licencës / autorizimit për tregtim të pajisjeve mjekësore, vlerësohen si kapacitete të lidhura ngushtë me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme e të nevojshme për të krijuar bindjen te AK se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standardeve të kërkuara.

Kundërshtojmë përcaktimin e pikës 2.16 të Dokumenteve të Tenderit, sipas së cilës ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera për përmbushjen e kriterit mbi furnizimet e mëparshme të ngjashme dhe për disponimin e licencës/autorizimit për tregtim të pajisjeve mjekësore.

Ky kufizim është i pajustifikuar, joproporcional dhe në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pasi ngushton më tej mundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në një procedurë e cila tashmë është strukturuar në përmasa jashtëzakonisht të mëdha përmes bashkimit të nevojave të 34 institucioneve shëndetësore në një lot të vetëm.

Vetë legjislati i prokurimit publik parashikon mundësinë që operatorët ekonomikë të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera për të provuar përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, me qëllim rritjen e konkurrencës dhe zgjerimin e aksesit në procedurat publike. Kufizimi i kësaj të drejte përbën përjashtim dhe si i tillë duhet të mbështetet në një analizë konkrete, të detajuar dhe të dokumentuar nga autoriteti kontraktor, e cila mungon plotësisht në këtë rast.

Arsyetimi i paraqitur nga autoriteti kontraktor është i përgjithshëm dhe deklarativ. AK mjaftohet duke pohuar se përvoja e mëparshme dhe disponimi i licencës/autorizimit janë të lidhura ngushtë me shoqërinë dhe konsiderohen të rëndësishme për zbatimin e kontratës, pa shpjeguar konkretisht përse mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera do të çenonte ekzekutimin e kontratës apo interesin publik.

Për më tepër, duke pasur parasysh se procedura është përqendruar në një kontratë me vlerë shumë të lartë, që mbulon furnizimet për të gjithë sistemin spitalor publik, ndalimi i mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera ka efekt të drejtpërdrejtë në eliminimin e operatorëve ekonomikë që disponojnë kapacitete reale furnizimi, por që për shkak të dimensionit artificialisht të fryrë të procedurës nuk plotësojnë individualisht kriteret e përvojës së kërkuar.

Veçanërisht i pajustifikuar është ndalimi për licencën/autorizimin e tregtimit të pajisjeve mjekësore. Në praktikën tregtare dhe në procedurat e prokurimit publik, operatorët ekonomikë bashkëpunojnë rregullisht me prodhues, distributorë të autorizuar ose subjekte të tjera të licencuara, të cilat marrin përsipër detyrime konkrete për furnizimin dhe mbështetjen e kontratës. Përjashtimi kategorik i kësaj mundësie kufizon pa arsye konkurrencën dhe favorizon një numër të kufizuar operatorësh ekonomikë që zotërojnë drejtpërdrejt të gjitha autorizimet e kërkuara.

Në kushtet kur autoriteti kontraktor ka pranuar vetë se numri i operatorëve pjesëmarrës në procedurat e mëparshme ka qenë i kufizuar, vendosja e një ndalimi shtesë për mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera përbën një masë që redukton edhe më tej konkurrencën, në vend që ta nxisë atë.

Për pasojë, ekziston dyshimi i arsyeshëm se ky përcaktim nuk është vendosur për të garantuar ekzekutimin e kontratës, por ka efektin praktik të kufizimit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë dhe favorizimit të operatorëve të mëdhenj që historikisht kanë dominuar këto procedura, siç janë BOE “O.E.S Distrimed” shpk dhe “Euromed” shpk për lotin 2 dhe BOE tjetër për lotin 1. Janë të vetmit OE në Republikën e Shqipërisë që plotësojnë

kontratat e ngjashme për këtë procedurë prokurimi (lehtësisht e verifikueshme), për këtë arsye tenderi është i paracaktuar. Kërkojmë heqjen e kufizimit të parashikuar në pikën 2.16 të Dokumenteve të Tenderit dhe lejimin e operatorëve ekonomikë që, në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, duke garantuar kështu konkurrencë më të gjerë, trajtim të barabartë dhe përdorim më efikas të fondeve publike.

Në dokumentat e tenderit është përcaktuar:

7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: Marrëveshje kuadër me afat 24 (njëzet e katër) muaj nga nënshkrimi.

Përveç:

1- QSUT e cila do të ketë afatet e lëvrimit: 24 muaj nga nënshkrimi i MK. AK do të lidhë kontratë sipas nevojave, për çdo kontratë të lidhur brenda MK, afati i lëvrimit do të jetë:

o 5 % e sasisë së mallit për secilin material duhet të lëvrohen brenda 20 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

o Pjesa e sasisë së mbetur duhet të lëvrohet deri në përfundim të kontratës dhe sipas kërkesave të shërbimeve.

2- Q.S.R.T “Shefqet Ndroqi” do të lidhë kontratë në bazë të nevojave të saj në çdo 4 muaj. Përjashtimisht këtij përcaktimi, autoriteti kontraktor mund të lidhë kontrata për çdo nevojë që del e parashikuar dhe është e domosdoshme në çdo kohë. Për çdokontratë të lidhur brenda marrëveshjes kuadër, afatet e lëvrimit do të jenë si më poshtë:

o 20% e vlerës totale të kontratës duhet të lëvrohet brenda 20 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

o Pjesa e mbetur e sasisë duhet të lëvrohet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

3- SUOGJ2 (Glozheni), Spitali Devoll dhe Spitali Rajonal Durrës: Afatet e lëvrimit të mallit do të jenë sipas kërkesës dhe nevojave të AK përfitues.

4- Spitali Rajonal Elbasan

Për arsye të krijimit të një sigurie në lëvrimin e mallit pa krijuar vonesa dhe mbulimin në kohë dhe pa probleme të shërbimit, Autoriteti Kontraktor do të nënshkruaj kontratën me operatorin ekonomik të suksesshem, sipas nevojave që autoriteti do të ketë me kusht që nga momenti i nënshkrimit të kontratës operatori ekonomik duhet të lëvrojë brenda 10 ditëve, 10 % të sasisë totale të kontraktuar. Pjesa tjetër do të lëvrohet periodikisht përgjatë afatit të vlefshmerisë së kontratës sipas kërkesave të AK.

Për sa i përket procedurës, ajo do të realizohet përmes marrëveshjes kuadër. Autoritetet Kontraktore do të lidhin me operatorin ekonomik fitues të dalë nga procedurat e prokurimit, kontrata bazuar në nevojat e tyre brenda dy periudhave 12 mujore për barna, si më poshtë:

12 mujori i parë / i dytë

? Deri në 50% të sasisë të pritshme - 4 mujorin e I

? Deri në 30 % të sasisë të pritshme - 4 mujorin e II

? Deri në 20% të sasisë të pritshme - 4 mujorin e III

Kundërshtojmë përcaktimet e dokumenteve të tenderit lidhur me afatet e lëvrimit të mallrave, të cilat parashikojnë që për institucione të ndryshme përfituese një pjesë e konsiderueshme e sasisë të kontraktuar të lëvrohet brenda 20 ditëve nga nënshkrimi i kontratës, ndërsa për pjesën tjetër lëvrimi të kryhet sipas kërkesave të autoriteteve kontraktore gjatë gjithë periudhës së zbatimit të marrëveshjes kuadër.

Fillimisht konstatojmë se në dokumentet e tenderit është përdorur termi “barna”, ndërkohë që objekti i procedurës nuk ka të bëjë me barna, por me pajisje/materiale mjekësore. Për

rrjedhojë, dokumentet përmbajnë pasaktësi që krijojnë paqartësi mbi mënyrën e zbatimit të kontratës dhe duhet të korrigjohen në përputhje me objektin real të prokurimit.

Sa i përket afateve të lëvrimit, vlerësojmë se kërkesa për furnizimin e 5%, 10% apo 20% të sasive brenda 20 ditëve nga nënshkrimi i kontratës, si dhe kërkesat për furnizime të menjëhershme sipas nevojave të autoriteteve kontraktore gjatë zbatimit të marrëveshjes kuadër, janë joproporcionale, të pajustificuara dhe kufizojnë konkurrencën.

Autoriteti kontraktor nuk ka paraqitur asnjë analizë teknike, logjistike apo ekonomike që të justifikojë përse afati 20-ditor konsiderohet i domosdoshëm për të gjitha institucionet përfituese, pavarësisht natyrës, vendndodhjes dhe nevojave të ndryshme të tyre. Në praktikë, shumica e operatorëve ekonomikë që ushtrojnë aktivitet në këtë treg janë importues dhe jo prodhues të drejtpërdrejtë të mallrave objekt prokurimi. Për realizimin e furnizimit kërkohet një proces i përbërë nga disa faza të domosdoshme, përfshirë marrjen dhe konfirmimin e porosisë nga prodhuesi, planifikimin dhe prodhimin e mallrave, procedurat e eksportit dhe transportit ndërkombëtar, procedurat doganore dhe transportin dhe shpërndarjen pranë institucioneve përfituese.

Për shkak të këtyre proceseve, si dhe faktorëve të tjerë objektivë si distanca gjeografike, kapacitetet prodhuese, vonesat në transport, periudhat e festave zyrtare apo rastet e forcës madhore, afati prej 20 ditësh nuk është një afat normal dhe i arritshëm për shumicën e operatorëve ekonomikë.

Në praktikë, ky përcaktim favorizon vetëm operatorët ekonomikë që disponojnë paraprakisht stoqe të konsiderueshme të të gjitha produkteve objekt prokurimi ose që kanë informacion të avancuar mbi nevojat konkrete të autoriteteve kontraktore. Për pasojë, krijon një avantazh të padrejtë për një numër të kufizuar operatorësh dhe redukton ndjeshëm mundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve të tjerë që kanë kapacitete reale furnizimi, por që sigurojnë mallrat përmes porosisë pranë prodhuesve pas lidhjes së kontratës.

Kjo problematikë bëhet edhe më e rëndë në kushtet kur procedura ka bashkuar nevojat e 34 institucioneve shëndetësore në një procedurë të vetme dhe me vlera shumë të larta ekonomike. Kombinimi i sasive të mëdha me afate të shkurtra lëvrimi rrit artificialisht barrierat e hyrjes në procedurë dhe bie ndesh me parimet e konkurrencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të parashikuara në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Gjithashtu, formulimet “sipas nevojave të autoritetit kontraktor”, “sipas kërkesave të shërbimeve” apo “sipas kërkesave të autoritetit kontraktor gjatë afatit të kontratës” nuk përcaktojnë qartë afatet minimale që duhet të ketë në dispozicion operatori ekonomik për realizimin e furnizimeve. Këto përcaktime krijojnë pasiguri juridike dhe i japin autoritetit kontraktor një diskrecion të pakufizuar për të kërkuar furnizime në afate të paparashikueshme, duke cenuar sigurinë dhe barazinë në procedurë.

Për këto arsye kërkojmë që dokumentet e tenderit të modifikohen dhe të përcaktohet se furnizimet do të realizohen jo më herët se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës ose nga data e kërkesës për furnizim të autoritetit kontraktor, sipas rastit. Ky afat është proporcional me natyrën e mallrave, procesin e importit dhe kushtet reale të tregut, duke garantuar njëkohësisht furnizimin normal të institucioneve shëndetësore dhe pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë.

Ky qëndrim është në përputhje edhe me praktikën e Komisionit të Prokurimit Publik, i cili në Vendimin nr. 1427/2025, datë 10.10.2025, ka vlerësuar se afatet tepër të shkurtra të lëvrimit mund të kenë efekt kufizues mbi konkurrencën dhe të favorizojnë operatorët që disponojnë paraprakisht mallrat në magazinë.

Në dokumentat e tenderit është përcaktuar:

1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së

kërkuar duhet të jetë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Kundërshtojmë kriterin e kapacitetit ekonomik dhe financiar sipas të cilit operatorët ekonomikë duhet të paraqesin xhiro vjetore, për të paktën një nga vitet financiare 2023, 2024 ose 2025, jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit të lotit apo të shumatores së loteve për të cilat ofertojnë.

Megjithëse legjislacioni i prokurimit publik lejon që autoriteti kontraktor të kërkojë një nivel xhiroje deri në kufirin maksimal prej 40% të vlerës së fondit limit, ky kufi nuk duhet të zbatohet automatikisht në çdo procedurë. Autoriteti kontraktor ka detyrimin të respektojë parimin e proporcionalitetit dhe të argumentojë konkretisht nevojën për vendosjen e nivelit maksimal të lejuar nga ligji.

Fryma e legjislacionit të prokurimit publik dhe parimi i proporcionalitetit kërkojnë që, sa më i lartë të jetë fondi limit i procedurës, aq më i moderuar duhet të jetë niveli i kriterëve ekonomike dhe financiare, me qëllim zgjerimin e konkurrencës dhe rritjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

Në dokumentet e tenderit nuk evidentohet asnjë analizë ekonomike, financiare që të justifikojë përse është zgjedhur pikërisht niveli maksimal prej 40% dhe jo një nivel më i ulët, i cili do të garantonte një konkurrencë më të gjerë pa cenuar ekzekutimin e kontratës.

Ky kriter bëhet veçanërisht kufizues në kushtet kur autoriteti kontraktor ka bashkuar nevojat e 34 institucioneve shëndetësore në një procedurë të vetme me vlerë shumë të lartë. Si pasojë, edhe kërkesa për xhiro llogaritet mbi një fond limit të fryrë artificialisht nga përqendrimi i nevojave të shumë institucioneve në një lot të vetëm.

Për rrjedhojë, operatorë ekonomikë që kanë kapacitete reale teknike, eksperiencë dhe mundësi financiare për të furnizuar një ose disa institucione shëndetësore, përjashtohen nga pjesëmarrja vetëm për shkak të nivelit të lartë të xhiros së kërkuar, i cili është rezultat i strukturimit të procedurës dhe jo i nevojave reale të secilit institucion përfitues.

Në këto kushte, kriteri nuk rezulton proporcional me objektin e kontratës dhe ka efekt kufizues mbi konkurrencën. Autoriteti kontraktor nuk ka provuar se vendosja e kufirit maksimal prej 40% është e domosdoshme për garantimin e ekzekutimit të kontratës.

Për këto arsye kërkojmë rishikimin e kriterit të mësipërm dhe uljen e nivelit të xhiros së kërkuar në një masë proporcionale me objektin e prokurimit dhe kushtet reale të tregut, me qëllim garantimin e pjesëmarrjes sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë dhe respektimin e parimit të konkurrencës efektive.

Në dokumentat e tenderit është përcaktuar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave

të furnizuara. Kundërshtojmë kriterin e kapacitetit teknik sipas të cilit operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 39% e vlerës së fondit limit të lotit apo të shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton.

Megjithëse niveli i kërkuar i përvojës së ngjashme është formalish brenda kufijve të lejuar nga legjislacioni i prokurimit publik, autoriteti kontraktor ka detyrimin të argumentojë proporcionalitetin e këtij kriteri në raport me objektin konkret të kontratës dhe kushtet reale të tregut.

Fryma e legjislacionit të prokurimit publik dhe parimi i proporcionalitetit kërkojnë që, sa më i lartë të jetë fondi limit i procedurës, aq më i moderuar duhet të jetë niveli i kriterëve ekonomike dhe financiare, me qëllim zgjerimin e konkurrencës dhe rritjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë. Nga dokumentet e tenderit nuk rezulton të jetë kryer asnjë analizë konkrete mbi strukturën e tregut, numrin e operatorëve ekonomikë aktivë apo ndikimin që ky kriter ka mbi konkurrencën. Autoriteti kontraktor është mjaftuar me vendosjen e një niveli shumë të lartë të përvojës së kërkuar, pa shpjeguar përse një operator ekonomik që ka realizuar me sukses kontrata me vlera më të ulëta, por që disponon kapacitete reale financiare, teknike dhe organizative, nuk do të ishte i aftë të zbatojë kontratën objekt prokurimi.

Ky kriter bëhet veçanërisht kufizues për shkak të mënyrës se si është strukturuar procedura. Autoriteti kontraktor ka bashkuar në një procedurë të vetme nevojat e 34 institucioneve shëndetësore publike, duke krijuar lote me vlera shumë të larta ekonomike. Si pasojë, edhe niveli i përvojës së kërkuar llogaritet mbi një fond limit të përqendruar artificialisht dhe jo mbi nevojat individuale të institucioneve përfituese.

Për rrjedhojë, operatorë ekonomikë që kanë realizuar me sukses furnizime të ngjashme për spitale të veçanta, për grupe institucioneve apo për autoritete të tjera kontraktore, përjashtohen nga pjesëmarrja vetëm sepse nuk kanë realizuar më parë kontrata me të njëjtin volum ekonomik të krijuar nga bashkimi i nevojave të 34 institucioneve në një procedurë të vetme.

Në praktikë, kriteri favorizon operatorët ekonomikë që historikisht kanë përfituar kontrata të mëdha të centralizuara dhe kufizon pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë që kanë kapacitet të plotë për të furnizuar një ose disa institucione përfituese, duke cenuar parimin e konkurrencës efektive.

Veçanërisht duhet theksuar se aftësia e një operatori ekonomik për të realizuar furnizime të ngjashme nuk matet vetëm nga vlera monetare e kontratave të mëparshme, por edhe nga përvoja profesionale, organizimi logjistik, rrjeti i furnizimit, marrëdhëniet me prodhuesit dhe kapacitetet e tij reale për të ekzekutuar kontratën. Për këtë arsye, vendosja e një niveli kaq të lartë të përvojës ekonomike, pa një analizë të posaçme dhe të dokumentuar, nuk rezulton proporcionale me objektin e prokurimit.

Për më tepër, ky kriter duhet të vlerësohet së bashku me kriteret e tjera kufizuese të procedurës, si bashkimi i nevojave të 34 institucioneve në një lot të vetëm, kërkesa për xhiro të lartë vjetore, ndalimi i mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të treta dhe afatet tepër të shkurtra të lëvritimit. Të marra së bashku, këto kërkesa reduktojnë ndjeshëm numrin e operatorëve ekonomikë që mund të marrin pjesë në procedurë.

Për sa më sipër, vlerësojmë se kriteri nuk është argumentuar në mënyrë të mjaftueshme nga autoriteti kontraktor dhe ka efekt kufizues mbi konkurrencën. Për rrjedhojë kërkojmë rishikimin e tij dhe përcaktimin e një niveli përvoje të ngjashme proporcional me objektin e kontratës dhe me kushtet reale të tregut, duke garantuar pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë dhe respektimin e parimeve të konkurrencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë.

Në dokumentat e tenderit është përcaktuar:

2. Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për secilin artikull në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara. Dorëzimi i mostrave, të bëhet pranë Operatorit të Blerjeve të Përqendruara SHA në adresën: Rruga “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)”, të mbyllura në një zarf

/kufi jo transparente të vulosur mbi të cilin të shënohet:

? “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme dhe kirurgjikale për nevoja spitalore” dhe jo para datës . .2026, ora 11:00 (\*Data e hapjes/dorëzimit të Ofertave).

? Se bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kufi.

? Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënojë Nr. Rëndor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të çmimit.

? Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit, e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi.

Kundërshtojmë kriterin e përcaktuar në dokumentet e tenderit sipas të cilit operatorët ekonomikë duhet të paraqesin nga një mostër për secilin artikull objekt prokurimi në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Referuar nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 40 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, si dhe Udhëzimit nr. 3, datë 12.04.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”, autoriteti kontraktor mund të kërkojë mostra vetëm kur gjykon se ato janë të nevojshme për vlerësimin e ofertës teknike dhe në çdo rast duhet të argumentojë teknikisht domosdoshmërinë e këtij kriteri.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe veçanërisht i “Procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, konstatohet se autoriteti kontraktor nuk ka paraqitur asnjë argumentim teknik specifik që të justifikojë kërkesën për paraqitjen e mostrave për çdo artikull objekt prokurimi.

Përkundrazi, në procesverbalin e argumentimit, autoriteti kontraktor ka justifikuar në mënyrë të detajuar kërkesën për paraqitjen e katalogëve dhe skedave teknike të prodhuesit, duke deklaruar shprehimisht se katalogët shërbejnë për verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar, garantimin e saktësisë dhe besueshmërisë së informacionit Teknik, evidentimin e origjinës dhe karakteristikave të produktit, parandalimin e ofertimit të produkteve të papërshtatshme ose të falsifikuara dhe krahasimin e specifikimeve teknike gjatë procesit të furnizimit.

Pra, vetë autoriteti kontraktor pranon se katalogët dhe skedat teknike janë instrumenti përmes të cilit krijohet bindja mbi përputhshmërinë e mallrave me specifikimet teknike të kërkuara.

Në këto kushte, kërkesa shtesë për paraqitjen e mostrave për të gjithë artikujt rezulton një kriter i dubluar, i paargumentuar teknikisht dhe jo proporcional me objektin e kontratës.

Më tej, kërkesa për paraqitjen e mostrave për secilin artikull krijon barrë të konsiderueshme ekonomike dhe administrative për operatorët ekonomikë. Duke qenë se procedura përfshin një numër të lartë artikujsh dhe produkte të prodhuesve të ndryshëm, sigurimi i mostrave kërkon porositjen paraprake të mallrave pranë prodhuesve, prodhimin ose nxjerrjen nga stoku të produkteve, transport ndërkombëtar dhe procedura doganore, transport dhe dorëzim pranë autoritetit kontraktor.

Shumë nga materialet objekt prokurimi nuk mbahen në stok nga prodhuesit për shkak të specifikave të tyre teknike ose afateve të kufizuara të përdorimit, çka e bën praktikisht të pamundur sigurimin e të gjitha mostrave brenda afateve të procedurës.

Gjithashtu, paraqitja e mostrave për të gjithë artikujt krijon kosto të konsiderueshme financiare për operatorët ekonomikë. Vetëm kostoja e blerjes së mostrave arrin në vlera të konsiderueshme, pa përfshirë kostot e transportit dhe logjistikës, të cilat mbeten të pakthyeshme në rast se operatori ekonomik nuk shpallet fitues. Kjo situatë dekurajon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe kufizon konkurrencën në procedurë.

Për më tepër, kërkesa favorizon operatorët ekonomikë që disponojnë paraprakisht mallrat në magazinë ose që kanë akses të menjëhershëm në to, ndërkohë që operatorët e tjerë që furnizohen sipas porosive pranë prodhuesve vendosen në kushte të pabarabarta konkurrence. Në këto kushte, kriteri i paraqitjes së mostrave nuk rezulton i argumentuar teknikisht, nuk është proporcional me objektin e kontratës dhe bie ndesh me parimet e konkurrencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë të parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik.

Ky qëndrim mbështetet edhe në praktikën e Komisionit të Prokurimit Publik, i cili me Vendimin nr. 1289/2025, nr. 800/2026, nr. 408/2026, ka pranuar pretendimin e operatorit ekonomik dhe ka urdhëruar heqjen e kërkesës për paraqitjen e mostrave. Po ashtu, edhe në procedura të ngjashme prokurimi të zhvilluara nga autoritete të tjera kontraktore, ky kriter është hequr pas ndërhyrjes dhe rekomandimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, kërkojmë heqjen e kriterit për paraqitjen e mostrave për secilin artikull objekt prokurimi, pasi autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar teknikisht domosdoshmërinë e tij, ndërkohë që verifikimi i përputhshmërisë teknike të produkteve sigurohet tashmë nëpërmjet katalogëve dhe skedave teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

*Në lidhje me specifikimet teknike të produktit nr. 27 ? “Gjuhëz për laringoskop me kamera”*

Në dokumentet e procedurës së prokurimit, për artikullin nr. 27 është parashikuar specifikimi teknik si më poshtë “Gjuhëz për laringoskop me kamera, paketim steril, material polimer optik, Nr. 2, 3, 4.”

Pas analizimit të detajuar të kërkesave teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor për këtë artikull, konstatojmë se formulimi aktual i specifikimit teknik paraqet elementë që kufizojnë në mënyrë të pajustificuar konkurrencën dhe krijojnë kushte që në praktikë orientojnë procedurën drejt një produkti të caktuar.

Konkretisht, kombinimi i karakteristikave teknike të kërkuara, përkatësisht gjuhëz për video-laringoskop, paketim steril, material polimer optic dhe madhësitë Macintosh Nr. 2, Nr. 3 dhe Nr. 4 nuk përfaqëson një përshkrim të përgjithshëm funksional të produktit, por përkon në mënyrë të konsiderueshme me konfigurimin teknik të gjuhëzave njëpërdorimëshe të sistemit McGRATH MAC. Bashkëlidhur katalogu zyrtar (<https://www.medtronic.com/en-us/healthcare-professionals/products/respiratory/intubation/video-laryngoscopes/mcgrath-mac-video-laryngoscope.html#ordering-information>)

Në këtë mënyrë, specifikimi nuk kufizohet në përcaktimin e nevojës klinike që duhet të përmbushë produkti, por përfshin një kombinim karakteristikash shumë specifike që identifikojnë një zgjidhje të caktuar teknike dhe jo një kategori të gjerë produktesh të disponueshme në treg.

Legjislacioni i prokurimit publik dhe praktika e konsoliduar administrative kërkojnë që specifikimet teknike të hartohen në mënyrë të tillë që të garantojnë konkurrencën efektive, trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë dhe mosdiskriminimin. Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të përshkruajë nevojën funksionale, rezultatin klinik dhe performancën e kërkuar, pa përcaktuar elemente teknike të panevojshme që në praktikë çojnë në identifikimin

e një produkti të vetëm. Në rastin konkret, kërkesa për përdorimin e “materialit polimer optik” paraqet një element tepër specifik teknik, i cili nuk lidhet drejtpërdrejt me rezultatin klinik që synohet të arrihet. Funkzioni kryesor i produktit është sigurimi i vizualizimit të rrugëve të frymëmarrjes dhe lehtësimi i procedurës së intubimit. Materiali i përdorur për prodhimin e gjuhëzës nuk përbën në vetvete tregues të performancës klinike, sigurisë së pacientit apo suksesit të procedurës.

Për rrjedhojë, përfshirja e kësaj karakteristike teknike nuk shërben për garantimin e cilësisë së shërbimit mjekësor, por kontribuon në identifikimin e një produkti të caktuar.

Situata paraqitet edhe më problematike duke marrë në konsideratë faktin se produktet McGRATH në tregun shqiptar shpërndahen në mënyrë ekskluzive nga një operator ekonomik i vetëm. Në këto kushte, çdo specifikim teknik që në praktikë identifikon gjuhëzat McGRATH sjell si pasojë kufizimin e menjëhershëm të pjesëmarrjes së operatorëve të tjerë ekonomikë dhe reduktimin e konkurrencës në favor të një distributori të vetëm.

Megjithëse dokumentet e tenderit nuk përmendin në mënyrë të drejtpërdrejtë markën apo prodhuesin, jurisprudenca e prokurimit publik vlerëson jo vetëm formulimin formal të specifikimeve, por edhe efektin konkret që ato prodhojnë në treg.

Nëse një kombinim karakteristikash teknike mund të përmbushet vetëm nga një produkt i caktuar ose nga një numër shumë i kufizuar operatorësh ekonomikë, atëherë kemi të bëjmë me një kufizim të konkurrencës, pavarësisht faktit se emri tregtar nuk përmendet në dokumentacion.

Gjithashtu duhet të merret në konsideratë natyra teknike e gjuhëzave të video-laringoskopëve. Këto produkte nuk janë universale dhe zakonisht projektohen për përdorim me sisteme specifike

video-laringoskopie. Për këtë arsye, në rast se Autoriteti Kontraktor disponon aktualisht një sistem McGRATH, formulimi aktual i specifikimit teknik ka efektin e drejtpërdrejtë të kufizimit të konkurrencës vetëm tek operatorët që kanë akses në produktet e këtij sistemi.

Si rezultat, operatorë të tjerë ekonomikë që disponojnë produkte të certifikuara dhe funksionalisht ekuivalente përjashtohen në mënyrë faktike nga pjesëmarrja në procedurë.

Shoqëria jonë disponon mundësinë për të ofertuar një produkt ekuivalent, të prodhuar nga një kompani me reputacion ndërkombëtar në fushën e menaxhimit të rrugëve të frymëmarrjes dhe pajisjeve diagnostikuese.

Produkti i ofruar nga ana jonë realizon të njëjtin funksion klinik, garanton vizualizim të avancuar të rrugëve të frymëmarrjes, është i certifikuar sipas kërkesave të Rregullores Evropiane MDR, përmbush standardet e sigurisë dhe performancës klinike dhe plotëson nevojën funksionale të Autoritetit Kontraktor.

Specifikimet e produktit të ofruar nga ana jonë, janë: gjuhëz për laringoskop me kamera, paketim steril, material polimer mjekësor, madhësitë Macintosh 2, 3 dhe 4 dhe sistem anti-fog.

Produkti i ofertuar paraqet gjithashtu disa avantazhe teknike dhe klinike, ndër të cilat:

Profil ultra i hollë: Struktura e gjuhëzës ofron më shumë hapësirë operative gjatë intubimit, duke lehtësuar manovrimin e tubit endotrakeal.

Sistem anti-fog: Dritarja optike e integruar mbron sistemin optik dhe parandalon mjegullimin e fushës së shikimit gjatë procedurës.

Gjeometri Macintosh: Kurbatura anatomike përputhet me standardin tradicional Macintosh, duke mundësuar përdorimin e saj pa nevojën e ritrajnimit të personelit mjekësor.

Performancë optike e avancuar: Polimeri teknik i përdorur funksionon si përçues i valës së dritës, duke siguruar ndriçim të njëtrajtshëm të fushës operative dhe duke minimizuar reflektimet që mund të ndikojnë në cilësinë e imazhit.

Megjithatë, pavarësisht përmbushjes së të gjitha kërkesave funksionale dhe klinike, formulimi aktual i specifikimit teknik pengon ofertimin e këtij produkti jo për shkak të mungesës së

*cilësisë apo performancës, por për shkak të përfshirjes së elementeve teknike që identifikojnë një zgjidhje specifike.*

*Parimi i ekuivalencës në prokurimin publik synon pikërisht shmangien e situatave të tilla dhe garantimin e konkurrencës ndërmjet prodhuesve të ndryshëm që ofrojnë të njëjtin rezultat funksional dhe klinik.*

*Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktor duhet të përcaktojë kërkesa funksionale dhe klinike, si:*

- a) sigurimi i vizualizimit të rrugëve të frymëmarrjes;*
- b) steriliteti;*
- c) siguria për pacientin;*
- d) performanca klinike;*
- e) përputhshmëria me sistemin ekzistues;*
- f) certifikimi sipas standardeve ndërkombëtare.*

*Njëkohësisht duhet të lejohet shprehimisht ofertimi i produkteve ekuivalente.*

*Kufizimi i konkurrencës në favor të një produkti të shpërndarë ekskluzivisht nga një operator i vetëm ekonomik bie ndesh me parimet themelore të transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit.*

*Një specifikim teknik nuk duhet të ketë si pasojë krijimin e një avantazhi tregtar për një distributor të vetëm, veçanërisht kur në treg ekzistojnë alternativa të tjera të certifikuara dhe funksionalisht ekuivalente.*

*Për sa më sipër, vlerësojmë se specifikimi teknik i publikuar për artikullin nr. 27 nuk është hartuar në përputhje me parimet e konkurrencës efektive dhe prodhon efekt kufizues në treg, duke favorizuar në mënyrë indirekte një produkt dhe një rrjet të caktuar shpërndarjeje.*

*Për rrjedhojë, kërkojmë rishikimin dhe riformulimin e specifikimeve teknike mbi bazën e kërkesave funksionale dhe klinike, duke eliminuar elementet që identifikojnë një produkt të caktuar dhe duke garantuar pranimin e produkteve ekuivalente që përmbushin të njëjtin qëllim funksional, teknik dhe klinik.*

*Vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet një procedurë prokurimi e hapur, konkurruese, transparente dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

*Në lidhje me specifikimet teknike të produktit nr. 36 ? “Sondë Blakemore”*

*Në dokumentet e procedurës së prokurimit, për artikullin nr. 36 është parashikuar si objekt furnizimi: “Sondë Blakemore, Nr. 16 dhe Nr. 20.”*

*Dëshirojmë të paraqesim një sërë rrethanash teknike, ligjore dhe tregtare që lidhen me këtë artikull dhe që, në vlerësimin tonë, krijojnë një situatë të qartë kufizimi të konkurrencës dhe pamundësojnë pjesëmarrjen efektive të operatorëve ekonomikë të tjerë.*

*Nga analiza e specifikimeve teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor rezulton se kërkesat e vendosura për këtë produkt përkojnë në praktikë me një produkt specifik të prodhuar nga CREATE Medic Co., Ltd., i cili në territorin e Republikës së Shqipërisë tregtohet në mënyrë ekskluzive nga shoqëria Euromed sh.p.k. Bashkëlidhur katalogu zyrtar ( [https://www.createmedic.co.jp/english/products\\_detail/id=342](https://www.createmedic.co.jp/english/products_detail/id=342) )*

*Sonda Blakemore është një pajisje mjekësore e specializuar, e përdorur për kontrollin emergjent të hemorragjive nga varicet ezofageale dhe gastrike përmes teknikës së tamponadës. Për shkak të natyrës së saj shumë specifike klinike, tregu ndërkombëtar i prodhuesve të këtij produkti ka qenë historikisht tepër i kufizuar.*

*Ndryshe nga kategori të tjera të pajisjeve mjekësore ku ekziston një numër i madh prodhuesish dhe produktesh ekuivalente, në rastin e sondave për tamponadën gastroezofageale alternativat në treg kanë qenë tradicionalisht shumë të kufizuara.*

*Historikisht, literatura mjekësore dhe tregu ndërkombëtar kanë njohur tre kategori kryesore të këtyre produkteve:*

- 1) Sonda Sengstaken-Blakemore;
- 2) Minnesota Tube;
- 3) Sonda Linton-Nachlas.

Nga verifikimet e kryera rezulton se produkti i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor përputhet me sondën Blakemore të prodhuar nga CREATE Medic.

Ndërkohë, alternativat e tjera historike që kanë ekzistuar në treg nuk rezultojnë më të disponueshme.

Konkretisht: Minnesota Tube, e prodhuar nga BD (Becton Dickinson), nuk prodhohet më dhe është nxjerrë jashtë portofolit aktiv të kompanisë kurse Sonda Linton-Nachlas, e prodhuar nga Teleflex/Ëilly Rüsç GmbH, nuk rezulton më në katalogët zyrtarë të prodhuesit dhe është ndërprerë nga prodhimi.

Komunikimet zyrtare të realizuara me prodhuesit konfirmojnë se këto produkte nuk janë më të disponueshme për furnizim.

Për pasojë, në tregun ndërkombëtar mbetet praktikisht vetëm një prodhues që ofron një produkt të certifikuar dhe të disponueshëm, konkretisht CREATE Medic.

Ky fakt ka rëndësi thelbësore për vlerësimin e ligjshmërisë së specifikimeve teknike, pasi demonstroi se kërkesa e vendosur nga Autoriteti Kontraktor nuk lejon ekzistencën e konkurrencës reale.

Në territorin e Republikës së Shqipërisë, produktet e CREATE Medic rezultojnë të shpërndahen në mënyrë ekskluzive nga shoqëria Euromed sh.p.k.

Verifikimet pranë institucioneve përkatëse konfirmojnë se Euromed sh.p.k. figuron si distributori i vetëm i regjistruar për këtë produkt, me prodhues CREATE Medic.

Për rrjedhojë, çdo operator tjetër ekonomik që nuk disponon marrëdhënie kontraktore me këtë prodhues apo me distributorin ekskluziv nuk ka mundësi objektive të sigurojë produktin. Situata bëhet edhe më problematike për shkak se prodhues të tjerë të identifikuar në tregje të treta nuk disponojnë certifikim CE të vlefshëm sipas legjislacionit evropian për pajisjet mjekësore.

Sipas Rregullores (BE) 2017/745 për pajisjet mjekësore (MDR), një pajisje mjekësore mund të vendoset në treg vetëm nëse disponon certifikim CE të lëshuar nga një trup i notifikuar i autorizuar dhe i regjistruar në sistemin NANDO.

Pajisjet që nuk disponojnë një certifikim të tillë nuk mund të regjistrohen pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, nuk mund të importohen ligjërisht në Republikën e Shqipërisë, nuk mund të përdoren në institucionet publike shëndetësore dhe nuk mund të ofertohen në procedurat e prokurimit publik.

Për pasojë, operatorët ekonomikë nuk mund të ofrojnë alternativa të tjera, edhe nëse ato mund të kenë funksione të ngjashme klinike, për shkak të pengesave ligjore dhe rregullatore.

Komunikimet e realizuara me prodhuesin CREATE Medic konfirmojnë ekzistencën e një distributori ekskluziv për territorin shqiptar.

Gjithashtu, komunikimet me distributorë të tjerë ndërkombëtarë kanë konfirmuar se ata nuk janë të autorizuar të furnizojnë produktin në territorin e Shqipërisë dhe i referohen drejtpërdrejt prodhuesit, i cili nga ana e tij konfirmon ekzistencën e të drejtave ekskluzive të shpërndarjes.

Në këto kushte, pjesëmarrja e operatorëve të tjerë ekonomikë bëhet objektivisht e pamundur. Kjo situatë krijon një efekt praktik të paracaktimit të fituesit, pasi vetëm distributori ekskluziv disponon mundësinë reale për të siguruar dhe ofertuar produktin.

Duhet theksuar se nuk kemi të bëjmë me një zgjedhje tregtare apo preferencë subjektive nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë, por me një pamundësi objektive dhe ligjore për sigurimin e produktit.

Legjislacioni i prokurimit publik nuk lejon hartimin e specifikimeve teknike që çojnë në favorizimin e një operatori ekonomik të vetëm ose të një distributori ekskluziv, përveç rasteve kur Autoriteti Kontraktor provon në mënyrë të argumentuar se:

- a) nuk ekziston asnjë alternativë tjetër teknike;
- b) produkti është i domosdoshëm për arsye funksionale ose klinike;
- c) kufizimi i konkurrencës është proporcional dhe i justifikuar.

Në rastin konkret, fakti që në treg ekziston vetëm një prodhues dhe një distributor i autorizuar përbën në vetvete tregues se specifikimet teknike nuk janë ndërtuar mbi bazën e konkurrencës efektive.

Përkundrazi, ato kufizojnë procedurën tek një produkt i vetëm dhe tek një operator i vetëm ekonomik.

Në këto kushte, Autoriteti Kontraktor duhet të argumentojë në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar arsyet klinike të domosdoshmërisë së këtij produkti, mungesën e alternativave të tjera terapeutike dhe pamundësinë e përdorimit të zgjidhjeve të tjera mjekësore që realizojnë të njëjtin funksion klinik.

Në mungesë të një argumentimi të tillë, ruajtja e specifikimeve aktuale krijon një avantazh të drejtpërdrejtë për distributorin ekskluziv dhe përjashton operatorët e tjerë ekonomikë nga pjesëmarrja.

Ky rezultat bie ndesh me parimet e konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë, proporcionalitetit, transparencës dhe mosdiskriminimit.

Për më tepër, për shkak të natyrës monopoliste të këtij produkti, përfshirja e tij brenda një loti me vlerë të konsiderueshme ekonomike ka efekt negativ mbi të gjithë procedurën, pasi një artikull i vetëm bëhet faktor përjashtues për operatorët ekonomikë që mund të konkurrojnë për pjesën tjetër të artikujve.

Për këtë arsye, vlerësojmë se zgjidhja më e përshtatshme dhe proporcionale është ndarja e artikullit nr. 36 në një lot të veçantë.

Një ndarje e tillë eliminon efektin bllokues të produktit monopol, garanton konkurrencën në pjesën tjetër të procedurës, lejon pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë ekonomikë dhe ruan interesin publik dhe eficiencën e prokurimit.

Për sa më sipër, kërkojmë:

1. Pranimin e këtij kundërshtimi si të bazuar në fakte dhe në legjislacionin e prokurimit publik.
  2. Rishikimin e specifikimeve teknike të artikullit nr. 36, duke i formuluar ato mbi bazën e karakteristikave funksionale dhe klinike.
  3. Argumentimin e dokumentuar të domosdoshmërisë së produktit të kërkuar dhe të mungesës së alternativave të tjera.
  4. Ndarjen e artikullit nr. 36 “Sondë Blakemore” në një lot të veçantë dhe të pavarur, me qëllim shmangien e efektit monopolist që ky produkt ushtron mbi të gjithë lotin.
- Vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet një procedurë prokurimi e hapur, konkurruese, proporcionale dhe në përputhje me parimet themelore të legjislacionit të prokurimit publik.

Në lidhje me specifikimet teknike të produktit nr. 64 ? “Beze kirurgjikale aktive 7.5 cm x 7.5 cm” Në dokumentet e procedurës së prokurimit, për artikullin nr. 64 është parashikuar si objekt furnizimi: “Beze kirurgjikale aktive 7.5 cm x 7.5 cm, copë e thurur, me thithje të shpejtë për plagë, me përbërës polyacrylate (SAP) me veshje celuloze dhe solucion Ringer, 7.5 cm x 7.5 cm ose ekuivalent.”

Pas analizimit të detajuar të specifikimeve teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, konstatuam se kombinimi i karakteristikave të kërkuara përputhet në mënyrë pothuajse identike me produktin HydroClean Plus të prodhuesit Paul Hartmann AG.

Produkti HydroClean Plus përfaqëson një sistem të specializuar të trajtimit aktiv të plagëve, i bazuar në teknologjinë e polimerëve superabsorbues (SAP), të kombinuar me një bërthamë të ngopur me solucion Ringer dhe një strukturë funksionale me bazë celuloze. Kjo teknologji është zhvilluar dhe standardizuar nga prodhuesi si një sistem i integruar për pastrimin e plagëve dhe menaxhimin aktiv të eksudatit.

Në këtë kontekst, kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konkretisht përdorimi i polimerit superabsorbues (SAP), prania e solucionit Ringer, struktura me bazë celuloze, funksioni i absorbimit aktiv të eksudatit dhe dimensionit 7.5 cm x 7.5 cm nuk përfaqësojnë vetëm karakteristika funksionale të produktit, por përbëjnë një kombinim teknik tepër specifik që përputhet në mënyrë të plotë me konfigurimin e produktit HydroClean Plus. Bashkëlidhur katalogu zyrtar (<https://www.hartmann.info/en-au/products/wound-management/hydroactive-wound-dressings/polyacrylate-wound-dressings/hydroclean%C2%AE-plus>) Për pasojë, specifikimi teknik nuk kufizohet në përcaktimin e funksionit klinik që duhet të realizojë produkti, por identifikon një teknologji të caktuar dhe praktikisht një produkt të vetëm.

Në praktikë, kjo situatë redukton ndjeshëm mundësinë e ofertimit të produkteve alternative dhe kufizon konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Edhe pse në dokumentacion përdoret shprehja “ose ekuivalent”, kombinimi i të gjitha elementeve teknike të kërkuara e bën praktikisht të pamundur ofertimin e produkteve të tjera që realizojnë të njëjtin funksion klinik përmes mekanizmave të ndryshëm teknologjikë.

Legjislacioni i prokurimit publik kërkon që specifikimet teknike të hartohen në mënyrë të tillë që të garantojnë konkurrencën efektive dhe të shmangin favorizimin e një produkti, marke ose teknologjie të caktuar.

Autoriteti Kontraktor duhet të përshkruajë nevojën klinike dhe rezultatin funksional që synon të arrijë, pa kufizuar operatorët ekonomikë në një zgjidhje të vetme teknologjike.

Në rastin konkret, funksioni klinik i kërkuar është menaxhimi i eksudatit, pastrimi i plagës, ruajtja e mjedisit optimal të shërimit, mbrojtja e indeve dhe stimulimi i procesit të shërimit.

Këto funksione mund të realizohen edhe nga produkte të tjera që përdorin mekanizma të ndryshëm teknologjikë.

Nga verifikimet e kryera rezulton se produktet e Paul Hartmann AG në territorin e Republikës së Shqipërisë shpërndahen nëpërmjet Vinipharma sh.p.k, në të cilën ortak I vetëm rezulton Hervin Fora, i cili është gjithashtu ortak I kompanisë Euromed me 10% të aksioneve.

Të dhënat e regjistrimit të pajisjeve mjekësore pranë AKBPM tregojnë se për produktet e Paul Hartmann AG figuron si distributor i regjistruar Vinipharma sh.p.k., përfshirë regjistrimet:

? Nr. 9973;

? Nr. 9985;

? Nr. 10016.

Kjo situatë krijon një kanal të kufizuar furnizimi për produktet specifike të këtij prodhuesi. Si rezultat, operatorët e tjerë ekonomikë ndodhen në vështirësi objektive për sigurimin e këtij produkti, për shkak të:

- 1) mungesës së kanaleve alternative të furnizimit;
- 2) marrëdhënieve të kufizuara të distribucionit;
- 3) pamundësisë praktike të furnizimit paralel në tregun vendas.

Në këto kushte, specifikimi aktual prodhon efektin e kufizimit të konkurrencës dhe krijon një avantazh të drejtpërdrejtë për operatorin ekonomik që disponon akses në këtë linjë produktesh. Ky rezultat bie ndesh me parimet themelore të prokurimit publik, konkretisht parimin e konkurrencës së lirë dhe efektive, parimin e trajtimit të barabartë, parimin e proporcionalitetit dhe parimin e mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë.

Shoqëria jonë disponon mundësinë e ofertimit të një produkti alternativ, i cili realizon të njëjtin funksion klinik dhe terapeutik.

Produkti i propozuar nga ana jonë është: Beze kirurgjikale aktive 10 cm x 10 cm me përbërje Chitosan (100% biopolimer natyral), me aftësi absorbuese të eksudatit.

Ky produkt përfaqëson një teknologji alternative për menaxhimin e plagëve, e bazuar në vetitë biologjike të chitosan-it.

Produkti kontrollon eksudatin, mbron indet, krijon mjedis të favorshëm për shërim, kontribuon në procesin e rigjenerimit të plagës si dhe siguron menaxhim aktiv të plagës.

Ndonëse mekanizmi i tij teknologjik ndryshon nga sistemi SAP-Ringer i HydroClean Plus, rezultati klinik dhe qëllimi terapeutik janë të njëjta.

Koncepti i ekuivalencës në prokurimin publik nuk kërkon identitet absolut të teknologjisë, por kërkon që produktet të realizojnë të njëjtin funksion klinik dhe të përmbushin të njëjtën nevojë mjekësore.

Për këtë arsye, kufizimi i ekuivalencës vetëm tek produktet që përdorin teknologjinë SAP me solucion Ringer përbën një interpretim tepër të ngushtë të parimit të ekuivalencës dhe redukton artificialisht konkurrencën.

Për sa më sipër, vlerësojmë se specifikimi teknik aktual i artikullit nr. 64 nuk është hartuar në përputhje me parimet e konkurrencës efektive dhe krijon një efekt kufizues në treg, duke orientuar procedurën drejt një produkti të vetëm.

Për rrjedhojë, kërkojmë:

1. Rishikimin e specifikimeve teknike të artikullit nr. 64.
2. Formulimin e kërkesave mbi bazën e funksioneve klinike dhe rezultateve terapeutike të kërkuara.
3. Zgjerimin real të konceptit “ose ekuivalent”, duke lejuar produkte që realizojnë të njëjtin funksion klinik nëpërmjet teknologjive të ndryshme.
4. Pranimin e produkteve alternative që ofrojnë menaxhim aktiv të plagëve, kontroll të eksudatit dhe stimulim të procesit të shërimit.

Vetëm në këtë mënyrë mund të garantohej një procedurë prokurimi e hapur, konkurruese dhe në përputhje me parimet e legjislacionit të prokurimit publik.

*Në lidhje me specifikimet teknike të produktit nr. 69 ? “Beze me vazelinë”*

Në dokumentet e procedurës së prokurimit, për artikullin nr. 69 është parashikuar si objekt furnizimi: “Beze me pomadë të thjeshtë (vazelinë të bardhë, estere acid yndyror digliceroli të karbonateve dhe bikarbonateve, dyll sintetik), e përshkueshme nga ajri dhe eksudati, me shtresë të trashë që nuk fshihet dhe në rast të eksudatit masiv, jo alergjike, efektive dhe për trajtim afatgjatë,

*7.5 cm x 10 cm, ose ekuivalent.”*

Pas analizës së detajuar të specifikimeve teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, konstatohet se kombinimi i karakteristikave të kërkuara përputhet në mënyrë pothuajse identike me produktin Grassolind? të prodhuesit Paul Hartmann AG. Bashkëlidhur katalogu zyrtar (<https://www.hartmann.info/en/products/wound-management/hydroactive-wound-dressings/foam-wound-dressings/hydrotac%C2%AE-comfort> )

Në veçanti, kërkesat që lidhen me përbërjen me vazelinë të bardhë, esteret e acideve yndyrore të diglicerolit, karbonatet dhe bikarbonatet, dyllin sintetik, strukturën e përshkueshme nga ajri dhe eksudati, shtresën e trashë jo-ngjitëse, përdorimin afatgjatë dhe dimensionin 7.5 cm x 10 cm përbëjnë një kombinim teknik shumë specifik, i cili përkon me formulimin dhe karakteristikat teknike të produktit Grassolind?.

Në këtë mënyrë, specifikimi teknik nuk kufizohet në përshkrimin e funksionit klinik që duhet të realizojë produkti, por përfshin elemente të detajuara të formulimit dhe përbërjes, të cilat identifikojnë një produkt të caktuar.

Në praktikë, ky nivel specifikimi krijon një situatë ku konkurrenca reale ndërmjet operatorëve ekonomikë kufizohet ndjeshëm, pasi numri i produkteve që mund të përmbushin në mënyrë identike të gjitha këto karakteristika është tepër i kufizuar.

Megjithëse dokumentet e tenderit përdorin shprehjen “ose ekuivalent”, kombinimi i të gjitha karakteristikave të kërkuara e redukton ndjeshëm mundësinë e ofertimit të produkteve alternative që realizojnë të njëjtin funksion klinik.

Legjislacioni i prokurimit publik kërkon që specifikimet teknike të hartohen mbi bazën e funksionit, performancës dhe nevojës klinike, pa favorizuar produkte, marka apo teknologji të caktuara.

Autoriteti Kontraktor duhet të përshkruajë rezultatin terapeutik që kërkohet të arrihet dhe jo të identifikojë në mënyrë indirekte formulime teknike që përkojnë me një produkt të vetëm.

Produkti Grassolind? i prodhuesit Paul Hartmann AG rezulton të jetë i regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë përmes operatorit ekonomik Vinipharma sh.p.k, në të cilën ortak I vetëm rezulton Hervin Fora, i cili është gjithashtu ortak I kompanisë Euromed me 10% të aksioneve.

Nga të dhënat e disponueshme në regjistrin e pajisjeve mjekësore rezulton se produktet e Paul Hartmann AG janë regjistruar nga ky operator ekonomik, çka krijon një kanal të kufizuar furnizimi për këtë linjë produktesh.

Për pasojë, operatorët e tjerë ekonomikë ndodhen në vështirësi objektive për sigurimin e produktit, për shkak të mungesës së kanaleve alternative të furnizimit, marrëdhënieve të kufizuara të distribucionit dhe pamundësisë praktike të furnizimit të drejtpërdrejtë.

Në këto kushte, specifikimi aktual krijon një avantazh të drejtpërdrejtë për operatorin ekonomik që disponon akses në këtë produkt dhe redukton ndjeshëm mundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve të tjerë.

Ky rezultat cenon parimet themelore të prokurimit publik, konkretisht parimin e konkurrencës së lirë dhe efektive, parimin e trajtimit të barabartë, parimin e proporcionalitetit dhe parimin e mosdiskriminimit.

Propozojmë si alternativë funksionalisht ekuivalente produktin: “Beze me vazelinë ? beze me pomadë të thjeshtë vazeline, 7.5 cm x 10 cm.”

Produkti i ofruar nga ana jonë përfaqëson një shtresë kontakti jo-adherente për plagët, e impregnuar me vazelinë dhe e destinuar për mbrojtjen e sipërfaqes së plagës.

Funksioni kryesor i këtij produkti është mbrojtja e plagës nga ngjitja e fashës sekondare, ruajtja e një mjedisi të përshtatshëm për shërimin e plagës, lejimi i kalimit të eksudatit drejt shtresës absorbuese, minimizimi i traumës gjatë ndërrimit të fashës dhe mbrojtja e indeve të reja gjatë procesit të shërimit.

Nga pikëpamja klinike dhe terapeutike, produkti i ofertuar realizon të njëjtin funksion si produkti i kërkuar në specifikimet e tenderit.

Koncepti i ekuivalencës në prokurimin publik nuk kërkon identitet absolut të përbërjes kimike apo të formulimit të produktit, por kërkon që produkti alternativ të realizojë të njëjtin qëllim terapeutik dhe të sigurojë të njëjtin rezultat klinik.

Për rrjedhojë, ekzistenca e ndryshimeve në përbërjen e detajuar të produktit nuk duhet të përbëjë shkak për përjashtimin e produkteve që realizojnë të njëjtin funksion mjekësor.

Në rastin konkret, kërkesa për përbërës të caktuar si esteret e diglicerolit, karbonatet, bikarbonatet apo dylli sintetik nuk paraqitet si një kërkesë klinike e domosdoshme, por si një element teknik që identifikon një formulim të caktuar tregtar.

Për sa më sipër, vlerësojmë se specifikimi teknik i artikullit nr. 69 nuk është hartuar në përputhje me parimet e konkurrencës efektive dhe prodhon efekt kufizues në treg, duke orientuar procedurën drejt një produkti të vetëm. Për rrjedhojë, kërkojmë:

1. Rishikimin e specifikimeve teknike të artikullit nr. 69.
  2. Formulimin e kërkesave mbi bazën e funksionit klinik dhe qëllimit terapeutik të produktit.
  3. Zbatimin real të konceptit “ose ekuivalent”, duke lejuar produkte alternative që realizojnë të njëjtin funksion klinik.
  4. Pranimin e produkteve të tjera jo-adherente me bazë vazeline, të cilat garantojnë mbrojtjen e plagës dhe rezultat të krahasueshëm terapeutik.
- Vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet një procedurë prokurimi e hapur, konkurruese dhe në përputhje me parimet e legjislacionit të prokurimit publik.

Në lidhje me specifikimet teknike të produktit nr. 70 ? Beze hidroshel

Në dokumentet e procedurës së prokurimit, për artikullin nr. 70 është parashikuar si objekt furnizimi produkti: “Beze e sfungjertë hidropolimere, hidrosheli me përbërje poliure/poliuretan-poliuretan polimer, propilen glikol, me buzë adezive poliakrilat. Përmasa 15 x 15 cm”.

Pas analizës së hollësishme të specifikimeve teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor konstatuam se kombinimi i karakteristikave të kërkuara përputhet në mënyrë pothuajse të plotë me karakteristikat teknike të produktit HydroTac? Comfort të prodhuesit Paul Hartmann AG. (<https://www.hartmann.info/en/products/wound-management/hydroactive-wound-dressings/foam-wound-dressings/hydrotac%C2%AE-comfort>) Përshkrimi i materialeve përbërëse, i strukturës hidropolimere, i përmbajtjes së propilen glikolit, i sistemit adeziv me bazë poliakrilati dhe i dimensioneve të kërkuara përbëjnë një konfigurim teknik tepër specifik, i cili identifikon në praktikë një produkt të vetëm të disponueshëm në treg.

Në këtë rast, specifikimi teknik nuk kufizohet në përcaktimin e funksionit klinik që duhet të realizojë produkti, por përfshin karakteristika të detajuara të përbërjes dhe teknologjisë së prodhimit që përkojnë me një zgjidhje të caktuar tregtare. Kjo mënyrë formulimi kufizon ndjeshëm mundësinë e ofertimit të produkteve alternative që realizojnë të njëjtin funksion terapeutik nëpërmjet teknologjive të ndryshme.

Edhe pse në dokumentet e tenderit përdoret shprehja “ose ekuivalent”, kombinimi i të gjitha karakteristikave të kërkuara e bën praktikisht të pamundur ofertimin e produkteve të tjera, pasi çdo devijim nga përbërja teknike e përshkruar mund të konsiderohet si mosplotësim i specifikimeve.

Për rrjedhojë, koncepti i ekuivalencës mbetet vetëm formal dhe nuk garanton në praktikë një konkurrencë reale ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Nga informacionet e disponueshme në tregun shqiptar rezulton se produktet e Paul Hartmann AG janë të regjistruara dhe të shpërndara në territorin e Republikës së Shqipërisë përmes operatorit ekonomik Vinipharma sh.p.k, në të cilën ortak I vetëm rezulton Hervin Fora, i cili është gjithashtu ortak I kompanisë Euromed me 10% të aksioneve. Kjo situatë krijon një kanal të kufizuar furnizimi për këtë kategori produktesh dhe redukton mundësinë e aksesit të operatorëve të tjerë ekonomikë tek këto produkte.

Për pasojë, operatorët ekonomikë që nuk disponojnë marrëdhënie furnizimi me këtë linjë produktesh ndodhen në pamundësi objektive për të siguruar produktin e kërkuar. Kjo situatë prodhon një avantazh konkurrues për operatorin ekonomik që ka akses në produktin konkret dhe kufizon pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë në procedurë.

Legjislacioni i prokurimit publik kërkon që specifikimet teknike të hartohen mbi bazën e nevojës funksionale dhe rezultatit klinik që synon të arrijë Autoriteti Kontraktor, duke

shmangur përshkrimet teknike që çojnë në identifikimin e një marke, prodhuesi ose teknologjie të caktuar. Parimet e konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit kërkojnë që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë mundësi reale pjesëmarrjeje në procedurë.

Ne propozojmë si alternativë funksionalisht ekuivalente një beze hidroxhel të përbërë nga një shtresë hidrogeli e rrethuar nga një film ngjitës prej poliuretani, i cili zgjatet për të vepruar si kufi adeziv, me përmasa 15 x 15 cm.

Produkti i ofertuar përfaqëson një zgjidhje moderne për trajtimin e plagëve dhe realizon të njëjtin funksion klinik si produkti i kërkuar në dokumentet e tenderit. Ai përdoret për trajtimin e ulcerave të presionit, ulcerave diabetike, plagëve kirurgjikale, djegieve sipërfaqësore, zonave donatore dhe plagëve të tjera që kërkojnë kontroll të eksudatit dhe ruajtjen e një mjedisi optimal të shërimit.

Funksioni kryesor i të dy produkteve është ruajtja e lagështisë fiziologjike të plagës, mbrojtja e indeve të reja, absorbimi i eksudatit dhe krijimi i kushteve optimale për procesin e shërimit. Ndonëse teknologjia e përdorur mund të ndryshojë në aspektin e përbërjes së materialeve, rezultati klinik dhe qëllimi terapeutik mbeten të njëjta.

Koncepti i ekuivalencës në prokurimin publik nuk kërkon identitet absolut të përbërjes kimike ose të teknologjisë së prodhimit, por kërkon që produkti alternativ të realizojë të njëjtin funksion klinik dhe të sigurojë të njëjtin rezultat terapeutik. Për rrjedhojë, ndryshimet në përbërjen teknike të produktit nuk duhet të përbëjnë shkak për përjashtimin e produkteve që plotësojnë të njëjtin qëllim mjekësor.

Për sa më sipër, vlerësojmë se specifikimi teknik i artikullit nr. 70 nuk është hartuar në përputhje me parimet e konkurrencës efektive dhe prodhon efekt kufizues në treg, duke orientuar procedurën drejt një produkti të vetëm. Kjo situatë pengon pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë ekonomikë dhe kufizon mundësinë e Autoritetit Kontraktor për të përfituar oferta alternative me cilësi të krahasueshme dhe kushte ekonomike potencialisht më të favorshme.

Për rrjedhojë, kërkojmë rishikimin e specifikimeve teknike të artikullit nr. 70, formulimin e tyre mbi bazën e funksionit klinik dhe rezultatit terapeutik të kërkuar, si dhe pranimin e produkteve funksionalisht ekuivalente që realizojnë të njëjtin qëllim mjekësor nëpërmjet teknologjive të ndryshme. Vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet një procedurë prokurimi e hapur, konkurruese dhe në përputhje me parimet e legjislacionit të prokurimit publik.

Në lidhje me specifikimet teknike të produktit nr. 71 ? Beze për trajtimin e plagëve kronike Në dokumentet e procedurës së prokurimit, për artikullin nr. 71 është parashikuar si objekt furnizimi produkti: “Beze me argjend për trajtimin e plagëve kronike, si ulçerat e këmbës dhe ulçerat diabetike, shtresë sterile, jo-ngjitëse, poliamidi i veshur me argjend, me pomadë jo-ngjitëse, me temperaturë shkrirjeje të pomadës 35?45?C, me peshë të pomadës minimumi 157 g/m?, me përmbajtje argjendi minimumi 8.4%, në përmasën 10 x 20 cm ose ekuivalent.”

Pas analizës së detajuar të specifikimeve teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor konstatuam se kombinimi i karakteristikave të kërkuara përputhet pothuajse në mënyrë të plotë me karakteristikat teknike të produktit Atrauman? Ag të prodhuesit Paul Hartmann AG. Përshkrimi i materialit bazë prej poliamidi të veshur me argjend, përmbajtja minimale e argjendit, parametrat e pomadës, temperatura e shkrirjes së saj, pesha specifike e shtresës dhe dimensionet e përcaktuara përbëjnë një konfigurim teknik tepër të detajuar, i cili në praktikë identifikon një produkt të vetëm në treg. Bashkëlidhur katalogu zyrtar

(<https://www.hartmann.info/en-au/products/wound-management/contact-layers/impregnated-contact-layers/atrauman%C2%AE-ag> )

Në këtë rast, specifikimi teknik nuk kufizohet në përcaktimin e funksionit klinik që duhet të realizojë produkti, por përfshin parametra teknike dhe karakteristika të hollësishme të përbërjes së produktit, të cilat përkojnë me një zgjidhje të caktuar tregtare. Kjo mënyrë formulimi kufizon ndjeshëm mundësinë e ofertimit të produkteve alternative që realizojnë të njëjtin funksion terapeutik nëpërmjet teknologjive të tjera.

Megjithëse dokumentet e tenderit përdorin shprehjen “ose ekuivalent”, kombinimi i të gjitha karakteristikave teknike të kërkuara e bën praktikisht të pamundur ofertimin e produkteve të tjera, pasi çdo ndryshim në parametrat e përcaktuar mund të konsiderohet si mosplotësim i specifikimeve teknike. Për rrjedhojë, koncepti i ekuivalencës mbetet vetëm formal dhe nuk garanton në praktikë një konkurrencë reale ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Nga informacionet e disponueshme në tregun shqiptar rezulton se produktet e Paul Hartmann AG janë të regjistruara dhe të shpërndara në territorin e Republikës së Shqipërisë përmes operatorit ekonomik Vinipharma sh.p.k në të cilën ortak I vetëm rezulton Hervin Fora, i cili është gjithashtu ortak I kompanisë Euromed me 10% të aksioneve. Kjo situatë krijon një kanal të kufizuar furnizimi për këtë kategori produktesh dhe kufizon aksesin e operatorëve të tjerë ekonomikë tek këto produkte.

Për pasojë, operatorët ekonomikë që nuk disponojnë marrëdhënie furnizimi me këtë linjë produktesh ndodhen në pamundësi objektive për të siguruar produktin e kërkuar. Kjo situatë prodhon një avantazh konkurrues për operatorin ekonomik që ka akses në produktin konkret dhe redukton mundësinë reale të pjesëmarrjes së operatorëve të tjerë në procedurë.

Legjislacioni i prokurimit publik kërkon që specifikimet teknike të hartohen mbi bazën e nevojës funksionale dhe rezultatit klinik që synon të arrijë Autoriteti Kontraktor, duke shmangur përshkrimet teknike që çojnë në identifikimin e një marke, prodhuesi apo teknologjie të caktuar. Parimet e konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit kërkojnë që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë mundësi reale pjesëmarrjeje në procedurë.

Produkti i kërkuar është i destinuar për trajtimin e plagëve kronike, ulçerave të këmbës, ulçerave diabetike dhe plagëve të tjera me rrezik infeksioni, ku nevojitet mbrojtja e plagës, kontrolli i ngarkesës bakteriale dhe ruajtja e një mjedisi optimal për shërim. Këto funksione terapeutike mund të realizohen edhe nga produkte të tjera që përdorin teknologji alternative me bazë argjendi ose materiale të tjera antimikrobiale të certifikuara.

Koncepti i ekuivalencës në prokurimin publik nuk kërkon identitet absolut të përbërjes kimike, të përqindjes së argjendit apo të parametrave fizikë të produktit, por kërkon që produkti alternativ të realizojë të njëjtin funksion klinik dhe të sigurojë të njëjtin rezultat terapeutik. Për rrjedhojë, ndryshimet në parametrat teknike nuk duhet të përbëjnë shkak për përjashtimin e produkteve që plotësojnë të njëjtin qëllim mjekësor.

Për sa më sipër, vlerësojmë se specifikimi teknik i artikullit nr. 71 nuk është hartuar në përputhje me parimet e konkurrencës efektive dhe prodhon efekt kufizues në treg, duke orientuar procedurën drejt një produkti të vetëm. Kjo situatë pengon pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë ekonomikë dhe kufizon mundësinë e Autoritetit Kontraktor për të përfituar oferta alternative me cilësi të krahasueshme dhe kushte ekonomike potencialisht më të favorshme.

Gjithashtu, përfshirja e këtij produkti në një lot të përbashkët me produkte të tjera krijon efekt bllokues për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në të gjithë lotin, pasi mungesa e aksesit në këtë produkt të vetëm e bën të pamundur paraqitjen e një oferte të plotë. Për këtë arsye, në rast se Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky produkt është klinikisht i domosdoshëm dhe nuk ekzistojnë alternativa të tjera të pranueshme, atëherë ndarja e këtij artikulli në një lot të veçantë përbën zgjidhjen më të përshtatshme për garantimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në pjesën tjetër të procedurës.

Për rrjedhojë, kërkojmë rishikimin e specifikimeve teknike të artikullit nr. 71, formulimin e tyre mbi bazën e funksionit klinik dhe rezultatit terapeutik të kërkuar, pranimin e produkteve funksionalisht ekuivalente që realizojnë të njëjtin qëllim mjekësor dhe, në rast se produkti konsiderohet i domosdoshëm në konfigurimin aktual, ndarjen e tij në një lot më vete, me qëllim garantimin e konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe përdorimit efikas të fondeve publike.

Në lidhje me specifikimet teknike të produktit nr. 73 ? Beze me xhel

Në dokumentet e procedurës së prokurimit, për artikullin nr. 73 është parashikuar si objekt furnizimi produkti: “Beze hidrocoloide me elastomer sintetik, vaj mineral, natrium karboksimetil celulozë vetëngjithëse dhe absorbente, e mbuluar me një shtresë gjysmë të përshkueshme për të parandaluar depërtimin bakterial, që shndërrohet në xhel dhe krijon një mjedis të lagësht për plagën, fleksibël dhe e përshtatshme për vendosje sipas kontureve të trupit, me përmasa 7.5 x 7.5 cm ose ekuivalent.”

Pas analizës së detajuar të specifikimeve teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor konstatuam se kombinimi i karakteristikave të kërkuara përputhet pothuajse në mënyrë të plotë me karakteristikat teknike të produktit Hydrocoll? Classic të prodhuesit Paul Hartmann AG. Përshkrimi i përbërjes me elastomer sintetik, vaj mineral, natrium karboksimetil celulozë, shtresën gjysmë të përshkueshme mbrojtëse, vetitë absorbuese dhe transformimin në xhel përbëjnë një konfigurim teknik shumë specifik, i cili në praktikë identifikon një produkt të caktuar tregtar.

Bashkëlidhur katalogu zyrtar

(<https://www.hartmann.info/en-gb/products/woundcare/hydroactive-wound-dressings/hydrocolloids>

-%E2%80%90beveled-edges/hydrocoll%C2%AE-classic)

Në këtë rast, specifikimi teknik nuk kufizohet në përcaktimin e funksionit klinik që duhet të realizojë produkti, por përfshin karakteristika të hollësishme të teknologjisë dhe përbërjes së produktit, të cilat përkrijnë me një zgjidhje të vetme të disponueshme në treg. Kjo mënyrë formulimi kufizon ndjeshëm mundësinë e ofertimit të produkteve alternative që realizojnë të njëjtin funksion terapeutik nëpërmjet materialeve ose teknologjive të ndryshme.

Megjithëse dokumentet e tenderit përdorin shprehjen “ose ekuivalent”, kombinimi i të gjitha parametrave teknikë të kërkuar e redukton ndjeshëm mundësinë e ofertimit të produkteve të tjera, pasi çdo ndryshim në përbërjen e materialeve ose në teknologjinë e prodhimit mund të konsiderohet si mosplotësim i specifikimeve. Për rrjedhojë, koncepti i ekuivalencës mbetet vetëm formal dhe nuk garanton në praktikë një konkurrencë efektive ndërmjet operatorëve ekonomikë. Nga informacionet e disponueshme në tregun shqiptar rezulton se produktet e Paul Hartmann AG janë të regjistruara dhe të shpërndara në territorin e Republikës së Shqipërisë përmes operatorit ekonomik Vinipharma sh.p.k në të cilën ortak I vetëm rezulton Hervin Fora, i cili është gjithashtu ortak I kompanisë Euromed me 10% të aksioneve. Kjo situatë krijon një kanal të kufizuar furnizimi për këtë kategori produktesh dhe kufizon mundësinë e operatorëve të tjerë ekonomikë për të siguruar produktin e kërkuar.

Për pasojë, operatorët ekonomikë që nuk disponojnë akses në këtë linjë produktesh ndodhen në pamundësi objektive për të ofertuar produktin e kërkuar. Kjo situatë krijon një avantazh konkurrues për operatorin ekonomik që ka akses në produktin konkret dhe redukton ndjeshëm pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë në procedurë.

Legjislacioni i prokurimit publik kërkon që specifikimet teknike të hartohen mbi bazën e nevojës funksionale dhe rezultatit klinik që synon të arrijë Autoriteti Kontraktor, duke shmangur përshkrimet teknike që çojnë në identifikimin e një marke, prodhuesi ose teknologjie të caktuar. Parimet e konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë,

proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit kërkojnë që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë mundësi reale pjesëmarrjeje në procedurë.

Ne propozojmë si alternativë funksionalisht ekuivalente një beze hidrocoloide pa xhelatinë, me material mbështetës prej poliuretani gjysmë të përshkueshëm, rezistent ndaj baktereve dhe viruseve, e cila shndërrohet në xhel gjatë kontaktit me eksudatin dhe krijon një mjedis të lagësht për plagën, duke qenë fleksibël dhe e përshtatshme për vendosje sipas kontureve të trupit, me përmasa 7.5 x 7.5 cm.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik rezulton se produkti i ofertuar përmbush karakteristikat thelbësore funksionale të produktit të kërkuar në specifikimet e tenderit. Të dy produktet i përkasin kategorisë së mbulesave hidrokolloide për trajtimin e plagëve, janë vetëngjitëse dhe absorbuese, krijojnë një mjedis të lagësht që favorizon procesin e shërimit të plagës dhe ofrojnë mbrojtje ndaj kontaminimit të jashtëm. Të dy produktet përdoren për të njëjtat indikacione klinike dhe realizojnë të njëjtin qëllim terapeutik.

Koncepti i ekuivalencës në prokurimin publik nuk kërkon identitet absolut të përbërjes kimike, të materialeve apo të teknologjisë së prodhimit, por kërkon që produkti alternativ të realizojë të njëjtin funksion klinik dhe të sigurojë të njëjtin rezultat terapeutik. Për rrjedhojë, ndryshimet në përbërjen e materialeve nuk duhet të përbëjnë shkak për përjashtimin e produkteve që plotësojnë të njëjtin qëllim mjekësor.

Për sa më sipër, vlerësojmë se specifikimi teknik i artikullit nr. 73 nuk është hartuar në përputhje me parimet e konkurrencës efektive dhe prodhon efekt kufizues në treg, duke orientuar procedurën drejt një produkti të vetëm. Kjo situatë pengon pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë ekonomikë dhe kufizon mundësinë e Autoritetit Kontraktor për të përfituar oferta alternative me cilësi të krahasueshme dhe kushte ekonomike potencialisht më të favorshme.

Për rrjedhojë, kërkojmë rishikimin e specifikimeve teknike të artikullit nr. 73, formulimin e tyre mbi bazën e funksionit klinik dhe rezultatit terapeutik të kërkuar, si dhe pranimin e produkteve funksionalisht ekuivalente që realizojnë të njëjtin qëllim mjekësor nëpërmjet teknologjive të ndryshme. Vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet një procedurë prokurimi e hapur, konkurruese dhe në përputhje me parimet e legjislacionit të prokurimit publik.

Në lidhje me specifikimet teknike për produktin nr. 74 ? Beze silikon

Në dokumentet e procedurës së prokurimit, për artikullin nr. 74 është përcaktuar si objekt furnizimi produkti “Beze silikon sterile, e butë dhe e përshkueshme, e bërë nga një rrjetë polietileni tereftalat (PET), e veshur në të dyja anët me xhel silikon me bazë polidimetilsiloksani, me peshë totale 224±272 g/m<sup>2</sup>, peshë të xhelit 180±220 g/m<sup>2</sup>, hapje poreve jo më pak se 96%, me përmasa 7.5 x 10 cm ose ekuivalent”.

Pas shqyrtimit të detajuar të specifikimeve teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor konstatuam se kombinimi i karakteristikave të kërkuara përputhet në mënyrë pothuajse të plotë me karakteristikat teknike të produktit Atrauman® Silicone të prodhuesit Paul Hartmann AG. Përshkrimi i materialit bazë PET, veshja në të dyja anët me xhel silikon, parametrat e përcaktuar të peshës së xhelit dhe peshës totale, si dhe kërkesa për përqindjen minimale të hapjes së poreve, përbëjnë një konfigurim teknik tepër specifik, i cili në praktikë identifikon një produkt të caktuar tregtar. Bashkëlidhur katalogu zyrtar

(<https://www.hartmann.info/en-au/products/wound-management/contact-layers/non-impregnated-co ntact-layers/atrauman%C2%AE-silicone>)

Specifikimet e hartuara nuk kufizohen vetëm në përcaktimin e funksionit klinik që duhet të realizojë produkti, por përfshijnë karakteristika të detajuara të materialeve, strukturës dhe parametrave fizikë, të cilat përkojnë me teknologjinë e një prodhuesi të vetëm. Një formulim i tillë redukton ndjeshëm mundësinë e ofertimit të produkteve të tjera që realizojnë të njëjtin funksion terapeutik nëpërmjet teknologjive ose parametrave teknikë të ndryshëm.

Nga informacionet e disponueshme në tregun shqiptar rezulton se produktet e kompanisë Paul Hartmann AG janë të regjistruara dhe të shpërndara në Republikën e Shqipërisë përmes operatorit ekonomik Vinipharma sh.p.k., në të cilën ortak I vetëm rezulton Hervin Fora, i cili është gjithashtu ortak I kompanisë Euromed me 10% të aksioneve. Për pasojë, aksesit në këtë kategori produktesh paraqitet i kufizuar për operatorët e tjerë ekonomikë, të cilët nuk disponojnë mundësi reale furnizimi me këto produkte.

Si rrjedhojë, operatorët ekonomikë të tjerë ndodhen në një pamundësi objektive për të ofertuar produktin konkret të identifikuar nga specifikimet teknike, duke krijuar një avantazh konkurrues për subjektet që kanë akses në këtë linjë produktesh. Kjo situatë kufizon pjesëmarrjen në procedurë dhe cenon parimet e konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit të përcaktuara në legjislacionin e prokurimit publik. Legjislacioni i prokurimit publik kërkon që Autoriteti Kontraktor të përcaktojë nevojën funksionale dhe rezultatit klinik që synon të arrijë, pa identifikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë një markë, prodhues apo teknologji të caktuar. Përfshirja e parametrave shumë të detajuar teknikë që përkojnë me një produkt të vetëm ka si efekt praktik kufizimin e konkurrencës dhe reduktimin e numrit të operatorëve ekonomikë që mund të marrin pjesë në procedurë.

Ne propozojmë si alternativë funksionalisht ekuivalente një beze silikonit sterile, të butë dhe të përshkueshme, të përbërë nga një rrjetë polietileni tereftalat (PET) e veshur në të dyja anët me xhel silikonit, me peshë të xhelit 190-210 g/m<sup>2</sup> dhe me përmasa 7.5 x 10 cm. Produkti i ofertuar i përket të njëjtës kategori të shtresave të kontaktit për plagët dhe realizon të njëjtin funksion terapeutik dhe klinik.

Nga pikëpamja funksionale dhe teknike, produkti i ofruar siguron përshkueshmëri optimale të eksudatit drejt fashës absorbuese, duke kontribuar në parandalimin e macerimit të lëkurës përreth plagës. Teknologjia e silikonit të butë mjekësor mundëson një kontakt atraumatik me plagën dhe garanton heqjen e fashaturës me dëmtim minimal të indeve të reja dhe me reduktim të dhimbjes për pacientin. Gjithashtu, produkti ofron fleksibilitet të lartë, përshtatet me konturet anatomike të trupit dhe mund të përdoret në mënyrë efektive për periudha të zgjatura klinike.

Produkti i ofertuar përmbush të njëjtin qëllim terapeutik si produkti i kërkuar në dokumentet e tenderit dhe përdoret për të njëjtat indikacione klinike në trajtimin e plagëve akute dhe kronike. Ndryshimet e mundshme në disa parametra teknikë nuk ndikojnë në performancën klinike dhe nuk cenojnë funksionin e produktit.

Koncepti i ekuivalencës në prokurimin publik nuk kërkon identitet absolut të materialeve, parametrave fizikë apo teknologjisë së prodhimit, por kërkon që produkti alternativ të realizojë të njëjtin funksion klinik dhe të sigurojë të njëjtin rezultat terapeutik. Për këtë arsye, ndryshimet në karakteristikat dytësore teknike nuk duhet të përbëjnë shkak për përjashtimin e produkteve që përmbushin të njëjtin qëllim mjekësor.

Për sa më sipër, vlerësojmë se specifikimet teknike të artikullit nr. 74 nuk janë hartuar në përputhje me parimet e konkurrencës efektive dhe prodhojnë efekt kufizues në treg, duke orientuar procedurën drejt një produkti të vetëm. Kjo situatë pengon pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë ekonomikë dhe kufizon mundësinë e Autoritetit Kontraktor për të përfituar oferta alternative me cilësi të krahasueshme dhe kushte ekonomike potencialisht më të favorshme.

Për rrjedhojë, kërkojmë rishikimin e specifikimeve teknike të artikullit nr. 74, formulimin e tyre mbi bazën e funksionit klinik dhe rezultatit terapeutik të kërkuar, si dhe pranimin e produkteve funksionalisht ekuivalente që realizojnë të njëjtin qëllim mjekësor. Vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet një procedurë prokurimi e hapur, konkurruese dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik.

*Në lidhje me specifikimet teknike për produktin nr. 75 ? Set Dekompresimi dhe Drenazhimi për Ileus*

*Në dokumentet e procedurës së prokurimit, për artikullin nr. 75 është parashikuar si objekt furnizimi “Set Dekompresimi dhe Drenazhimi transanal për ileus”, me dilatator për zgjerimin gradual të stenozës me përmasa 26 Fr deri 28 Fr dhe gjatësi 100?150 cm, tub drenazhi 22 Fr deri 24 Fr me gjatësi 120?140 cm, me majë të hapur dhe minimumi katër hapje anësore për aspirim, balon me kapacitet 30?40 ml, konektor me dy kanale për irigim dhe drenazh, si dhe unaza radio-opake të vendosura në të dy skajet e balonës për lokalizim radiologjik nëpërmjet radiografisë ose fluoroskopisë”.*

*Nga analiza e specifikimeve teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor rezulton se kombinimi i parametrave të kërkuar përputhet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pothuajse të plotë me konfigurimin teknik të produktit të prodhuar nga Create Medic. Bashkëlidhur katalogu zyrtar ([https://www.createmedic.co.jp/english/products\\_detail/id=438](https://www.createmedic.co.jp/english/products_detail/id=438) ) Përputhja e njëkohshme e diametrave, gjatësive, kapacitetit të balonit, numrit të hapjeve anësore, pozicionit të unazave radiopake dhe karakteristikave të sistemit të drenazhimit përbën një konfigurim tepër të detajuar teknik, i cili në praktikë identifikon një produkt të vetëm në treg. Specifikimet e hartuara nuk kufizohen në përcaktimin e funksionit klinik të pajisjes, por përfshijnë elemente të veçanta të dizajnit dhe konfigurimit teknik që lidhen me një model të caktuar prodhimi. Parametra të tillë si numri minimal i hapjeve anësore, vendosja e unazave radiopake në të dy skajet e balonit apo kombinimi i saktë i diametrave dhe gjatësive nuk përbëjnë domosdoshmëri klinike universale, por karakteristika specifike të një produkti të caktuar.*

*Në praktikën klinike të dekompressionit intestinal nuk ekzistojnë standarde të detyrueshme që kërkojnë një numër të caktuar hapjesh anësore, një pozicion të përcaktuar të unazave radiopake apo kombinime fikse të dimensioneve dhe kapaciteteve të balonit. Këto elemente përfaqësojnë zgjedhje teknike të prodhuesit dhe jo kërkesa të domosdoshme për realizimin e funksionit terapeutik të pajisjes.*

*Nga analiza e tregut rezulton se vetëm një prodhues përmbush në mënyrë të plotë të gjithë parametrat teknikë të kërkuar, konkretisht Create Medic. Për pasojë, edhe pse në mënyrë formale është përdorur shprehja “ose ekuivalent”, struktura e specifikimeve është aq e detajuar dhe e ngushtë sa që mundësia e ofertimit të produkteve ekuivalente bëhet praktikisht e pamundur. Në këto kushte, koncepti i ekuivalencës mbetet vetëm formal dhe nuk garanton konkurrencë reale ndërmjet operatorëve ekonomikë.*

*Nga informacionet e disponueshme në tregun shqiptar rezulton se produktet e Create Medic shpërndahen nëpërmjet operatorëve të autorizuar që disponojnë akses në këtë linjë produktesh. Verifikimet pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore tregojnë se produktet e këtij prodhuesi janë të regjistruara në tregun vendas, ndërsa operatorët e tjerë ekonomikë nuk disponojnë mundësi reale furnizimi me këtë produkt. Si rrjedhojë, specifikimi aktual krijon një avantazh konkurrues indirekt për operatorët që disponojnë akses në zinxhirin e furnizimit të këtij prodhuesi.*

*Kjo situatë krijon një efekt praktik të kufizimit të konkurrencës, pasi aksesit në produktin e kërkuar realizohet përmes një burimi të vetëm furnizimi, ndërsa hyrja në treg e produkteve alternative bëhet tepër e vështirë ose e pamundur për shkak të përputhjes së ngushtë të specifikimeve me një model të vetëm tregtar. Një avantazh i tillë strukturor bie ndesh me parimet e konkurrencës së lirë dhe të hapur, të përcaktuara në legjislacionin e prokurimit publik.*

*Sipas parimeve themelore të prokurimit publik, specifikimet teknike duhet të formulohen në mënyrë neutrale, të mos favorizojnë një prodhues të vetëm dhe të lejojnë pjesëmarrje reale dhe efektive të operatorëve ekonomikë. Në rastin konkret, kombinimi i specifikimeve të*

detajuara teknike dhe ekzistenca e një zinxhiri të kufizuar furnizimi krijojnë efektin praktik të kufizimit të konkurrencës, edhe pse marka e produktit nuk përmendet në mënyrë të drejtpërdrejtë në dokumentet e tenderit.

Gjithashtu, konstatuam se për këtë artikull është parashikuar një sasi tepër e kufizuar, konkretisht vetëm katër copë për nevojat e sistemit spitalor në nivel kombëtar. Ky fakt ka rëndësi të veçantë në vlerësimin e proporcionalitetit të specifikimeve teknike, pasi një volum kaq i vogël furnizimi nuk justifikon vendosjen e kriterëve kaq të detajuara dhe kufizuese.

Për një sasi minimale, autoriteti kontraktor duhet të synojë zgjerimin e konkurrencës dhe jo kufizimin e saj. Specifikimet tepër të ngushta për një numër kaq të vogël pajisjesh krijojnë një efekt disproporcional në raport me objektin e kontratës dhe rrisin rrezikun e mospjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, duke reduktuar eficiencën e përdorimit të fondeve publike.

Në këto kushte, formulimi aktual i specifikimeve teknike nuk garanton një procedurë prokurimi të hapur, transparente dhe konkurruese, por krijon varësi nga një zinxhir i vetëm furnizimi dhe kufizon pjesëmarrjen reale të operatorëve ekonomikë.

Për sa më sipër, vlerësojmë se artikulli nr. 75 duhet të trajtohet si një lot më vete, i ndarë nga artikujt e tjerë të procedurës, me qëllim që të shmanget kombinimi i padrejtë i produkteve me treg dhe karakteristika të ndryshme, të rritet pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë të specializuar, të garantohet konkurrenca reale dhe efektive, të sigurohet përdorimi efikas i fondeve publike dhe të shmanget varësia nga një burim i vetëm furnizimi.

Vetëm nëpërmjet rishikimit të specifikimeve teknike dhe ndarjes së këtij artikulli në një lot të veçantë mund të garantohet respektimi i parimeve të konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe transparencës, duke krijuar kushte të barabarta pjesëmarrjeje për të gjithë operatorët ekonomikë.

Në lidhje me specifikimet teknike për produktin numër 119 ? Soturë sintetike e absorbueshme nga 90?110 ditë, USP 3-0

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit dhe analizës së specifikimeve teknike të përcaktuara për artikullin nr. 119, konstatuam se kërkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktor përputhen në mënyrë pothuajse të plotë me karakteristikat teknike të produktit V-Loc? 90 të prodhuar nga Medtronic. Kombinimi i përbërjes së materialit, kohës së absorbimit, strukturës së fijes me luspa njëdrejtimëshe përgjatë gjithë trupit të saj, pranisë së lakut në fund të fijes, si dhe parametrave të tjerë teknikë të kërkuar, çon në identifikimin praktik të një produkti të vetëm në treg.

Nga verifikimet e kryera rezulton se Medtronic është aktualisht prodhuesi i vetëm që ofron këtë konfigurim specifik teknik, çka bën që specifikimet e hartuara të kenë efekt kufizues mbi konkurrencën dhe të reduktojnë ndjeshëm mundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve të tjerë ekonomikë. Në tregun shqiptar produktet Medtronic tregtohen përmes distributorit zyrtar OES Distrimed, ndërsa përpjekjet tona të përsëritura për të siguruar informacion, ofertim apo mundësi furnizimi përmes këtij operatori nuk kanë rezultuar efektive, duke krijuar një situatë objektive pamundësie për pjesëmarrje në procedurë.

Në këto kushte, formulimi aktual i specifikimeve teknike krijon një varësi të drejtpërdrejtë nga një prodhues dhe një kanal i vetëm furnizimi, duke kufizuar konkurrencën reale dhe duke vendosur operatorët e tjerë ekonomikë në pozita të pabarabarta. Ky efekt bie në kundërshtim me parimet e konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të përcaktuara në legjislacionin për prokurimin publik.

Në vijim propozojmë një produkt funksionalisht ekuivalent me karakteristikat: soturë sintetike e absorbueshme nga 180?220 ditë, USP 3-0, me përbërje glikolid, dioksanon dhe trimetilen karbonat ose poli(p-dioksanon) ekuivalent, me strukturë njëdrejtimëshe me luspa përgjatë trupit të fijes, me lak në fund, gjatësi 23 cm, age 5/8, 27 mm, taper point.

Produkti i propozuar përmbush të njëjtin funksion klinik dhe terapeutik si produkti i kërkuar në dokumentet e tenderit. Parametrat thelbësorë teknikë, si dimensionin USP 3-0, gjatësia e

fijes, tipi i agës dhe mekanizmi i vetëfiksimit, mbeten të njëjtë dhe garantojnë të njëjtën performancë kirurgjikale. Diferenca në kohën e absorbimit nuk ndikon negativisht në sigurinë apo efikasitetin klinik të produktit dhe, në disa indikacione kirurgjikale, një periudhë më e gjatë absorbimi mund të përbëjë avantazh funksional për ruajtjen e mbështetjes së indeve.

Gjithashtu, ndryshimet në përbërjen e materialeve nuk ndikojnë funksionin bazë të suturës, pasi në të dy rastet bëhet fjalë për polimere sintetike të absorbueshme, monofilament, të cilat degradohen nëpërmjet procesit të hidrolizës dhe janë projektuar për të njëjtin përdorim klinik. Për rrjedhojë, produkti i propozuar përmbush të njëjtin qëllim funksional dhe terapeutik si produkti i kërkuar dhe duhet të konsiderohet teknikisht dhe klinikisht ekuivalent. Në këto kushte, Autoriteti Kontraktor duhet të rishikojë formulimin e specifikimeve teknike duke u bazuar në kërkesat funksionale dhe klinike të produktit dhe jo në karakteristika që identifikojnë një prodhues të vetëm. Pranimi i produkteve ekuivalente garanton konkurrencë reale dhe efektive, zgjeron pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe siguron përdorimin sa më efikas të fondeve publike, në përputhje me parimet e përcaktuara në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Në lidhje me specifikimet teknike për produktet me numër 120, 121, 122 dhe 123 ? Sutura sintetike të absorbueshme me luspa (barbed sutures)

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit dhe analizës së specifikimeve teknike të përcaktuara për artikujt nr. 120, 121, 122 dhe 123, konstatojmë se kombinimi i karakteristikave teknike të kërkuara korrespondon praktikisht me një linjë të vetme produktesh të prodhuara nga kompania Medtronic. Kërkesat për absorbim afatgjatë rreth 180 ditë, përbërjen me kopolimer të acidit glikolik dhe karbonatit të trimetilenit, strukturën me luspa njëdrejtimëshe përgjatë gjithë trupit të fijes, praninë e lakut në fund të saj, si dhe konfigurimet specifike të gjatësisë, madhësisë USP dhe tipit të agës, krijojnë një kombinim teknik që identifikon në praktikë një produkt të vetëm në treg.

Në mbështetje të këtij konstatimi, kompania jonë ka zhvilluar komunikime me prodhues ndërkombëtarë të specializuar në prodhimin e suturave kirurgjikale, përfshirë kompani të njohura të sektorit, të cilat kanë konfirmuar se produktet me këto karakteristika teknike identifikohen si produkte specifike të Medtronic. Këto komunikime dokumentojnë faktin se specifikimet aktuale nuk përfaqësojnë një standard të hapur tregu, por përkojnë me një konfigurim të veçantë prodhuesi.

Nga verifikimet e kryera në regjistrin zyrtar të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve

Mjekësore rezulton se produktet përkatëse të Medtronic janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë nga operatori ekonomik OES Distrimed, i cili vepron si distributor zyrtar për territorin shqiptar. Gjithashtu, përpyekjet tona të përsëritura për të kontaktuar drejtpërdrejt kompaninë Medtronic me qëllim sigurimin e aksesit në produkt, marrjen e ofertave apo krijimin e mundësive të furnizimit, nuk kanë sjellë asnjë përgjigje zyrtare. Kjo situatë demonstroi në praktikë pamundësinë reale të operatorëve të tjerë ekonomikë për të siguruar produktin jashtë kanalit ekzistues të furnizimit.

Në këto kushte rezulton se specifikimet teknike të hartuara nuk përfaqësojnë një standard të përgjithshëm teknik apo funksional, por çojnë objektivisht në identifikimin e një produkti të vetëm, të një prodhuesi të vetëm dhe të një distributori të vetëm në tregun shqiptar. Për pasojë, formulimi aktual i specifikimeve krijon kufizim të konkurrencës dhe vendos operatorët e tjerë ekonomikë në kushte të pabarabarta pjesëmarrjeje.

Gjithashtu, duhet të merret në konsideratë fakti se për këta artikuj janë kërkuar sasi relativisht të kufizuara në raport me produktet e tjera të ngjashme të përfshira në procedurë. Ky element tregon se nevoja reale e furnizimit është e kufizuar dhe se vendosja e specifikimeve tepër të ngushta për produkte të tilla krijon një efekt disproporcional mbi

konkurrencën. Në praktikë, përfshirja e një produkti ekskluziv me sasi të kufizuara mund të sjellë skualifikimin e operatorëve ekonomikë që janë në gjendje të furnizojnë pjesën dërrmuese të artikujve të tenderit, por që nuk kanë mundësi objektive të sigurojnë një produkt të kontrolluar nga një kanal i vetëm furnizimi.

Nga ana tjetër, ekzistojnë produkte të tjera në tregun ndërkombëtar që realizojnë të njëjtin funksion klinik dhe kirurgjikal. Kompania jonë ka kontaktuar prodhues të tjerë të specializuar në sutura kirurgjikale, të cilët kanë konfirmuar disponueshmërinë e suturave monofilament të absorbueshme me luspa, të bazuara në Polydioxanone (PDO), të cilat ofrojnë të njëjtin mekanizëm kirurgjikal të mbylljes pa nyje, të njëjtën mbështetje afatgjatë të indeve dhe të njëjtin funksion klinik.

Këto produkte i përjashtojnë kategoritë funksionale të suturave absorbuese monofilament me luspa për mbyllje kirurgjikale pa nyje dhe karakterizohen nga absorbimi afatgjatë, strukturë njëdrejtimëshe ose dykahëshe të luspave, mundësi konfigurimi me lak në fund dhe përdorim në indikacione të krahasueshme kirurgjikale. Diferencat që lidhen me përbërjen e polimerit ose me profilin e degradimit nuk ndikojnë funksionin bazë kirurgjikal të produktit dhe përfaqësojnë variacione të pranueshme teknike brenda së njëjtës kategori funksionale.

Sa i përket kërkesës për gjatësi të caktuara të fijes, prodhuesit alternativë kanë sqaruar se konfigurimet standarde të disponueshme mund të ndryshojnë në disa milimetra apo centimetra, por këto diferenca nuk ndikojnë funksionin klinik të produktit, sigurinë e pacientit apo performancën kirurgjikale.

Për rrjedhojë, ekzistenca e produkteve ekuivalente që realizojnë të njëjtin funksion klinik dhe terapeutik demonstroi se Autoriteti Kontraktor duhet të lejojë produkte ekuivalente dhe të mos kufizojë specifikimet teknike vetëm në konfigurimin specifik të produktit Medtronic.

Si alternativë teknike dhe funksionale propozojmë që specifikimet të riformulohen duke lejuar sutura sintetike të absorbueshme me profil absorbimi 180-210 ditë, me përbërje Polydioxanone (PDO) ose materiale ekuivalente, me luspa në një drejtim përgjatë trupit të fijes, me lak në fund, si dhe me parametrat përkatës të madhësisë USP, tipit të agës dhe gjatësisë së fijes sipas nevojave klinike.

Produkti i propozuar përmbush të njëjtin funksion kirurgjikal, të njëjtin qëllim terapeutik dhe të njëjtat kërkesa klinike si produktet e kërkuara në dokumentet e tenderit dhe duhet të konsiderohet teknikisht dhe funksionalisht ekuivalent.

Për më tepër, Komisioni i Prokurimit Publik, me Vendimin nr. 800/2026, datë 15.06.2026, lidhur me procedurën e prokurimit me nr. reference REF-84346-05-05-2026, me objekt “Blerje materiale konsumi mjekësore e ndarë në lote për nevoja të Spitalit Rajonal Shkodër”, ka pranuar pretendimet e operatorit ekonomik për produkte të ngjashme të kategorisë së suturave sintetike të absorbueshme me luspa dhe ka urdhëruar modifikimin e specifikimeve teknike duke lejuar formulimin “ose ekuivalent”. Ky vendim përbën një precedent administrativ të rëndësishëm, i cili konfirmon se specifikime të tilla nuk duhet të kufizohen në një konfigurim të vetëm prodhuesi kur ekzistojnë produkte të tjera që realizojnë të njëjtin funksion klinik.

Në këto kushte, kërkojmë rishikimin dhe riformulimin e specifikimeve teknike për artikujt nr. 120, 121, 122 dhe 123 mbi bazën e kërkesave funksionale dhe klinike, duke eliminuar elementet që identifikojnë një prodhues të vetëm dhe duke garantuar pranimin e produkteve ekuivalente. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet një procedurë prokurimi e hapur, konkurruese dhe në përputhje me parimet e barazisë, proporcionalitetit dhe konkurrencës së lirë të parashikuara në legjislacionin për prokurimin publik.

Në lidhje me specifikimet teknike për produktet nr. 157, 158 dhe 159, MESH PVDF/PP, MESH PVDF dhe MESH PVDF Hiatus konstatuam se kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit përputhen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pothuajse ekskluzive me produktet DynaMesh? të prodhuara nga FEG Textiltechnik GmbH, Gjermani.

Për produktin nr. 157, kërkesa për mesh me përbërje 88% PVDF dhe 12% polypropylene (PP), në përmasat 10 x 15 cm, korrespondon me produktet DynaMesh?, të cilat prodhohen vetëm nga FEG Textiltechnik GmbH. Po kështu, për produktin nr. 158, kërkesa për mesh monofilament PVDF për korrigjimin kirurgjikal të inkontinencës urinare me përmasa 0.1 x 50 cm, si dhe për produktin nr. 159, kërkesa për mesh monofilament PVDF për korrigjimin kirurgjikal të hernieve hiatale dhe paraezofageale me përmasa 0.7 x 12 cm, përputhen drejtpërdrejt me produktet DynaMesh? SIS dhe DynaMesh? HIATUS.

Nga verifikimet e kryera rezulton se produktet DynaMesh? janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe distributori i autorizuar për territorin shqiptar është shoqëria Euromed sh.p.k. Ky fakt rezulton si nga të dhënat e regjistrimit të AKBPM, ashtu edhe nga informacioni i publikuar në faqen zyrtare të prodhuesit. (<https://en.dyna-mesh.com/distribution-gb/>)

Pavarësisht përpjekjeve tona për të kontaktuar prodhuesin dhe për të siguruar mundësi furnizimi, nuk kemi marrë përgjigje apo ofertë konkrete, çka demonstroi në praktikë mungesën e aksesit të operatorëve të tjerë ekonomikë në këto produkte jashtë kanalit të autorizuar të shpërndarjes.

Në rastin konkret, kërkesa për materialin specifik PVDF nuk përbën një domosdoshmëri klinike të provuar, por përfaqëson një karakteristikë teknologjike të një prodhuesi të caktuar. Për produktin nr. 157, përdorimi i mesh-eve 100% polypropylene përbën praktikën më të përhapur ndërkombëtare në kirurgjinë e hernieve dhe të murit abdominal, me siguri dhe efikasitet të dokumentuar gjerësisht në literaturën shkencore dhe praktikën klinike.

Gjithashtu, për produktet nr. 158 dhe 159, nga verifikimet e kryera rezulton se prodhues të tjerë ndërkombëtarë ofrojnë produkte me funksion të ngjashëm klinik, të bazuara në materiale alternative si polypropylene apo materiale të tjera sintetike, të cilat përdoren për të njëjtat indikacione kirurgjikale. Megjithatë, edhe këto produkte në tregun shqiptar shpërndahen përmes distributorëve ekskluzivë, gjë që kufizon më tej mundësinë e sigurimit të tyre nga operatorë të tjerë ekonomikë.

Një element tjetër i rëndësishëm është edhe sasia shumë e ulët e kërkuar për produktin nr. 159, konkretisht vetëm 19 copë. Një volum kaq i kufizuar nuk justifikon vendosjen e specifikimeve teknike tepër të detajuara dhe të orientuara drejt një produkti të vetëm. Përkundrazi, për sasi të tilla minimale duhet të favorizohet zgjerimi i konkurrencës dhe jo kufizimi i saj.

Në praktikë, përfshirja e produkteve ekskluzive, të disponueshme vetëm përmes një prodhuesi dhe një distributori të vetëm, brenda të njëjtit lot me artikuj të tjerë krijon efekt bllokues për operatorët ekonomikë, pasi pamundësia për të siguruar këto pak artikuj çon automatikisht në pamundësinë e ofertimit për të gjithë lotin.

Për rrjedhojë, specifikimet aktuale kufizojnë konkurrencën reale, krijojnë avantazh të padrejtë konkurrues për operatorin ekonomik që disponon aksesin ekskluziv në këto produkte dhe bien ndesh me parimet e konkurrencës së lirë, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të parashikuara nga Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet të respektojë parimet themelore të barazisë në trajtim, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë, duke shmangur hartimin e specifikimeve teknike që çojnë në favorizimin e një marke, prodhuesi apo operatori ekonomik të caktuar.

Duke qenë se produktet nr. 157, 158 dhe 159 identifikojnë praktikisht produkte të një prodhuesi të vetëm, furnizimi i tyre lidhet me një kanal të vetëm të autorizuar dhe mungesa e aksesit në këto produkte pengon pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë ekonomikë, kërkojmë që këta artikuj të ndahen në një LOT të veçantë.

Ndarja në lot më vete përbën zgjidhjen më proporcionale dhe më pak kufizuese për konkurrencën, duke garantuar njëkohësisht furnizimin e autoritetit kontraktor me produktet specifike që ai konsideron të nevojshme, pa cenuar pjesëmarrjen e lirë dhe konkurrencën efektive për pjesën tjetër të procedurës së prokurimit.

Në lidhje me specifikimet teknike për produktin nr. 165 Stapler rrethor 25mm / 28mm / 31mm, konstatuam se kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit përputhen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pothuajse ekskluzive me produktin EEA? Circular Stapler ëith DST Series? Technology të prodhuar nga kompania Medtronic/Covidien.

Nga verifikimi i katalogëve zyrtarë të prodhuesit rezulton se parametrat e kërkuar, konkretisht diametrat 25 mm, 28 mm dhe 31 mm, gjatësia e boshtit 22 cm, kapëset me lartësi 4.8 mm dhe mekanizmi Tilt-Top anvil, korrespondojnë me karakteristikat teknike të kësaj linje produktesh të Medtronic. Për rrjedhojë, formulimi aktual i specifikimeve identifikon në praktikë një produkt të vetëm dhe një prodhues të vetëm.

Nga verifikimi i regjistrimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore rezulton se gama e produkteve EEA? Circular Stapler with DST Series është e regjistruar me numrin identifikues 16530 nga operatori ekonomik OES Distrimed, i cili rezulton distributori i autorizuar për këto produkte në territorin e Republikës së Shqipërisë. Bashkëlidhur katalogu zyrtar (chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://www.medtronic.com/content/dam/medtronic-wide/public/western-europe/products/surgical-stapling/surgical-stapling-eea-dst-series-broc-hure-fr-fr.pdf )

Kompania jonë ka kryer tentativa të përsëritura për të kontaktuar kompaninë Medtronic dhe përfaqësuesit e saj me qëllim sigurimin e mundësisë së furnizimit dhe bashkëpunimit për produktin në fjalë. Megjithatë, pavarësisht kërkesave dhe komunikimeve të vazhdueshme, nuk kemi marrë asnjë përgjigje apo mundësi bashkëpunimi, çka demonstroi në praktikë mungesën e aksesit të operatorëve të tjerë ekonomikë në këtë produkt jashtë kanalit të autorizuar të shpërndarjes.

Në këto kushte, specifikimet aktuale krijojnë një kufizim objektiv të konkurrencës, pasi furnizimi dhe tregtimi i produktit lidhet drejtpërdrejt me një distributor të vetëm, duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë ekonomikë në procedurën e prokurimit.

Ndërkohë, në treg ekzistojnë prodhues të tjerë ndërkombëtarë të staplerëve kirurgjikalë me certifikime CE dhe MDR, të cilët ofrojnë produkte funksionalisht ekuivalente, por që përjashtohen nga procedura për shkak të parametrave tepër specifike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në vijim propozojmë një produkt funksionalisht ekuivalent:

165 Stapler rrethor 25 mm / 28 mm / 31 mm Stapler njëpërdorimësh rrethor 29 mm, me gjatësi boshti 22.65 cm, me kapëse 4.8 mm në formë B dhe anvil të fiksuar.

Produkti i propozuar realizon të njëjtin funksion kirurgjikal dhe të njëjtin qëllim klinik si produkti i kërkuar në dokumentet e tenderit. Diferenca në gjatësinë e boshtit prej 22.65 cm kundrejt 22 cm nuk ndikon në mekanizmin e anastomozës, në formimin e kapëseve, në presionin e mbylljes apo në integritetin e vijës së anastomozës.

Përkundrazi, gjatësia më e madhe e boshtit mundëson fleksibilitet më të madh operacional dhe lehtëson aksesin në zona anatomike më të thella, pa kufizuar përdorimin në procedurat standarde kirurgjikale. Gjithashtu, ndryshimi ndërmjet mekanizmit tilt dhe anvilit të fiksuar përbën një karakteristikë të dizajnit të prodhuesit dhe jo një kërkesë thelbësore klinike apo funksionale.

Për rrjedhojë, produkti i propozuar përmbush të njëjtin funksion terapeutik dhe kirurgjikal, garanton të njëjtin nivel sigurie dhe efikasiteti klinik dhe duhet të konsiderohet teknikisht ekuivalent me produktin e kërkuar.

Specifikimet aktuale, ashtu siç janë formuluar, favorizojnë një produkt dhe një distributor të vetëm, kufizojnë konkurrencën reale dhe bien ndesh me parimet e konkurrencës së lirë, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të parashikuara nga Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet të respektojë parimet themelore të barazisë në trajtim, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë, duke shmangur hartimin e specifikimeve teknike që çojnë në favorizimin e një marke, prodhuesi apo operatori ekonomik të caktuar.

Për këtë arsye kërkojmë rishikimin e specifikimeve teknike, heqjen e parametrave identifikues që korrespondojnë me një produkt të vetëm dhe formulimin e kërkesave mbi bazën e karakteristikave funksionale dhe klinike, duke lejuar ofertimin e produkteve ekuivalente.

Për më tepër, Komisioni i Prokurimit Publik, me Vendimin nr. 800/2026, datë 15.06.2026, lidhur me procedurën e prokurimit me nr. reference REF-84346-05-05-2026, me objekt “Blerje materiale konsumi mjekësore e ndarë në lote për nevoja të Spitalit Rajonal Shkodër”, ka pranuar pjesërisht pretendimet e operatorit ekonomik për këtë produkt dhe ka urdhëruar ndryshimin e parametrave teknikë të kërkuar.

Ky vendim përbën precedent administrativ që konfirmon se specifikimet teknike nuk duhet të kufizohen në konfigurimin e një produkti të vetëm kur ekzistojnë produkte të tjera që realizojnë të njëjtin funksion klinik dhe kirurgjikal.

Në lidhje me specifikimet teknike për produktin nr. 166 Stapler Endoskopie Stapler njëpërdorimësh i rikarikueshëm, gjatësia e boshtit 16cm dhe 6cm, artikulacion +/-45 gradë dhe me 11 pozicione, konstatohet se kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit për staplerin endoskopik përmbajnë një karakteristikë teknike që nuk rezulton të jetë e verifikueshme në tregun ndërkombëtar të pajisjeve kirurgjikale.

Nga verifikimi i kryer në katalogët zyrtarë të prodhuesve ndërkombëtarë të staplerëve endoskopikë rezulton se nuk identifikohet asnjë produkt që ofron artikulum me 11 pozicione, siç kërkohet në specifikimet teknike të tenderit. Ky parametër nuk evidentohet në dokumentacionet teknike të prodhuesve dhe, për rrjedhojë, përbën një karakteristikë të paqartë, të paverifikueshme dhe potencialisht kufizuese për konkurrencën.

Përdorimi i një karakteristike teknike që nuk rezulton të ekzistojë në produktet e disponueshme në treg cenon parimin e hartimit të specifikimeve të qarta, të sakta dhe të verifikueshme, siç parashikohet nga legjislacioni i prokurimit publik. Në këto kushte, kërkesa për 11 pozicione artikulimi nuk mbështetet në standarde të njohura teknike apo klinike dhe nuk paraqet një avantazh funksional të provuar.

Në vijim propozojmë një produkt funksionalisht ekuivalent:

Stapler Endoskopie Stapler njëpërdorimësh i rikarikueshëm, me gjatësi boshti 16 cm dhe 6 cm, artikulum +/-45 gradë dhe me 7 pozicione.

Produkti i propozuar përmbush plotësisht kërkesat funksionale dhe klinike të përdorimit kirurgjikal, pasi disponon të njëjtin kënd artikulimi +/-45°, të njëjtat gjatësi boshti, është njëpërdorimësh dhe i rikarikueshëm dhe realizon të njëjtin funksion kirurgjikal dhe të njëjtin rezultat klinik.

Nga pikëpamja klinike, parametrat që përcaktojnë performancën e një stapleri endoskopik janë aftësia për të siguruar akses adekuat në fushën kirurgjikale, orientimi i instrumentit në hapësira anatomike të kufizuara, stabiliteti gjatë staplimit, kompresioni korrekt i indeve, formimi i sigurt i vijës së staplimit dhe kontrolli intraoperativ.

Produkti i propozuar i përmbush të gjitha këto kërkesa funksionale, duke siguruar orientim të përshtatshëm dhe akses të mjaftueshëm gjatë procedurave kirurgjikale. Në bazë të artikulimit +/-45 gradë, shtatë pozicionet e artikulimit përfaqësojnë këndet -45°, -30°, -15°, 0°, +15°, +30° dhe +45°, të cilat mundësojnë manovrim të plotë dhe efikas të instrumentit.

Numri i pozicioneve të artikulimit përbën një karakteristikë ergonomike të dizajnit të prodhuesit dhe nuk përfaqëson një kriter thelbësor që ndikon drejtpërdrejt në suksesin klinik të ndërhyrjes. Funksioni kryesor i artikulimit është orientimi i instrumentit në anatomi të vështira dhe ky funksion realizohet plotësisht edhe me shtatë pozicione artikulimi.

Për rrjedhojë, produkti i propozuar duhet të konsiderohet teknikisht ekuivalent dhe i pranueshëm, ndërsa kërkesa aktuale për 11 pozicione artikulimi përbën një specifikim të pajustificuar teknikisht dhe potencialisht kufizues për konkurrencën.

Specifikimet aktuale, ashtu siç janë formuluar, kufizojnë në mënyrë të panevojshme pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe bien ndesh me parimet e konkurrencës së lirë, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të parashikuara nga Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet të rishikojë formulimin e specifikimeve teknike dhe të lejojë ofertimin e produkteve ekuivalente që realizojnë të njëjtin funksion klinik dhe kirurgjikal.

Për më tepër, Komisioni i Prokurimit Publik, me Vendimin nr. 800/2026, datë 15.06.2026, lidhur me procedurën e prokurimit me nr. reference REF-84346-05-05-2026, me objekt “Blerje materiale konsumi mjekësore e ndarë në lote për nevoja të Spitalit Rajonal Shkodër”, ka pranuar pretendimet

e operatorit ekonomik për këtë produkt dhe ka urdhëruar ndryshimin e specifikimeve teknike.

Ky vendim përbën precedent administrativ që konfirmon se specifikimet teknike duhet të bazohen në karakteristika funksionale dhe klinike të verifikueshme dhe të mos përfshijnë kërkesa të pajustificuara që kufizojnë konkurrencën.

Në lidhje me specifikimet teknike për artikujt nr. 174, 175, 176, 177 dhe 178, pas shqyrtimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit, konstatojmë se kërkesat teknike të përcaktuara për kanjulat ultrasonike, setet e tubave dhe aksesoret përkatës nuk përshkruajnë karakteristika funksionale apo rezultate klinike të kërkuara nga autoriteti kontraktor, por korrespondojnë drejtpërdrejt me aksesoret dhe konsumablat e platformës ultrasonike CUSA të prodhuar nga kompania Integra LifeSciences. Bashkëlidhur katalogu zyrtar (chrome-extension://efaidnbnmnibpcajpcglclefindmkaj/file:///C:/Users/User/Downloads/0669586-2-E N%20-%20CUSA%20Clarity%20Neurosurgeons%20Brochure%20Canada%20(1).pdf)

Kombinimi i frekuencës 23 kHz, dimensioneve specifike të kanjulave, kërkesës për set tubash me lidhje të shpejtë të pajisur me kartrixh dhe përdorimit të çelësit dinamometrik të dedikuar për të njëjtën frekuencë përbën një konfigurim teknik që identifikon aksesoret origjinalë të sistemit CUSA. Këto produkte nuk përfaqësojnë një standard të përgjithshëm të industrisë, por janë projektuar për përdorim ekskluziv me platformën e Integra LifeSciences dhe nuk mund të përdoren në mënyrë të ndërsjellë me sistemet e prodhuesve të tjerë.

Nga verifikimet e kryera rezulton se produktet e Integra LifeSciences tregtohen në territorin e Republikës së Shqipërisë përmes operatorit ekonomik OES Distrimed (bashkëlidhur emaili), i cili disponon aksesin dhe shpërndarjen e këtyre produkteve. Për rrjedhojë, specifikimet aktuale krijojnë një avantazh të drejtpërdrejtë konkurrues për këtë operator ekonomik dhe kufizojnë ndjeshëm mundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve të tjerë në procedurë.

Në praktikë, operatorët e tjerë ekonomikë, edhe pse mund të ofrojnë sisteme ultrasonike të certifikuara dhe produkte me funksionalitet të krahasueshëm klinik, nuk kanë mundësi reale të paraqesin ofertë, pasi produktet e kërkuara janë konsumabla dhe aksesore të dedikuara për një platformë të vetme teknologjike. Për këtë arsye, specifikimet teknike nuk janë të orientuara drejt performancës klinike apo rezultatit terapeutik, por drejt identifikimit të një prodhuesi dhe një produkti të caktuar.

Në këto kushte, mënyra e formulimit të specifikimeve sjell si pasojë kufizimin e konkurrencës, favorizimin e një operatori të vetëm ekonomik dhe krijimin e një pengese objektive për pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë, duke cenuar parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë të parashikuara në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Gjithashtu, duke qenë se artikujt nr. 174, 175, 176, 177 dhe 178 përbëjnë konsumabla dhe aksesore specifike të një platforme të vetme teknologjike, përfshirja e tyre në të njëjtin lot me

artikuj të tjerë krijon efekt bllokues për operatorët ekonomikë që nuk kanë akses në produktet e Integra LifeSciences. Pamundësia për të siguruar këto produkte çon praktikisht në pamundësinë e ofertimit për të gjithë lotin, pavarësisht aftësisë së operatorëve për të furnizuar pjesën tjetër të artikujve.

Për rrjedhojë, kërkojmë rishikimin e dokumenteve të procedurës dhe ndarjen e artikujve nr. 174, 175, 176, 177 dhe 178 në një LOT të veçantë, me qëllim garantimin e konkurrencës reale dhe efektive, rritjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, shmangien e varësisë nga një burim i vetëm furnizimi dhe sigurimin e përdorimit sa më efikas të fondeve publike.

Në lidhje me specifikimet teknike për artikullin nr. 173 Elektroda me majë Maryland, njëpërdorimëshe, për mbylljen e enëve të gjakut, 23cm, pas shqyrtimit të dokumentacionit të procedurës së prokurimit konstatuam se kërkesat teknike të përcaktuara për elektrodën me majë Maryland korrespondojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me produktin LigaSure Maryland Jaë Sealer-Divider të kompanisë Medtronic/Covidien, konkretisht me konfigurimin teknik të produktit me kod reference LF1723. Bashkëlidhur katalogu zyrtar (chrome-extension://efaidnbmnribpcajpcgglefindmkaj/https://www.tengrant.com/upLoad/file/20170312/ligasure-maryland-jaw-info-sheet.pdf)

Kombinimi i karakteristikave teknike të kërkuara, si maja Maryland, aftësia për mbylljen e enëve të gjakut deri në 7 mm, gjatësia 23 cm, rrotullimi 350 gradë, gjatësia e nofullës 20 mm, prerja 18 mm dhe prania e një thike të integruar të pavarur nga mekanizmi i sealing-ut, identifikon praktikisht një konfigurim të vetëm prodhuesi dhe nuk përfaqëson një standard të përgjithshëm të tregut të pajisjeve elektrokirurgjikale.

Nga verifikimet e kryera rezulton se produktet e kësaj kategorie të kompanisë Medtronic janë të regjistruara pranë AKBPM në emër të operatorit ekonomik OES Distrimed, i cili vepron si distributor i autorizuar për këto produkte në territorin e Republikës së Shqipërisë. Për rrjedhojë, operatorët e tjerë ekonomikë nuk kanë akses real në sigurimin e këtij produkti, pasi furnizimi lidhet me një kanal të vetëm të autorizuar.

Kompania jonë ka kryer tentativa të përsëritura për të kontaktuar kompaninë Medtronic dhe përfaqësuesit përkatës me qëllim sigurimin e mundësisë së furnizimit apo bashkëpunimit për produktin në fjalë, por pa marrë asnjë përgjigje apo mundësi konkrete aksesimi. Në këto kushte, specifikimet teknike të hartuara në këtë mënyrë krijojnë një situatë përjashtuese dhe kufizojnë objektivisht pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë ekonomikë në procedurën e prokurimit.

Për më tepër, kërkesat tepër specifike teknike nuk lidhen domosdoshmërisht me një avantazh klinik proporcional, por identifikojnë indirekt një produkt dhe një prodhues të vetëm, duke cenuar parimet e konkurrencës së lirë, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Përcaktimi i karakteristikave të tilla krijon një situatë monopol faktik dhe kufizon konkurrencën reale në procedurë.

Referuar parimeve të legjislacionit të prokurimit publik, autoriteti kontraktor duhet të formulojë specifikimet teknike mbi bazën e funksionalitetit dhe performancës klinike të produktit, duke lejuar edhe produkte ekuivalente që realizojnë të njëjtin funksion mjekësor dhe kirurgjikal.

Në këtë kuadër, kompania jonë propozon një produkt funksionalisht ekuivalent me këto karakteristika:

173 Elektrodë me majë Maryland, njëpërdorimëshe, për mbylljen e enëve të gjakut deri në/përfshirë 7 mm, 23 cm, për prerje dhe devaskularizim organesh, e rrotullueshme 350°, me gjatësi nofullë 20 mm, prerje 18.4 mm dhe me thikë të integruar të pavarur nga mekanizmi i sealing-ut.

Produkti i propozuar përmbush plotësisht funksionin klinik dhe kirurgjikal të kërkuar nga autoriteti kontraktor, pasi garanton mbyllje efektive të enëve të gjakut deri në 7 mm, prerje

dhe devaskularizim të sigurt të indeve, kontroll të mirë intraoperativ dhe përdorim të përshtatshëm në procedurat laparoskopike dhe kirurgjikale. Produkti siguron të njëjtin nivel sigurie, hemostaze dhe performancë klinike si produkti i kërkuar.

Gjithashtu, diferenca ndërmjet gjatësisë së prerjes 18 mm të kërkuar dhe gjatësisë së prerjes 18.4 mm të produktit të ofruar nuk përbën ndryshim thelbësor teknik apo klinik. Kjo diferencë minimale prej vetëm 0.4 mm nuk ndikon në funksionin kirurgjikal të instrumentit, në efektivitetin e prerjes apo në performancën e sealing-ut të enëve të gjakut. Në praktikën kirurgjikale dhe në vlerësimin teknik të pajisjeve mjekësore, diferenca të tilla dimensionale konsiderohen brenda tolerancave normale të prodhimit dhe nuk ndikojnë në rezultatin klinik të produktit.

Për rrjedhojë, produkti i propozuar duhet të konsiderohet teknikisht, funksionalisht dhe klinikisht ekuivalent me produktin e kërkuar në dokumentet e tenderit dhe refuzimi i tij për shkak të një diferencë minimale dimensionale do të përbënte një kufizim të pajustificuar të konkurrencës dhe të parimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Për më tepër, Komisioni i Prokurimit Publik, me Vendimin nr. 800/2026, datë 15.06.2026, lidhur me procedurën e prokurimit me nr. reference REF-84346-05-05-2026, me objekt “Blerje materiale konsumi mjekësore e ndarë në lote për nevoja të Spitalit Rajonal Shkodër”, ka pranuar pretendimet e operatorit ekonomik për këtë produkt dhe ka urdhëruar ndryshimin e specifikimeve teknike.

Në lidhje me specifikimet teknike për artikullin nr. 179 Copë e absorbueshme ngjitëse. Për hemostazë dhe ngjitje. Të jetë prej sfungjeri të thatë, por me mundësi konvertimi në formë xhelatine. I absorbueshëm në 14?15 ditë. Të ketë të paktën 40 minikolona për cm?. Pa proteina të nxjerra nga gjaku. Përmasa 8?5?1 cm.

Nga analiza e dokumentacionit teknik dhe verifikimi i katalogëve zyrtarë të prodhuesve ndërkombëtarë të produkteve hemostatike me bazë xhelatine rezulton se kërkesa për “minimumi 40 minikolona/cm?” nuk paraqitet si karakteristikë standarde teknike në dokumentacionin e publikuar të prodhuesve. Prodhuesit e këtyre produkteve deklarojnë zakonisht parametra si përmasat, koha e absorbimit, përbërja e materialit, struktura poroze, kapaciteti absorbues, biokompatibiliteti dhe efektiviteti hemostatik, ndërsa numri i minikolonave për cm? nuk rezulton të jetë një parametër i publikuar apo i standardizuar.

Për rrjedhojë, kërkesa për minimumi 40 minikolona/cm? përbën një specifikim të paqartë, të pamatshëm dhe të paverifikueshëm nga operatorët ekonomikë, duke krijuar vështirësi objektive për vërtetimin e përputhshmërisë së produkteve të ofruara. Në mungesë të një reference teknike të njohur dhe të verifikueshme, ky kriter nuk lejon vlerësimin objektiv të produkteve ekuivalente dhe për rrjedhojë mund të kufizojë konkurrencën.

Funksioni kryesor i një sfungjeri hemostatik konsiston në kontrollin e gjakderdhjes, realizimin e hemostazës lokale, absorbimin e lëngjeve biologjike, transformimin në masë xhelatinoze pas kontaktit me gjakun dhe absorbimin gradual në organizëm. Parametri i numrit të minikolonave për cm? nuk përfaqëson një kriter klinik të njohur që ndikon drejtpërdrejt në efektivitetin hemostatik, sigurinë apo performancën e produktit.

Në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, specifikimet teknike duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të mos krijojnë pengesa të pajustificuara për konkurrencën dhe të lejojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që ofrojnë produkte ekuivalente që realizojnë të njëjtin funksion klinik.

Në këto kushte, kërkojmë rishikimin e specifikimeve teknike dhe heqjen e kriterit “minimumi 40 minikolona/cm?” ose zëvendësimin e tij me karakteristika funksionale dhe klinikisht të verifikueshme.

Si alternativë teknike dhe funksionale propozojmë:

Nr. ArtikulliSpecifikimi i propozuar

179 Sfungjer hemostatik absorbues Për hemostazë dhe ngjitje. Të jetë prej sfungjeri të thatë, me mundësi konvertimi në formë xhelatine. I absorbueshëm në 14?15 ditë. Pa proteina të nxjerra nga gjaku. Përmasa 8?5?1 cm ose ekuivalent.

Produkti që ne ofrojmë është një sfungjer hemostatik absorbues me bazë xhelatine të purifikuar, i destinuar për përdorim kirurgjikal për kontrollin e gjakderdhjes dhe realizimin e hemostazës lokale. Produkti është steril, biokompatibël, jo toksik dhe jo imunogjenik, ndërsa nuk përmban proteina të nxjerra nga gjaku, duke përmbushur kërkesat për sigurinë biologjike.

Pas kontaktit me lëngjet biologjike, produkti zgjerohet dhe merr konsistencë xhelatinoze, duke mundësuar ngjitjen në ind dhe krijimin e një efekti të qëndrueshëm hemostatik. Produkti absorbon sasi të konsiderueshme gjaku dhe absorbohet gradualisht në organizëm brenda periudhës së kërkuar prej 14?15 ditësh, në varësi të kushteve klinike dhe vendit të aplikimit.

Përmasat e produktit 8?5?1 cm përputhen plotësisht me kërkesat e autoritetit kontraktor. Produkti realizon të njëjtin funksion klinik dhe hemostatik si produkti i kërkuar dhe garanton të njëjtin nivel sigurie dhe efikasiteti në përdorim.

Për rrjedhojë, produkti i ofruar nga kompania jonë duhet të konsiderohet produkt ekuivalent dhe funksionalisht i zëvendësueshëm, ndërsa refuzimi i tij mbi bazën e një parametri të paverifikueshëm teknikisht do të përbënte një kufizim të pajustificuar të konkurrencës dhe do të binte ndesh me parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë.

Në lidhje me specifikimet teknike për produktin nr. 180 Dezinfektant instrumentash me bazë Glutaraldehyde-Formaldehyde. Për dezinfektimin manual të instrumenteve kirurgjikale, përfshirë endoskopet dhe fibroskopet. Të ketë efekt baktericid, fungicid, tuberkulocid, antiviral (përfshirë HBV/HIV). Të furnizohet si komplet me solucion të pa-aktivizuar dhe aktivizuesin për përzierjen dhe përfitim të solucionit të gatshëm për përdorim. Përmbajtja: min. 2% glutaraldehyde, etj. Të furnizohet si solucion i gatshëm për përdorim (max 5 litra / enë). Të ketë referenca përdorimi nga firmat e njohura të endoskopeve dhe fibroskopeve.

Nga shqyrtimi i specifikimeve teknike rezulton se kërkesa për përmbajtje Formaldehyde nuk përbën kërkesë të domosdoshme funksionale për arritjen e efektit dezinfektues, por përfaqëson një komponent kimik të lidhur me rrezikshmëri të lartë për shëndetin e personelit dhe përdoruesve.

Formaldehyde është klasifikuar ndërkombëtarisht si substancë kancerogjene për njerëzit (IARC Group 1 dhe CLP Regulation EC 1272/2008), dhe përdorimi i tij në mjedise spitalore lidhet me rreziqe të njohura si irritim i rrugëve të frymëmarrjes, reaksione alergjike, dermatite profesionale dhe ekspozim afatgjatë me pasoja të mundshme serioze shëndetësore. Në këtë kuptim, përfshirja e Formaldehyde në specifikimet teknike nuk është e domosdoshme për funksionin dezinfektues, por rrit ekspozimin ndaj një substance të rrezikshme, në kundërshtim me tendencat bashkëkohore të sigurisë në kujdesin shëndetësor.

Rregullorja (BE) 2023/1464 e Komisionit, që ndryshon Aneksin XVII të Rregullores (KE) Nr. 1907/2006 (REACH), konfirmon qartë nevojën për kufizim dhe kontroll të rreptë të përdorimit të Formaldehyde, duke reflektuar qasjen e Bashkimit Evropian drejt reduktimit të ekspozimit ndaj substancave të rrezikshme kur ekzistojnë alternativa më të sigurta dhe po aq efektive.

Në praktikën bashkëkohore ndërkombëtare të dezinfektimit të nivelit të lartë, prodhuesit kryesorë kanë kaluar drejt formulimeve pa Formaldehyde, duke përdorur alternativa si glutaraldehyde pa formaldehyde, ortho-phthalaldehyde (OPA), peracetic acid dhe hydrogen peroxide, të cilat ofrojnë të njëjtin spektër veprimi baktericid, fungicid, tuberkulocid dhe antiviral, duke garantuar të njëjtin funksion klinik me siguri më të lartë për përdoruesit.

*Për rrjedhojë, kërkesa për formulime “Glutaraldehyde-Formaldehyde” nuk përfaqëson një domosdoshmëri teknike dhe kufizon në mënyrë të pajustificuar konkurrencën, duke përjashtuar produkte moderne të disponueshme gjerësisht në treg ndërkombëtar.*

*Gjithashtu, konstatohet një mospërputhje teknike në specifikim, ku kërkohet njëkohësisht që produkti të furnizohet si komplet me solucion të pa-aktivizuar dhe aktivizues, dhe njëkohësisht si solucion i gatshëm për përdorim. Këto dy forma janë teknikisht të ndryshme, pasi produktet që kërkojnë aktivizim nuk janë “ready to use”, ndërsa produktet “ready to use” furnizohen të gatshme dhe nuk kërkojnë përzierje apo aktivizim. Ky formulim krijon paqartësi dhe kufizon konkurrencën duke vështirësuar ofertimin e saktë nga operatorët ekonomikë.*

*Nga analiza e tregut rezulton se produktet moderne të dezinfektimit të instrumenteve kirurgjikale dhe endoskopike janë kryesisht “ready to use”, pasi kjo formë redukton gabimet në përgatitje, garanton përqendrim të saktë të substancës aktive dhe rrit sigurinë e personelit shëndetësor.*

*Në përputhje me parimet e proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë të përcaktuara në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, kërkojmë rishikimin e specifikimeve teknike dhe heqjen e Formaldehyde nga formulimi, si dhe unifikimin e kërkesës në një formë të qartë dhe të verifikueshme.*

*Si alternativë teknike dhe funksionale propozojmë: Dezinfektant instrumentash me bazë Glutaraldehyde. Për dezinfektimin manual të instrumenteve kirurgjikale, përfshirë endoskopet dhe fibroskopet. Të ketë efekt baktericid, fungicid, tuberkulocid, antiviral (përfshirë HBV/HIV).*

*Përmbajtja: min. 2% glutaraldehyde. Të furnizohet si solucion i gatshëm për përdorim (max 5 litra/ene).*

*Produkti i propozuar realizon të njëjtin funksion dezinfektues dhe përmbush të njëjtin spektër veprimi si produkti i kërkuar, duke garantuar efektivitet klinik, siguri në përdorim dhe përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të dezinfektimit spitalor, pa ekspozuar personelin ndaj Formaldehyde dhe pa kufizuar konkurrencën në treg.*

*Autoriteti kontraktor ka të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me artikujt objekt-prokurimi, por në çdo rast këto specifikime teknike duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e specifikimeve teknike joproportionale dhe të pajustificuara shkaktojnë kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar,*

*Neni 3 ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se:*

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

*Neni 21 i ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohen se:*

*“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.*

*Neni 36 i ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se:*

*“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

*b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

*c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

*ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me ?do mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

*Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet*

*ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”*

*Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.*

*Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përfshijë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.*

*Sa më sipër, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

*Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kriteret të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar .*

*Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kriteret apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar.....”[.....]*

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës me nr. 3051/7 prot., datë 25.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1993/1 prot., datë 29.06.2026 me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur ng operatori ekonomik “SoLed” SHPK, lidhur me dokumentet e tenderit, në procedurën e prokurimit me nr. REF-89793-06-11-2026026, me objekt: “LOT 2 -“Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore MM2”, autoriteti kontraktor njofton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pas shqyrtimit të ankesës ka vendosur të ndërpresë afatin 5-ditor për marrjen e vendimit në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “SoLed” SHPK deri në marrjen e një informacioni nga autoriteti kontraktor përfitues Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale.

II.6. Njëpërmjet sistemit elektronik të ankesave autoriteti kontraktor përfitues Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, me shkresën nr. 3221/2 prot, datë 06.07.2026, protokolluar me tonën me nr. 1993/3 prot, datë 09.07.2026, me objekt “Kthim përgjigje” ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik procesverbalin e mbajtur nga ky institucion lidhur me qëndrimin teknik të arsyetuar përsa i përket specifikimeve teknike dhe kriterëve objekt i ankesës së operatorit ekonomik “SoLed” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 3221/3 prot, datë 07.07.2026, protokolluar me tonën me nr. 1993/4 prot, datë 09.07.2026, autoriteti kontraktor përfitues Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale ka bërë kërkesë për shqyrtimin me prioritet të ankesës dhe lejimin e procedurës së prokurimit.

II.8. Me shkresën nr. 3051/11 prot, datë 17.07.2026, protokolluar me tonën me nr. 1993/5 prot, datë 20.07.2026, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i KSHA-së nr.1251/2026, datë 16.07.2026.

Referuar vendimit të KSHA-së konstatohet se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues, dhe në përfundim ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës duke pranuar kërkesat si më poshtë:

*“1. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues mbi rishikimin e strukturës së procedurës së prokurimit si dhe parashikimin e mundësisë së lidhjes së marrëveshjes kuadër me më shumë se një Operator ekonomik, KSHA gjykon se:*

*..... Nisur nga pretendimi ankimuesit, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi shqyrtoi Dokumentet e Tenderit, të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Loti 2.’ Blerje maieriale mjekimi konsumf kirurgjikale MM2”, gjykon se organizimi i procedurës si marrëveshje kuadër me një Operator ekonomik nuk përfaqëson në vetvete alternativën më të përshtatshme për realizimin e objektit të prokurimit. Ky konstatimi mbështetet në një analizë të detajuar në raport me vlerën e konsiderueshme të fondit limit për objektin e prokurimit; faktit që furnizimet do të realizohen në mënyrë të shpërndarë gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit, si dhe nisur nga karakteristikat e tregut dhe mundësisë që Operator të ndryshëm ekonomikë të disponojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e furnizimeve gjatë periudhave të ndryshme të ekzekutimit.....*

*.... Nga sa më lart cituar, konstatohet se fondi limit i procedurës së prokurimit për sa i takon vlerës është relativisht i konsiderueshëm dhe se referuar Grafikut të lëvrimit, evidentohet qartazi se furnizimet objekt prokurimi nuk do të realizohen njëherësh, por në mënyrë të planifikuar gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të marrëveshjes kuadër, konkretisht deri në 50% të sasive në katërmujorin e parë, deri në 25% në katërmujorin e dytë dhe deri në 25% në katërmujorin e tretë. KSHA gjykon se kjo mënyrë realizimi e kontratës nuk imponon domosdoshmërinë e përzgjedhjes së vetëm një Operatori ekonomik, por krijon kushtet që nevojat e Autoritetit Kontraktor Përfitues të përmbushen në mënyrë efikase nëpërmjet një marrëveshjeje kuadër me disa Operatorë ekonomikë.*

*Gjithashtu, KSHA vlerëson se, duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit si dhe kohëzgjatjen e ekzekutimit të marrëveshjes kuadër, organizimi i procedurës së prokurimit Marrëveshje Kuadër me disa OE do të siguronte një nivel më të lartë konkurrence, duke*

zgjeruar mundësinë e pjesëmarrjes së Operatorëve ekonomikë që disponojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e furnizimeve, por që mund të mos jenë në gjendje të përballojnë të gjithë vëllimin e kontratës në cilësinë e operatorit të vetëm.

Njëkohësisht, përfshirja e disa Operatorëve ekonomikë krijon garanci më të lartë për vazhdimësinë e furnizimeve gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit, duke reduktuar riskun operacional që lidhet me varësinë nga një Operator i vetëm si dhe rrit fleksibilitetin e Autoritetit Kontraktor Përfitues në përmbushjen e nevojave të tij, duke garantuar në këtë mënyrë një administrim më efikas të marrëveshjes kuadër.

KSHA çmon se forma e zgjedhur e marrëveshjes kuadër përbën një element thelbësor të strategji isë së prokurimit dhe të dokumenteve të tenderit. Ndryshimi i saj nga marrëveshje kuadër me një Operator ekonomik në marrëveshje kuadër me disa Operatori ekonomikë përbën një ndryshim thelbësor të dokumenteve të procedurës, i cili nuk mund të realizohet gjatë zhvillimit të procedurës së publikuar, pasi do të cenonte parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, konkurrencës efektive si dhe sigurisë juridike.

Për këtë arsye, KSHA vlerëson se procedura aktuale e prokurimit ka mangësi të rëndësishme në dokumentet e tenderit, të cilat nuk mund korrigjohen pa çënuar parimet e procedurës.

Në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), Neni 98, pika 1, gërma “c”, përcaktohet se: “/ . Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në raslet liur: a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshfatshme; b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme; c) konstalon se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme; ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar; d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashkimeve në këtë ligj. ”

Sa më lart cituar, referuar legjislacionit për prokurimin publik në fuqi, KSHA propozon që procedura e prokurimit me objekt: “Loti 2 Blerje materiale mjekimi konsumi kirurgjikale MM2” duhet të anulohet, si rrjedhojë e konstatimit të mangësive të rëndësishme të dokumenteve të tenderit.

Gjatë rishpalljes së procedurës së prokurimit objekt ankimi, Njësia e Prokurimit duhet të mbajë në konsideratë mangësitë e konstatuara si dhe të konsolidojë një strategji të re zhvillimi të procedurës si marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë si një mase e nevojshme për të garantuar zhvillimin e një procedure në përputhje me parimet e ligjit për prokurimin publik në fuqi. Një qasje e tillë do të garantonte njëkohësisht konkurrencë më të gjerë, përdorimin me efektivitet të fondeve publike si dhe realizimin në kohë të nevojave të Autoritetit Kontraktor Përfitues.

2. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues “SoLed” shpk, mbi modifikimin e Dokumenteve Standarte tii Tenderit, Kriteret e Veçanta tri Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 9, me arsyetimin se: “...Kerkojme heqjen e krileril **per** paraqitjen e mosirave per secilin artikull objekti prokurimi, pasi Autoriteti Kontraktor, riuk ka argumentuar teknikisht

*domosdoshmerine e tij', nderkohe qe verifikimi i perputhshmerise teknike te produkteve sigurohel tashme nepermjet katalogeve dhe skedave teknike l kerkuara ne dokumentet e tenderit...'', KSHA gjykon se:*

*.....Autoriteti kontraktues eshte organi pergjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën pergjegjësinë e Autoritetit Kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e pëjashtuese.*

*Referuar pretendimeve të Operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë, KSHA vlerëso se në rastin konkret synimi themelor i Autoritetit Kontraktor është verifikimi i ekzistencë së kapaciteteve të nevojshme të Operatorëve ekonomikë ofertues për realizimin e kontratës objekt prokurimi.*

*Në funksion të realizimit të këtij qëllimi, Autoriteti Kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriterë kualifikimi që lidhen me provimin e kapacitetit teknik të Operatorëve ekonomikë, por edhe kërkesa të tjera kualifikuese që lidhen me verifikimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të produkteve, nëpërmjet paraqitjes së mostrave.*

*Gjithashtu, KSHA konstaton se kërkesa për paraqitjen e mostrave është parashikuar për të gjithë artikujt objekt prokurimi, të parashikuar sipas Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit.*

*Në DT, Kriteret e Veçanta të Kualifikimi, Kapaciteti Teknik, pika 9, Autoriteti Kontraktor, OBP sha ka parashikuar se: "9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë / skeda teknike për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë fë pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara. Në katalogët / skedat teknike të paraqitura, duhet të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), specifikimet /eJmzR sipas DST. (Katalogëi 1skedat teknike duhet të ngarkohen në eëë. app.gov. al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT), "*

*Për sa më lart, KSHA konstaton se referuar DT, Autoriteti Kontraktor, krahas kërkesës për paraqitjen e mostrave, ka kërkuar gjithashtu edhe paraqitjen e katalogëve teknikë / skedave teknike për të gjithë artikujt e ofertuar, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së mallrave të ofertuara me specifikimet teknike të parashikuara në DT.*

*Ndodhur në kushtet ku qëllimi i kërkesës për paraqitjen e mostrave si dhe i kërkesës për paraqitjen e katalogëve teknikë/skedave teknike për të gjithë artikujt e ofertuar lidhet me verifikimin e përputhshmërisë së mallrave të ofertuara me specifikimet teknike të objektit të prokurimit, KSHA gjykon se paraqitja e katalogëve teknikë/skedave teknike përbën dokumentacion të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për të provuar përmbushjen e qëllimit.*

*Për më tepër, duke marrë në konsideratë dhe numrin e artikujve të objektit të prokurimit si dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit, KSHA gjykon se kërkesa për paraqitjen e mostrave për të gjithë artikujt krijon një barrë administrative dhe ekonomike të panevojshme për Operatorët ekonomikë, e cila mund të ndikojë në pjesëmarrjen e tyre në procedurë dhe, për rrjedhojë, mund të ndikojë në uljen e konkurrencës.*

*Në këto kushte, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, çmon se qëllimi i verifikimit të përputhshmërisë teknike mund të arrihet nëpërmjet dokumentacionit teknik të kërkuar (pra nëpërmjet kërkesës së parashikuar për paraqitjen e katalogëve teknikë/ skedave teknike), ndërsa paraqitja e mostrave mund të kërkohej vetëm për artikuj të veçantë, kur kjo është objektivisht e nevojshme dhe e arsyetuar.*

**Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.**

### 3. Artikulli 166 - Stapler endoskopie

*Pretendimi i ankuesit: Ankuesi kundërshton 11 pozicionet e artikulimit si kufizuese.*

*Analiza AK. Qellimi teknik është artikulum i mjaftueshëm për akses endoskopik, jo numri formal i pozicione. Numri i pozicioneve duhet të jetë minimum funksional ndërsa produktet me më shumë pozicione nuk përjashtohen. Minimumi “të paktën 7 pozicione” është më proporcional dhe lejon produkte me performancë të barasvlershme apo më të lartë.*

***Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.***

### 4. Artikulli 180 - Dezinfectant instrumentash me bazë Glutaraldehide

*Pretendimi i ankuesit: Ankuesi kërkon qartësim të përbërjes kimike dhe formës së produktit, pasi emërtimi dhe specifikimi nuk janë të unifikuara.*

*Analiza e AK. Për dezinfektantët e instrumenteve kirurgjikale/ endoskopëve, parametrat kritikë janë spektri i veprimit, përqendrimi i substancës aktive, koha e kontaktit, përputhshmëria me materialet e instrumenteve, siguria e përdoruesit, SDS/IFU dhe dokumentacioni rregullor. Emërtimi i artikullit dhe specifikimet teknike janë të paqarta dhe jo të unifikuara për rrjedhojë OE ka të drejtë.*

***Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.***

II.9. Me shkresën nr. 800005 prot, datë 22.07.2026, protokolluar me tonën me nr. 1993/46 prot, datë 23.07.2026, operatori ekonomik ankimues “SoLed” SHPK ka bërë kërkesë për shqyrtimin e plotë të ankesës.

## III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës nr. nr. 3051/11 prot, datë 17.07.2026, protokolluar me tonën me nr. 1993/5 prot, datë 20.07.2026 me anë të së cilës është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i KSHA-së nr.1251/2026, datë 16.07.2026 nga ku konstatohet se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues, dhe në përfundim ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës duke pranuar kërkesat si më poshtë:

*“1. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues mbi rishikimin e strukturës së procedurës së prokurimit si dhe parashikimin e mundësisë së lidhjes së marrëveshjes kuadër me më shumë se një Operator ekonomik, KSHA gjykon se:*

*..... Nisur nga pretendimi ankimuesit, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi shqyrtoi Dokumentet e Tenderit, të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Loti 2.’ Blerje maieriale mjekimi konsumf kirurgjikale MM2”, gjykon se organizimi i procedurës si marrëveshje kuadër me një Operator ekonomik nuk përfaqëson në vetvete alternativën më të përshtatshme për realizimin e objektit të prokurimit. Ky konstatimi mbështetet në një analizë të detajuar në raport me vlerën e konsiderueshme të fondit limit për objektin e prokurimit; faktit që furnizimet do të realizohen në mënyrë të shpërndarë gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit, si dhe nisur nga karakteristikat e tregut dhe mundësisë që Operator të ndryshëm ekonomikë të disponojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e furnizimeve gjatë periudhave të ndryshme të ekzekutimit.....*

*.... Nga sa më lart cituar, konstatohet se fondi limit i procedurës së prokurimit për sa i takon vlerës është relativisht i konsiderueshëm dhe se referuar Grafikut të lëvrimit, evidentohet qartazi se furnizimet objekt prokurimi nuk do të realizohen njëherësh, por në mënyrë të planifikuar gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të marrëveshjes kuadër, konkretisht deri në 50% të sasive në katërmujorin e parë, deri në 25% në katërmujorin e dytë dhe deri në 25% në katërmujorin e tretë. KSHA gjykon se kjo mënyrë realizimi e kontratës nuk imponon domosdoshmërinë e përzgjedhjes së vetëm një Operatori ekonomik, por krijon kushtet që nevojat e Autoritetit Kontraktor Përfitues të përmbushen në mënyrë efikase nëpërmjet një marrëveshjeje kuadër me disa Operatorë ekonomikë.*

*Gjithashtu, KSHA vlerëson se, duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit si dhe kohëzgjatjen e ekzekutimit të marrëveshjes kuadër, organizimi i procedurës së prokurimit Marrëveshje Kuadër me disa OE do të sigurojë një nivel më të lartë konkurrence, duke zgjeruar mundësinë e pjesëmarrjes së Operatorëve ekonomikë që disponojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e furnizimeve, por që mund të mos jenë në gjendje të përballojnë të gjithë vëllimin e kontratës në cilësinë e operatorit të vetëm.*

*Njëkohësisht, përfshirja e disa Operatorëve ekonomikë krijon garanci më të lartë për vazhdimësinë e furnizimeve gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit, duke reduktuar riskun operacional që lidhet me varësinë nga një Operator i vetëm si dhe rrit fleksibilitetin e Autoritetit Kontraktor Përfitues në përmbushjen e nevojave të tij, duke garantuar në këtë mënyrë një administrim më efikas të marrëveshjes kuadër.*

*KSHA çmon se forma e zgjedhur e marrëveshjes kuadër përbën një element thelbësor të strategj isë së prokurimit dhe të dokumenteve të tenderit. Ndryshimi i saj nga marrëveshje kuadër me një Operator ekonomik në marrëveshje kuadër me disa Operatori ekonomikë përbën një ndryshim thelbësor të dokumenteve të procedurës, i cili nuk mund të realizohet gjatë zhvillimit të procedurës së publikuar, pasi do të cenonte parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, konkurrencës efektive si dhe sigurisë juridike.*

*Për këtë arsye, KSHA vlerëson se procedura aktuale e prokurimit ka mangësi të rëndësishme në dokumentet e tenderit, të cilat nuk mund korigjohen pa cënuar parimet e procedurës.*

Në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), Neni 98, pika 1, gërma “c”, përcaktohet se: “/. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në raslet liur: a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshfatshme; b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme; c) konstalon se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme; ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetet ose entit kontraktor kanë ndryshuar; d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashkimeve në këtë ligj. ”

Sa më lart cituar, referuar legjislacionit për prokurimin publik në fuqi, KSHA propozon që procedura e prokurimit me objekt: “Loti 2 Blerje materiale mjekimi konsumi kirurgjikale MM2” duhet të anulohet, si rrjedhojë e konstatimit të mangësive të rëndësishme të dokumenteve të tenderit.

Gjatë rishpalljes së procedurës së prokurimit objekt ankimi, Njësia e Prokurimit duhet të mbajë në konsideratë mangësitë e konstatuara si dhe të konsolidojë një strategji të re zhvillimi të procedurës si marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë si një mase e nevojshme për të garantuar zhvillimin e një procedure në përputhje me parimet e ligjit për prokurimin publik në fuqi. Një qasje e tillë do të garantonte njëkohësisht konkurrencë më të gjerë, përdorimin me efektivitet të fondeve publike si dhe realizimin në kohë të nevojave të Autoritetit Kontraktor Përfitues.

2. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues “SoLed” shpk, mbi modifikimin e Dokumenteve Standarte tii Tenderit, Kriteret e Veqanta tri Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 9, me arsyetimin se: “...Kerkojme heqjen e krileril **per** paraqitjen e mosirave per secilin artikull objekti prokurimi, pasi Autoriteti Kontraktor, riuk ka argumentuar teknikisht domosdoshmerine e tij’, nderkohe qe verifikimi i perputhshmërise teknike te produkteve sigurohel tashme nepermjet katalogeve dhe skedave teknike l kerkuara ne dokumentet e tenderit...”, KSHA gjykon se:

.....Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e Autoritetit Kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përyashtuese.

Referuar pretendimeve të Operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë, KSHA vlerëso se në rastin konkret synimi themelor i Autoritetit Kontraktor është verifikimi i ekzistencë së kapaciteteve të nevojshme të Operatorëve ekonomikë ofertues për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Në funksion të realizimit të këtij qëllimi, Autoriteti Kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriteret kualifikimi që lidhen me provimin e kapacitetit teknik të Operatorëve ekonomikë, por edhe kërkesa të tjera kualifikuese që lidhen me verifikimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të produkteve, nëpërmjet paraqitjes së mostrave.

Gjithashtu, KSHA konstaton se kërkesa për paraqitjen e mostrave është parashikuar për të gjithë artikujt objekt prokurimi, të parashikuar sipas Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit.

Në DT, Kriteret e Veçanta të Kualifikimi, Kapaciteti Teknik, pika 9, Autoriteti Kontraktor, OBP sha ka parashikuar se: “9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë / skeda teknike për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë fë pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara. Në katalogët / skedat teknike të paraqilura, duhet të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), specifikimet /eJmzR sipas DST. (Katalogëi 1skedat teknike duhet të ngarkohen në ëëë. app.gov. al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT), ”

Për sa më lart, KSHA konstaton se referuar DT, Autoriteti Kontraktor, krahas kërkesës për paraqitjen e mostrave, ka kërkuar gjithashtu edhe paraqitjen e katalogëve teknikë / skedave teknike për të gjithë artikujt e ofertuar, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së mallrave të ofertuara me specifikimet teknike të parashikuara në DT.

Ndodhur në kushtet ku qëllimi i kërkesës për paraqitjen e mostrave si dhe i kërkesës për paraqitjen e katalogëve teknikë/skedave teknike për të gjithë artikujt e ofertuar lidhet me verifikimin e përputhshmërisë së mallrave të ofertuara me specifikimet teknike të objektit të prokurimit, KSHA gjykon se paraqitja e katalogëve teknikë/skedave teknike përbën dokumentacion të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për të provuar përmbushjen e qëllimit.

Për më tepër, duke marrë në konsideratë dhe numrin e artikujve të objektit të prokurimit si dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit, KSHA gjykon se kërkesa për paraqitjen e mostrave për të gjithë artikujt krijon një barrë administrative dhe ekonomike të panevojshme për Operatorët ekonomikë, e cila mund të ndikojë në pjesëmarrjen e tyre në procedurë dhe, për rrjedhojë, mund të ndikojë në uljen e konkurrencës.

Në këto kushte, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, çmon se qëllimi i verifikimit të përputhshmërisë teknike mund të arrihet nëpërmjet dokumentacionit teknik të kërkuar (pra nëpërmjet kërkesës së parashikuar për paraqitjen e katalogëve teknikë/ skedave teknike), ndërsa paraqitja e mostrave mund të kërkohej vetëm për artikuj të veçantë, kur kjo është objektivisht e nevojshme dhe e arsyetuar.

**Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.**

### 3. Artikulli 166 - Stapler endoskopie

Pretendimi i ankuesit: Ankuesi kundërshton 11 pozicionet e artikulimit si kufizuese.

Analiza AK. Qëllimi teknik është artikulum i mjaftueshëm për akses endoskopik, jo numri formal i pozicioneve. Numri i pozicioneve duhet të jetë minimum funksional ndërsa produktet me më shumë pozicione nuk përjashtohen. Minimumi “të paktën 7 pozicione” është më proporcional dhe lejon produkte me performancë të barasvlershme apo më të lartë.

**Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.**

### 4. Artikulli 180 - Dezinsektant instrumentash me bazë Glutaraldehide

Pretendimi i ankuesit: Ankuesi kërkon qartësim të përbërjes kimike dhe formës së produktit, pasi emërtimi dhe specifikimi nuk janë të unifikuara.

Analiza e AK. Për dezinfektantët e instrumenteve kirurgjikale/ endoskopëve, parametrat kritikë janë spektri i veprimt, përqendrimi i substancës aktive, koha e kontaktit, përputhshmëria me materialet e instrumenteve, siguria e përdoruesit, SDS/IFU dhe dokumentacioni rregullor. Emërtimi i artikullit dhe specifikimet teknike janë të paqarta dhe jo të unifikuara për rrjedhojë OE ka të drejtë.

**Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.**

III.1.2. Neni 30 i LPP-së, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 114 i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: 1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet

shoqëruese, që mbështetin këtë vendim si më poshtë:

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

*3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:*

*a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;*

*b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.*

III.1.5. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shkresa e autoritetit kontraktor, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranim të pjesshëm të ankesës së operatorit ekonomik “SoLed” SHPK, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me pjesën e pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr.1993 prot., datë 22.06.2026, të operatorit ekonomik “SoLed” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “SoLed” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit, konkretisht të grafikut të lëvrimit me arsyetimin se : “...vlerësojmë se kërkesa për furnizimin e 5%, 10% apo 20% të sasive brenda 20 ditëve nga nënshkrimi i kontratës, si dhe kërkesat për furnizime të menjëhershme sipas nevojave të autoriteteve kontraktore gjatë zbatimit të marrëveshjes kuadër, janë joproporcionale, të pajustificuara dhe kufizojnë konkurrencën..... Për këto arsye kërkojmë që dokumentet e tenderit të modifikohen dhe të përcaktohet se furnizimet do të realizohen jo më herët se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës ose nga data e kërkesës për furnizim të autoritetit kontraktor, sipas rastit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1 Në shtojcën nr. 7 “Formulari i Sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, autoriteti kontraktor ka

kërkuar si vijon::

## **Shtojca 7.**

### **FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

#### **Sasia e mallit që kërkohet:**

Sasia e mallit që kërkohet: Sasite, fondi limit/vlera e pritshme e kontratave dhe shpërndarja sipas AK/spitaleve palë në MK të cilat disponojnë fondet dhe më të cilët do të nënshkruhen kontratat e furnizimit të mallrave jepen sipas aneksit 1 të DST për lotin përkatës.

#### **Afatet e lëvrimit:**

Për arsye të krijimit të një sigurie në lëvrimin e mallit pa krijuar vonesa dhe mbulimin në kohë dhe pa probleme të shërbimit, Autoritetet Kontraktore do të lidhin me operatorin ekonomik fitues të dalë nga procedurat e prokurimit, kontrata bazuar në nevojat e tyre brenda nje periudhe 12 mujore për materiale mjekimi, si me poshte:

- Deri në 50% të sasive - 4 mujorin e I
- Deri në 25 % të sasive - 4 mujorin e II
- Deri në 25% të sasive - 4 mujorin e III

Për sa i takon sasive të cilat nuk mund të ndahen për nga pikepamja e ekonomisë procedurale dhe për arsye teknike/organizative, Autoritetet Kontraktore, në vlerësimin e tyre (pa krijuar stok të panevojshëm) mund të lidhin kontrate me të gjithë sasine vjetore brenda një viti buxhetor.

Për çdo kontratë të lidhur sipas përcaktimit më sipër, afatet e lëvrimit të përcaktuara nga Autoritetet Kontraktore, duhet të jenë minimumi 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës me palëve, përveç rasteve të dakordësuara me palëve kontraktuale.

#### **Përveç:**

1- QSUT e cila do të ketë afatet e lëvrimit: 24 muaj nga nënshkrimi i MK. AK do të lidhë kontratë sipas nevojave, për çdo kontratë të lidhur brenda MK, afati i lëvrimit do të jetë:

- o 5 % e sasisë së mallit për secilin material duhet të lëvrohen brenda 20 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
- o Pjesa e sasisë së mbetur duhet të lëvrohet deri në përfundim të kontratës dhe sipas kërkesave të shërbimeve.

2- Q.S.R.T “Shefqet Ndroqi” do të lidhë kontratë në bazë të nevojave të saj në çdo 4 muaj. Përfundimisht këtij përcaktimi, autoriteti kontraktor mund të lidhë kontrata për çdo nevojë që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në çdo kohë. Për çdokontratë të lidhur brenda marrëveshjes kuadër, afatet e lëvrimit do të jenë si më poshtë:

- 20% e vlerës totale të kontratës duhet të lëvrohet brenda 20 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Pjesa e mbetur e sasisë duhet të lëvrohet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

**3- SUOGJ2 (Glozheni), Spitali Devoll dhe Spitali Rajonal Durrës: Afatet e levrimin të mallit do të jenë sipas kërkesës dhe nevojave të AK përfitues.**

**4- Spitali Rajonal Elbasan**

*Për arsye të krijimit të një sigurie në lëvrimin e mallit pa krijuar vonesa dhe mbulimin në kohë dhe pa probleme të shërbimit, Autoriteti Kontraktor do të nënshkruaj kontratën me operatorin ekonomik të suksesshem, sipas nevojave që autoriteti do të ketë me kusht që nga momenti i nënshkrimit të kontratës operatori ekonomik duhet të levrojë brenda 10 ditëve, 10 % të sasisë totale të kontraktuar. Pjesa tjetër do të levrohet periodikisht përgjate afatit të vlefshmerisë së kontratës sipas kërkesave të AK.*

*Per sa i përket procedurës, ajo do të realizohet përmes marrëveshjes kuadër. Autoritetet Kontraktore do të lidhin me operatorin ekonomik fitues të dalë nga procedurat e prokurimit, kontrata bazuar në nevojat e tyre brenda dy periudhave 12 mujore për barna, si më poshtë:*

**12 mujori i parë / i dytë**

- ❖ *Deri në 50% të sasive të pritshme - 4 mujorin e I*
- ❖ *Deri në 30 % të sasive të pritshme - 4 mujorin e II*
- ❖ *Deri në 20% të sasive të pritshme - 4 mujorin e III*

III.2.2. Në vendimin e KSHA-së nr.125/2026, datë 16.07.2026, të përcjellë pranë Komisionin e Prokurimit Publik nëpërmjet shkresës së autoritetit kontraktor nr. 3051/11 prot, datë 17.07.2026, protokolluar me tonën me nr. 1993/5 prot, datë 20.07.2026, mbas komunikimit me autoritetin kontraktor përfitues ka vendosur si më poshtë vijon:

*“.....Për sa më sipër, pas rishikimit të pretendimit të operatorit ekonomik dhe me qëllim balancimin ndërmjet dinamikës reale të tregut të materialeve mjekësore dhe nevojës së institucioneve shëndetësore për furnizim të pandërprerë, MSHMS vlerëson se afati minimal i lëvrimin fillestar duhet të jetë 30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës, i kombinuar me lëvrimin periodik sipas nevojave të autoriteve përfituese. Për këtë arsye, Shtojca 7 riformulohet si më poshtë.....*

*Shtojca 7.*

**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

*Sasia e mallit që kërkohet:*

*Sasia e mallit që kërkohet: Sasite, fondi limit/vlera e pritshme e kontratave dhe shpërndarja sipas AK/spitaleve palë në MK të cilat disponojnë fondet dhe më të cilët do të nënshkruhen kontratat e furnizimit të mallrave jepen sipas aneksit 1 të DST për lotin përkatës.*

*Afatet e lëvrim:*

*Për arsye të krijimit të një sigurie në lëvrimin e mallit pa krijuar vonesa dhe mbulimin në kohë dhe pa probleme të shërbimit, Autoritetet Kontraktore do të lidhin me operatorin ekonomik fitues të dalë nga procedurat e prokurimit, kontrata bazuar në nevojat e tyre brenda një periudhe 12 mujore për materiale mjekimi, si me poshte:*

- Deri në 50% të sasive - 4 mujorin e I*
- Deri në 25 % të sasive - 4 mujorin e II*
- Deri në 25% të sasive - 4 mujorin e III*

*Për sa i takon sasive të cilat nuk mund të ndahen për nga pikepamja e ekonomisë procedurale dhe për arsye teknike/organizative, Autoritetet Kontraktore, në vlerësimin e tyre (pa krijuar stok të panevojshëm) mund të lidhin kontrate me të gjithë sasinë vjetore brenda një viti buxhetor.*

*Për çdo kontratë të lidhur sipas përcaktimit më sipër, afatet e lëvrimin të përcaktuara nga Autoritetet Kontraktore, duhet të jenë minimumi 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës mes palëve, përveç rasteve të dakordësuara mes palëve kontraktuale.*

*Përveç:*

*5- QSUT e cila do të ketë afatet e lëvrimin: 24 muaj nga nënshkrimi i MK. AK do të lidhë kontratë sipas nevojave, për çdo kontratë të lidhur brenda MK, afati i lëvrimin do të jetë:*

- o 5 % e sasisë së mallit për secilin material duhet të lëvrohen brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.*
- o Pjesa e sasisë së mbetur duhet të lëvrohet deri në përfundim të kontratës dhe sipas kërkesave të shërbimeve.*

*6- Q.S.R.T “Shefqet Ndroqi” do të lidhë kontratë në bazë të nevojave të saj në çdo 4 muaj. Përfundimisht këtij përcaktimi, autoriteti kontraktor mund të lidhë kontrata për çdo nevojë që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në çdo kohë. Për çdokontratë të lidhur brenda marrëveshjes kuadër, afatet e lëvrimin do të jenë si më poshtë:*

- o 20% e vlerës totale të kontratës duhet të lëvrohet brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.*
- o Pjesa e mbetur e sasisë duhet të lëvrohet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.*

*7- SUOGJ2 (Glozheni), Spitali Devoll dhe Spitali Rajonal Durrës: Afatet e lëvrimin të mallit do të jenë sipas kërkesës dhe nevojave të AK përfitues.*

## 8- Spitali Rajonal Elbasan

*Për arsye të krijimit të një sigurie në lëvrimin e mallit pa krijuar vonesa dhe mbulimin në kohë dhe pa probleme të shërbimit, Autoriteti Kontraktor do të nenshkruaj kontraten me operatorin ekonomik të suksesshem, sipas nevojave që autoriteti do të ketë me kusht që nga momenti i nenshkrimit të kontratës operatori ekonomik duhet të levrojë bnda 10 diteve, 10 % të sasisa totale të kontraktuar. Pjesa tjetër do të levrohet periodikisht përgjate afatit të vlefshmerise se kontrates sipas kerkesave te AK.*

*Per sa i përket procedurës, ajo do të realizohet përmes marrëveshjes kuadër. Autoritetet Kontraktore do të lidhin me operatorin ekonomik fitues të dalë nga procedurat e prokurimit, kontrata bazuar në nevojat e tyre brenda dy periudhave 12 mujore për barna, si më poshtë:*

*12 mujori i pare / i dyte*

- ❖ Deri në 50% të sasive të pritshme - 4 mujorin e I*
- ❖ Deri në 30 % të sasive të pritshme - 4 mujorin e II*
- ❖ Deri në 20% të sasive të pritshme - 4 mujorin e III...”.*

*III.2.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

*III.2.4. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin*

*mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

*III. 2.5. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi*

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.2.7. Lidhur me vendimin e mësipërm të KSHA-së për pranimin e pjesshëm dhe modifikimin e kërkesës – ku përcaktohet se 5% dhe 20% e sasisë së mallit për secilin material duhet të lëvrohen brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës (nga 20 ditë që ishte fillimisht) – KPP-ja gjykon se ky ndryshim është i pranueshëm, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe nuk cenon interesin publik. Ky afat prej 30 ditësh vendos balancën e duhur midis kohës së mjaftueshme për operatorin ekonomik për të siguruar mallin dhe nevojës emergjente të autoritetit kontraktor. Kërkesa për lëvrimin e një sasive minimale prej 5% dhe 20% të mallit shërben për të garantuar vijueshmërinë e menjëhershme të punës fill pas nënshkrimit të kontratës. Objekti i kësaj procedure përfshin materiale dhe barna mjekësore, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e pacientëve dhe mbarëvajtjen e shërbimit spitalor. Autoriteti kontraktor nuk mund të lejojë periudha pa mbulim me furnizime, pasi kjo do të sillte kolaps në ofrimin e shërbimit shëndetësor publik. Afati prej 60 ditësh i kërkuar nga operatori ekonomik ankimues është i papranueshëm, pasi zhvendos rrezikun e mungesave të stokut tërësisht mbi autoritetin kontraktor dhe pacientët. Modifikimi i afatit në 60 ditë në këtë fazë do të cenonte parimin e barazisë së trajtimit të operatorëve në garë, duke favorizuar kapacitetet logjistike të këtij operatori ekonomik në dëm të të tjerëve që kanë marrë masa për të përmbushur afatin prej 30 ditësh. Komisioni çmon se objekti i këtij prokurimi nuk konsiston në mallra të zakonshme tregtare, por në artikuj dhe produkte mjekësore të domosdoshme për funksionimin e përditshëm të institucioneve shëndetësore. Nisur nga këto nevoja imediate dhe jetike, çdo vonesë në furnizim do të sillte pasoja kritike, deri në kolaps total të shërbimit shëndetësor.

**Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.**

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “SoLed” SHPK për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurë së prokurimit objekt – ankimi, për

heqjen e kufizimit të parashikuar në pikën 2.16 të Dokumenteve të Tenderit dhe lejimin e operatorëve ekonomikë që, në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, duke garantuar kështu konkurrencë më të gjerë, trajtim të barabartë dhe përdorim më efikas të fondeve publike, .Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se

III.3.1. Në pikën 2.16 të DST Autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po      X      Jo      ☐

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera për pikën 1 (furnizimet e mëparshme të ngjashme) dhe pikën 6 (licencë / autorizimit për tregtim të pajisjeve mjekësore) të seksionit 2.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim të kërkuara në DT.

Ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera për pikat si më sipër, pasi përvoja e mëparshme për të zbatuar kontratën dhe disponimi i licencës / autorizimit për tregtim të pajisjeve mjekësore, vlerësohen si kapacitete të lidhura ngushtë me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme e të nevojshme për të krijuar bindjen te AK se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standardeve të kërkuara.

III.3.2. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3. “Kapaciteti teknik”, pika 1 dhe 6 të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar ndër të tjera:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në

*fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara..*

*dhe*

*.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë “Licencë / Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”, i ndryshuar*

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.3.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.3.5. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

- 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
  - a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
  - b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.3.6 Në nenin 84 pika 1,3 dhe 6 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.”

III.3.7. Në nenin 41 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.8. Në nenin 90 pika 1 dhe 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.”

III.3.9. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” e Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar përcaktohet:

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.
2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.
3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.
4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.
5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.
6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.
7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.

III.3.10. Në Nenin 90 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera.

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.
2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;
  - t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.
  - t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.
  - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.
3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.
4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.
5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.
6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.
7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.

III.3.11. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlereson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe ërmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike,

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në rastin konkret duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit i cili kërkon që të hiqet kufizimi i vënë nga autoriteti kontraktor që nuk lejon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera për të provuar përvojën e mëparshme të ngjashme si dhe për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (Licencë / Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”, i ndryshuar), nga shqyrtimi dokumenteve të tenderit rezulton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar aspektet në të cilat nuk lejohet mbështetja dhe që kanë të bëjnë me kufizimet e përmendura më sipër. Ndalimi i mbështetjes në kapacitetet e një subjekti tjetër për kriterin e disponimit të licencës apo autorizimit tregtar është plotësisht i ligjshëm për dy arsye kryesore: së pari Licencat mjekësore dhe autorizimet e lëshuara nga institucionet rregullatore i akordohen një subjekti specifik bazuar në përmbushjen e kushteve të rrepta teknike, higjieno-sanitare dhe profesionale prej vetë atij subjekti. Kjo licencë nuk është një "aset" që mund t'i huazohet një palë të tretë thjesht për efekt kualifikimi formal në tender. Së dyti ligji përcakton shprehimisht se një operator mund të shfrytëzojë aftësinë e një subjekti tjetër për kualifikime profesionale ose licenca “vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë”. Nëse operatori ofertues nuk e gëzon vetë këtë licencë, ai nuk ka të drejtë ligjore të fusë në territorin e Republikës së Shqipërisë apo të tregtojë këto pajisje, duke e bërë kontratën të paekzekutueshme dhe të paligjshme që në fazën fillestare

Lidhur me ndalimin e mbështetjes për furnizimet e mëparshme të ngjashme referuar Nenit 77, pika 3 e LPP-së dhe Neni 43 i VKM-së i njohin autoritetit kontraktor diskrecionin e plotë për të specifikuar “aspektet kritike të kontratës” të cilat duhet të përmbushen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vetë ofertues. Furnizimi me pajisje mjekësore nuk përbën një furnizim me mallra të zakonshme tregtare. Pajisjet mjekësore ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e pacientëve. Autoriteti kontraktor ka nevojë për siguri absolute që operatori që do të menaxhojë kontratën (importin, transportin e kushtëzuar, instalimin dhe kalibrimin) ka përvojën e duhur praktike dhe logjistike. Sipas jurisprudencës së GJDBE-së (Çështja C-324/14, Partner Apelski), mbështetja të të tretët nuk mund të përdoret për të plotësuar kriteret në mënyrë thjesht formale në letër, pa pasur një lidhje reale ekzekutuese. Lejimi i një operatori pa asnjë ditë përvojë në fushën mjekësore që të fitojë një tender kaq sensitiv, duke u “mbështetur” në përvojën e një subjekti tjetër që nuk do të jetë prezent në ekzekutimin ditor të kontratës, zhvendos të gjithë rrezikun e dështimit mbi spitalet dhe pacientët. Përcaktimi i vendosur nga Autoriteti Kontraktor nuk është në kundërshtim me ligjin. Përkundrazi, ai është një mjet i ligjshëm proporcional, i cili mbron interesin publik, garanton zbatimin e saktë të Nenit 84 të LPP-së dhe siguron që kontrata të ekzekutohet vetëm nga një operator ekonomik që zotëron kapacitete reale, të provuara dhe të licencuara.

**Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.**

III.4. Lidhur me ankesen e operatori ekonomik ankimues “SoLed” SHPK përsa i përket pretendimeve lidhur me paligjshmërinë dhe supozimin si joproportional të dy kriterëve të vendosura në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) kriteri i xhiros vjetore (kërkesa për paraqitjen e vërtetimit të xhiros për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku për të paktën një nga vitet vlera duhet të jetë jo më pak se 40% e fondit limit të lotit/lotëve përkatëse) dhe kriteri i përvojës së ngjashme (Kërkesa për dëshmi të furnizimeve të ngjashme gjatë 3 viteve të fundit, në vlerë jo më pak se 39% e fondit limit të lotit/lotëve përkatëse Komisioni i Prokurimit Publik vëren se

III.4.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2. “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar ndër të tjera:

*“1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të lotit apo shumatores së fondit limit të lotëve për të cilat oferton. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.”*

III.4.2. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3. “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar ndër të tjera:

*“1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të lotit apo shumatores së fondit limit të lotëve për të cilat oferton**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”*

III.4.3. Në nenin 2 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të

sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 21 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.4.4. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer

shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.4.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë

*proporcionale me objektin e kontratës.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.4.6. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

*4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

III.4.7. KPP gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët

ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.4.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “SoLed” SHPK Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në vendimin e KSHA-së këto dy pretendime nuk janë marrë në shqyrtim me arsyetimin se “...Ndodhur në kushtet kur Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, çmon të nevojshëm anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, për arsytet e argumentuara sipas pikës 11.2 të këtij Vendimi, gjykojmë se pretendimet e ngritura në lidhje me xhiron e kërkuar si dhe me përvojën e ngjashme nuk do të merren në shqyrtim.

*Kjo për arsye se, me rishpalljen e procedurës së re të prokurimit, Autoriteti Kontraktor do të rishikojë dokumentet e procedurës, përfshirë kushtet dhe kërkesat e saj, të cilat mund të pësojnë ndryshime në funksion të objektit të prokurimit, llojit të procedurës, st dhe vlerës së fondit limit.”*

Përsa i përket paligjshmërisë së kritereve të kapacitetit ekonomik dhe teknik, Komisioni gjykon se rregullat e prokurimit publik të përcaktuara me VKM nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar sanksionojnë shprehimisht se autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë si kapacitet ekonomik dhe financiar një xhiro vjetore deri në një nivel maksimal të caktuar në raport me fondin limit. Kërkesa që operatori të ketë një xhiro vjetore në vlerën jo më pak se 40% të fondit limit për të paktën një nga tre vitet e fundit financiare (2023, 2024, 2025) është dukshëm nën tavanin maksimal që lejon VKM-ja (e cila lejon kërkesa deri në 100% ose më shumë të vlerës së përllogaritur të kontratës në varësi të llojit të procedurës). Për rrjedhojë, ky kriter nuk mund të konsiderohet joproporcional, pasi është një prag minimal sigurie që garanton se operatori ka likuiditetin e mjaftueshëm për të përballuar financimin e kontratës.

Sipas përcaktimeve të VKM-së për vlerësimin e kapacitetit teknik dhe profesional, Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë dëshmi të realizimit të furnizimeve të ngjashme në një vlerë monetare të specifikuar gjatë tri viteve të fundit. VKM-ja e thotë qartë: "vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur". Duke kërkuar saktësisht 39%, Autoriteti Kontraktor ka zbatuar pikë për pikë këtë rregull, duke qëndruar nën tavanin maksimal ligjor. Ky përcaktim reflekton përdorimin e drejtë të diskrecionit për të hapur garën maksimalisht, pa thyer kufijtë normativë. Xhiroja vjetore (40%): Në mënyrë analoge, kërkesa për xhiro vjetore prej 40% për të paktën një nga vitet financiare përputhet me logjikën proporcionale të kritereve të kapacitetit ekonomik të lejuara nga kuadri rregullator i prokurimit, duke mos vendosur asnjë barrë shtesë jashtë praktikave standarde të VKM-së..

Duke qenë se objekti i prokurimit është “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme dhe kirurgjikale për nevoja spitalore”, kemi të bëjmë me artikuj jetikë për shëndetin e popullatës. Kriteret e xhiros (40%) dhe përvojës (39%) nuk janë barriera artificiale, por filtra të domosdoshëm ligjorë të parashikuar nga VKM-ja për të shmangur operatorët fiktivë ose të

papërgatitur, dështimi i të cilëve do të sillte bllokimin e operacioneve në spitalet e vendit. Asnjë tejkalim i kompetencave diskrecionale: Autoriteti Kontraktor ka ushtruar të drejtën e tij diskrecionale brenda kufijve të lejuar shprehimisht nga VKM-ja dhe DST të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik APP. Operatori ankimues nuk ka sjellë asnjë argument juridik se përse këto përqindje bien ndesh me VKM-në, për sa kohë ato janë plotësisht brenda parametrave normativë.

Në analizë të themlit të pretendimeve të operatorit ekonomik 'SoLed' SHPK lidhur me kriteret e xhiros vjetore (40%) dhe përvojës së ngjashme (39%), Komisioni konstaton se këto pretendime janë tërësisht të pabazuara në ligj. Referuar dispozitave urdhëruese të VKM-së në fuqi për prokurimin publik, përcaktohet shprehimisht se: "ë çdo rast, vlera totale e kërkuar për përvojën e mëparshme duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës". Referuar DST, rezulton se Autoriteti Kontraktor ka kërkuar dëshmi të furnizimeve të ngjashme në masën 39%, dhe xhiro vjetore në masën 40%, duke qëndruar në mënyrë strikte brenda kufirit maksimal ligjor të sanksionuar nga VKM-ja. Ky përcaktim është plotësisht i ligjshëm, proporcional dhe i diktuar nga rëndësia e objektit të prokurimit për shëndetësinë spitalore. Për rrjedhojë, përveç rënies së objektit të ankimit për shkak të anulimit të procedurës, këto dy pretendime rrëzohen edhe në theml si të pambështetura në VKM.

### **Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.**

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "SoLed" SHPK për rishikimin e strukturës së procedurës së prokurimit dhe ndarjen e saj sipas institucioneve përfituese ose sipas grupeve funksionale të spitaleve, në përputhje me nevojat reale të secilit autoritet kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik

III.5.1. Referuar dokumentit të titulluar "Loti 2 \_ Aneks 1 për MM2", i cili është pjesë përbërëse e Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST) të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), evidentohen qartë institucionet spitalore përfituese për nevojat e të cilave zhvillohet kjo procedurë prokurimi, e cila është objekt ankimi. Ky dokument dëshmon se Autoriteti Kontraktor ka grumbulluar në një lot të vetëm nevojat e disa institucioneve të ndryshme, pa kryer ndarjen e tyre sipas spitaleve apo grupeve funksionale, duke rënë kështu në kundërshtim me parimin e moskufizimit të konkurrencës dhe efektivitetit të fondeve publike.

III.5.2. Neni 2 "Qëllimi i ligjit "162/2021 "Për prokurimin publik", i ndryshuat, parashikon se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; d
- h) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

| 121 | Suture Sintetike e absorbueshme 180 ditë, USP 3-0                                                                  | Me përbërje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa në një drejtim rreth gjithë trupit të fijos dhe me lak në fund,                                          | Copë |

|                             |                                                                                |                                                                                                                                                                                       |      |
|-----------------------------|--------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
|                             |                                                                                | gjatësi 45cm, age 3/8, 19mm, reverse cutting                                                                                                                                          |      |
| 122                         | Suture Sintetike e absorbueshme 180 ditë, USP 3-0                              | Me përbërje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa në një drejtim rreth gjithë trupit të fijos dhe me lak në fund, gjatësi 45cm, age 1/2, 17mm, taper point | Copë |
| 123                         | Suture Sintetike e absorbueshme 180 ditë, USP 0                                | Me përbërje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa në një drejtim rreth gjithë trupit të fijos dhe me lak në fund, gjatësi 60cm, age 1/2, 37mm, taper point | Copë |
| <b>Suturë Polipropileni</b> |                                                                                |                                                                                                                                                                                       |      |
| 124                         | Polypropylene-USP1, Gjatësia e fijos 70-90cm; dimensiononi i ageve 30-40 mm    | 1/2 rrethore                                                                                                                                                                          | Copë |
| 125                         | Polypropylene-USP1, Gjatësia e fijos 70-90cm; dimensiononi i ageve 40-50 mm    | 1/2 rrethore shpuese                                                                                                                                                                  | Copë |
| 126                         | Polypropylene-USP1, Gjatësia e fijos 75-90cm; dimension i ageve 40-50 mm       | 1/2 rrethore, cutting                                                                                                                                                                 | Copë |
| 127                         | Polypropylene-USP0, Gjatësia e fijos 70-90cm; dimensiononi i ageve 30-40 mm    | 1/2 rrethore                                                                                                                                                                          | Copë |
| 128                         | Polypropylene-USP0, Gjatësia e fijos 40-50cm; dimensiononi i ageve 30-40 mm    | 1/2 rrethore shpuese                                                                                                                                                                  | Copë |
| 129                         | Polypropylene-USP2-0, Gjatësia e fijos 70-90cm; dimensiononi i ageve 25-30 mm  | 1/2 rrethore                                                                                                                                                                          | Copë |
| 130                         | Polypropylene-USP2-0, Gjatësia e fijos 70-90cm; dimensiononi i ageve 30-40 mm  | 1/2 rrethore shpuese                                                                                                                                                                  | Copë |
| 131                         | Polypropylene-USP3-0, Gjatësia e fijos 70-90cm; dimensiononi i ageve 25-30 mm  | 1/2 rrethore                                                                                                                                                                          | Copë |
| 132                         | Polypropylene-USP3-0, Gjatësia e fijos 70-90cm; dimensiononi i ageve 20-30 mm  | 1/2 rrethore shpuese                                                                                                                                                                  | Copë |
| 133                         | Polypropylene-USP4-0, Gjatësia e fijos 60-90cm; dimensiononi i ageve 25-30 mm  | 1/2 rrethore                                                                                                                                                                          | Copë |
| 134                         | Polypropylene-USP4-0, Gjatësia e fijos 70-90cm; dimensiononi i ageve 17-22 mm  | 1/2 rrethore shpuese                                                                                                                                                                  | Copë |
| 135                         | Polypropylene-USP 5-0, Gjatësia e fijos 70-90cm; dimensiononi i ageve 17-22 mm | 1/2 rrethore shpuese                                                                                                                                                                  | Copë |
| 136                         | Polypropylene-USP1, Gjatësia e fijos 75cm;                                     | 1/2 rrethore, cutting                                                                                                                                                                 | Copë |

|                             |                                                                                    |                                                                                                                                          |      |
|-----------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
|                             | dimensioni i ageve 30 mm                                                           |                                                                                                                                          |      |
| 137                         | Polypropylene-USP2-0,<br>Gjatësia e fijeve 75cm;<br>dimensioni i ageve 30 mm       | 1/2 rrethore, cutting                                                                                                                    | Copë |
| 138                         | Polypropylene-USP3-0,<br>Gjatësia e fijeve 75cm;<br>dimensioni i ageve 24 mm       | 3/8 rrethore, cutting                                                                                                                    | Copë |
| 139                         | Polypropylene-USP3-0,<br>Gjatësia e fijeve 45-50cm;<br>dimensioni i ageve 14-15 mm | age 3/8 rrethore, reverse cutting, slip point                                                                                            | Copë |
| 140                         | Polypropylene-USP4 -0,<br>Gjatësia fijeve 45-50cm;<br>dimensioni i ageve 14-15 mm  | age 3/8 rrethore, reverse cutting, slip point                                                                                            | Copë |
| <b>Sutura PVDF</b>          |                                                                                    |                                                                                                                                          |      |
| 141                         | Monofilament PVDF, e pa<br>absorbueshme; USP 6/0                                   | 0.7 metric, reverse cutting, 12mm 3/8 circle,<br>length 45 cm                                                                            | Copë |
| 142                         | Monofilament PVDF, e pa<br>absorbueshme; 2+2 USP 6/0                               | 0.7 metric, reverse cutting, 12mm 3/8 circle,<br>length 76 cm                                                                            | Copë |
| 143                         | Monofilament Sutura PVDF,<br>e pa absorbueshme; USP 3/0                            | 2 metric, straight cutting, 60mm straight,<br>length 100 cm                                                                              | Copë |
| 144                         | Monofilament Sutura PVDF,<br>e pa absorbueshme; USP 6/0                            | 0.7 metric, reverse premium cutting, 12mm<br>3/8 circle, length 45 cm                                                                    | Copë |
| 145                         | Monofilament PVDF, e pa<br>absorbueshme; USP 4/0                                   | 1.5 metric, reverse premium cutting, 16mm<br>3/8 circle, length 45 cm                                                                    | Copë |
| 146                         | Monofilament PVDF, e pa<br>absorbueshme; USP 3/0                                   | 2 metric, fineline cutting, 25mm 3/8 circle,<br>length 45 cm                                                                             | Copë |
| 147                         | Monofilament Sutura PVDF,<br>e pa absorbueshme; USP 2/0                            | 3 metric, Taper, 25mm 1/2 circle, length 90<br>cm                                                                                        | Copë |
| 148                         | Monofilament Sutura PVDF<br>e pa absorbueshme; 2/0                                 | 3 metric, Round bodied taper, 30mm 1/2<br>circle, length 76 cm                                                                           | Copë |
| <b>Sutura PVDF e verdhë</b> |                                                                                    |                                                                                                                                          |      |
| 149                         | Monofilament PVDF i<br>verdhë, e pa absorbueshme<br>USP 3/0,                       | 2 metric, reverse cutting, 24mm 3/8 circle,<br>length 45 cm                                                                              | Copë |
| 150                         | Monofilament PVDF i<br>verdhë e pa absorbueshme<br>USP 2/0                         | 3 metric, reverse cutting, 25mm 1/2 circle,<br>length 76 cm                                                                              | Copë |
| 151                         | Monofilament PVDF i<br>verdhë, e pa absorbueshme<br>USP 4/0,                       | 1.5 metric, taper, 20mm 1/2 circle, length 90<br>cm                                                                                      | Copë |
| 152                         | Monofilament PVDF i<br>verdhë, e pa absorbueshme<br>USP 3/0,                       | 2 metric, Round bodied taper, 16mm 1/2<br>circle, length 45 cm                                                                           | Copë |
| 153                         | Shirit Polyester i pa<br>absorbueshëm për serklazh<br>0.5cm                        | Për trajtimin e qafes së mitrës gjatë<br>shtatëzanisë sipas teknikës Shirodkar, gjatësi<br>50cm, me dy age 65mm në të dy anët e shiritit | Copë |

| <b>Mesh kirurgjikal për hernia-laparaskopi</b> |                                                                                    |                                                                                                                                                                                                        |      |
|------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| <b>154</b>                                     | Mesh polypropyleni - formë drejtkendore                                            | Fije monofilament; pesha e meshës 80-90g/m2, sipërfaqja jo më pak se 112cm2                                                                                                                            | Copë |
| <b>155</b>                                     | Mesh e vogël                                                                       | Pjesërisht e absorbueshme (90-120 ditë) me përbërje polipropilen dhe PGA dhe koprolakton (PP/PGACL) Fije monofilament; pesha e meshës < 30 g/m2, sipërfaqja jo më pak se 150cm2                        | Copë |
| <b>156</b>                                     | Mesh e madhe                                                                       | Pjesërisht e absorbueshme (90-120 ditë) me përbërje polipropilen dhe PGA dhe koprolakton (PP/PGACL) Fije monofilament; pesha e meshës < 30 g/m2, sipërfaqja jo më pak se 900cm2, porozitet > 75 mikron | Copë |
| <b>157</b>                                     | MESH PVDF/PP                                                                       | Mesh e përbërë me dy komponente 88% PVDF dhe 12% polypropylene (PP) 10cm x15 cm ose ekuivalent                                                                                                         | Copë |
| <b>158</b>                                     | MESH PVDF                                                                          | Mesh me monofilament PVDF për korrigjim kirurgjikal inkontinencës urinare mikse ose nga sforcimi me teknikë minimalisht invazive, 0.1 cm x 50 cm ose ekuivalent                                        | Copë |
| <b>159</b>                                     | MESH PVDF Hiatus                                                                   | Mesh me monofilament PVDF për korrigjim kirurgjikal të hernies aksiale dhe paraezofageale, 0.7 cm x 12 cm                                                                                              | Copë |
| <b>Sutura për okulistike</b>                   |                                                                                    |                                                                                                                                                                                                        |      |
| <b>160</b>                                     | Polyamide 6 dhe 66- USP 10-0, Gjatësia e fijes 30-45 cm, Dimensioni i ageve 5-8 mm | spatula 1/2ose 3/8 rrethore, double                                                                                                                                                                    | Copë |
| <b>161</b>                                     | Polyamide 6 dhe 66- USP 9-0, Gjatësia e fijes 30-45 cm, Dimensioni i ageve 5-8 mm  | spatula 1/2ose 3/8 rrethore, double                                                                                                                                                                    | Copë |
| <b>162</b>                                     | Polypropylene- USP 6-0; Gjatësia e fijes 75 cm, Dimensioni i ages 13 mm            | 3/8 rrethore                                                                                                                                                                                           | Copë |
| <b>Të tjera materiale qepës kirurgjikale</b>   |                                                                                    |                                                                                                                                                                                                        |      |
| <b>163</b>                                     | Tel metalik                                                                        | Tel celiku monofilament nr.7 48 mm 1/2 reverse cutting 4 X 45 cm                                                                                                                                       | Copë |
| <b>164</b>                                     | Stapler                                                                            | Linear 30/60/90 mm                                                                                                                                                                                     | Copë |
| <b>165</b>                                     | Stapler rrethor 25mm / 28mm / 31mm                                                 | Stapler njëpërdorimësh rrethor 28mm, gjatësia e boshtit 22 cm dhe me kapëse 4.8mm në formë drejtëkëndore, anvili të jetë me mekanizem tilt                                                             | Copë |
| <b>166</b>                                     | Stapler Endoskopie                                                                 | Stapler njëpërdorimësh i rikarikueshëm, gjatësia e boshtit 16cm dhe 6cm, artikulacion +/-45 gradë dhe me 11 pozicione                                                                                  | Copë |
| <b>167</b>                                     | Stapler linear prerës                                                              | 60-80 mm                                                                                                                                                                                               | Copë |

|                                                |                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |       |
|------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| 168                                            | Stapler për lëkurë                                                                | Të ketë jo më pak se 35 kapëse të gjera                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Copë  |
| 169                                            | Kartrixh për Stapler Endoskopie                                                   | Kartrixh i artikulluar me tre rrjeshta me lartësi të ndryshme (2;2.5;3mm dhe 3;3.5;4mm), 30mm;45mm;60mm                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Copë  |
| 170                                            | Aplikator automatik klipash                                                       | Medium                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Copë  |
| 171                                            | Elektroda, njëpërdorimëshe, për mbylljen e enëve të gjakut në formë gërshere      | Elektroda, njëpërdorimëshe, për mbylljen e enëve të gjakut deri në/përfshirë 7 mm. Prerje (devaskularizimi i organeve), me majë të harkuar, thikë të integruar të pavarur nga ngjitja, me buton aktivizimi në elektrodë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Copë  |
| 172                                            | Elektroda njëpërdorimëshe për tiroidektomi                                        | Instrument për ngjitjen e enëve të gjakut deri në/përfshirë 7 mm; të jetë në formë gërshere; me majë të harkuar; gjatësia totale 18-19 cm; gjatësia e ngjitjes 16.5mm; gjatësia e prerjes 14.7mm                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Copë  |
| 173                                            | Elektroda me majë Maryland, njëpërdorimëshe, për mbylljen e enëve të gjakut, 23cm | Elektroda me majë Maryland, njëpërdorimëshe, për mbylljen e enëve të gjakut deri në/përfshirë 7 mm, 23cm. Prerje (devaskularizimi i organeve), i rrotullueshëm 350 gradë, gjatësi nofulle 20mm, prerje 18mm, me thikë të integruar të pavarur nga ngjitja.                                                                                                                                                                                                                                                                 | Copë  |
| 174                                            | Kanjule ultrasonike standarde                                                     | Gjatësia 78-80mm, diametri OD 2.5-2.7, 23Khz                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Copë  |
| 175                                            | Kanjule ultrasonike makro                                                         | Gjatësia 75-78mm, diametri OD 3.2-3.5, 23Khz                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Copë  |
| 176                                            | Kanjule ultrasonike per Ind Reziistent                                            | Gjatësia 78-80mm, diametri OD 2.7-2.9, 23Khz                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Copë  |
| 177                                            | Set tubash me lidhje te shpejte                                                   | përfshirë kartrixhen                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Copë  |
| 178                                            | Celës dinamometrik                                                                | për kanjule 23Khz                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | Copë  |
| 179                                            | Copë e absorbueshme ngjitëse                                                      | Për hemostazë dhe ngjitje. Të jetë prej sfungjeri të thatë, por me mundësi konvertimi në formë xhelatine. I absorbueshëm në 14 -15 ditë. Të ketë të paktën 40 minikolona për cm2. Pa proteina të nxjerra nga gjaku. Permasa 8x5x1cm                                                                                                                                                                                                                                                                                        | Copë  |
| <b>Dezinfektantë mjekësorë dhe kirurgjikal</b> |                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |       |
| 180                                            | Dezinfektant instrumentash me bazë Glutaraldehide-Formaldehide                    | Për dezinfektimin manual të instrumenteve kirurgjikale, përfshirë endoskopet dhe fibroskopet. Të ketë efekt baktericid, fungicid, tuberkulocid, antiviral (përfshirë HBV/HIV). Të furnizohet si komplet me solucion e pa -aktivizuar dhe aktivizuesin për përzierjen dhe përfundimin e solucionit të gatshëm për përdorim. Përmbajtja: min. 2% glutaraldehide, etj. Të furnizohet si solucion i gatshëm për përdorim (max 5 litra / ene). Të ketë referenca përdorimi nga firmat e njohura të endoskopeve dhe fibroskopeve | litra |

|     |                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |       |
|-----|----------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| 181 | Solucion i koncentruar enzimatik | Për pastrimin e mbetjeve në instrumentat mjekësore-kirurgjikale, veçanërisht endoskopet dhe instrumentat mjekësore dhe kirurgjikale me pjesë të lëvizeshme dhe lumene të vegjël. Të ketë bazë enzimatike. Të furnizohet si koncentrat për t'u holluar me ujë në masën 1-3% . Të jetë efektiv për punë në ujë me temperaturë të zakonshme (~20°) | litra |
| 182 | Drape dezinfektuese              | Drape higjienike të gatshme për përdorim, të imprenjuara me solucion pastrues dhe dezinfektues. Për pastrimin dhe dezinfektimin e sipërfaqeve të vogla të pajisjeve dhe instrumentave mjekësore; 100-200 copë / kuti                                                                                                                            | Copë  |
| 183 | Detergjent                       | Dezinfektim të shpejtë dhe të vazhdueshme të të gjitha sipërfaqeve, plane sanitare, dysheme, dhe objekteve. Dezinfektanti përmban 10 % Didecildimetilammonio Cloruro dhe 2 % Isotiazolinone Magnesio Cloruro , përdoret duke u tretur 20 ml në 1 litër ujë.                                                                                     | litra |
| 184 | Xhel shumëpërdorimësh            | Për dezinfektimin e duarve të personelit mjekësor , Antiseptik i shpejtë dhe efektiv, i gatshëm për ta përdorur pa nevojën e përdorimit të ujit për shplarje. Të furnizohet në enë 1 - 3 litër të pajisura me dozator.                                                                                                                          | litra |
| 185 | Chlorhexidine gluconate          | 4% chlorexidine gluconate; . Antiseptik me efekt baktericid, fungicid, antiviral . Për kirurgët për dezinfektimin e duarve , larja e plotë e pacientëve përpara ndërhyrjes kirurgjikale, i gatshëm për ta përdorur                                                                                                                              | litra |
| 186 | Peroksid Hidrogjeni 3%           | Peroksid hidrogjeni 3% e vëllimit . Për përdorim të plagëve të jashtme , i gatshëm për ta përdorur                                                                                                                                                                                                                                              | litra |
| 187 | Formaldehid                      | Solucion 35-40%                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | litra |
| 188 | Benzalchonium chloride 10%       | Benzalconium chloride 10%. Për dezinfektimin dhe pastrimin e sipërfaqeve. Efekt baktericid, mycobaktericid, antiviral.                                                                                                                                                                                                                          | litra |

**Shënim: Për çdo certifikatë, standard, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre**

**Afati i skadencës:** Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës ose jo më e vogël se 12 muaj nga data e lëvrimit të mallit në destinacion, sipas kërkesës së AK përfitues gjatë zbatimit të MK. Skadenca duhet të jetë e shënuar në ambalazh.

**Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.**

**Materialet e mjekimit duhet të permbushin standartet CE ose CE sipas direktivës MDD/MDR 93/42 EEC. Ato duhet të jenë të markuara CE në momentin e lëvrimit të mallit.**

III.6.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.6.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.6.4. Në nenin 36, “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore*

nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet

*ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”.*

III.6.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor, edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP-ja gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet, si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështetet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u

referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt- kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu, referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: “Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojcës VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet “Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: “specifikim teknik” nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe

vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të parashtrojnë pretendime mbi modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” është përafshuar pjesërisht edhe me Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar”. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): “Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar”. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, që bie në kundërshtim me LPP, mund ta kundërshtojë këtë vendim.” Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendojsen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson se, fakti se nëse një ose disa produkte të një ose disa prodhuesve vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor nuk përbën një kusht sine qua non, se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuarit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të

cilin parashikohet se: “në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtarë me reputacion.

III.6.6. KPP-ja gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.6.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “SoLed” SHPK mbi modifikimin e specifikimeve teknike për produktet numër 27; 64; 69; 70; 71; 73; 74; 119; 120; 121; 122; 123; 157; 165; 173; 174; 175; 176; 177; 178; 179;

27 *Gjuhëza për laringoskop me kamera* *Paketim steril, material polimer optik, Nr.2,3,4*

64 *Beze kirurgjikale aktive 7.5 cm x 7.5 cm* *Copë e thurur, me thithje të shpejtë për plagë, me përbërës polyakrylate (SAP) me veshje celuloze and solucion ringer, 7.5 cm x 7.5 cm ose ekuivalent*

69 *Beze me vazeline* *Beze me pomadë të thjeshtë (vazeline të bardhë, estere acid yndyror digliceroli të karbonateve dhe bikarbonateve, dyll sintetik) e përshkueshme nga ajri dhe eksudati, me shtresë të trashë që nuk fshihet dhe në rast të eksudatit masiv, jo alergjike, efektive dhe për trajtim afatgjatë. 7.5cm x10 cm ose ekuivalent*

70 *Beze hidroxhel* *Beze e sfungjertë hidropolimere, hidroxheli me përbërje poliure/poliuretan-poliuretan polimer, propilen glikol, me buzë adezive poliakrilat. Përmasa 15x15 cm;*

71 *Beze për trajtimin e plagëve kronike* *Beze me argjend për trajtimin e plagëve kronike, si ulçerat e këmbës, ulçerat diabetike Shtresë sterile, jo-ngjitëse poliamidi i veshur me argjend, me pomadë jo-ngjitëse. shkrijra e pomadës: 35–45°C Peshë e pomadës: minimumi 157 g/m<sup>2</sup> Përmbajtja e argjendit minimumi 8.4%, 10 x 20 ose ekuivalent*

73 *Beze me xhel* *Beze hidrocoloide me elastomer sintetik, vaj mineral, natrium karboksimetil me celulozë vetëngjitëse dhe absorbente, e mbuluar me një shtresë gjysmë-të përshkueshme për të parandaluar depërtimin bakterial, shndërrohen në xhel dhe krijojnë një mjedis të lagësht për plagën. Fleksibël dhe të vendoset lehtësisht sipas kontureve të trupit; 7,5 x 7,5 cm ose ekuivalent*

74 Beze silikoni Beze silikoni sterile, e butë dhe e përshkueshme, e bërë nga një rrjetë polietileni tereftalat (PET), e veshur në të dyja anët me xhel silikoni (me bazë polidimetilsiloksani). Pesha totale: 224–272 g/m<sup>2</sup> Pesha e xhelit: 180–220 g/m<sup>2</sup> Hapja e poreve: ≥ 96% 7,5 x 10 cm ose ekuivalent

119 Suture Sintetike e absorbueshme nga 90-110 ditë, USP 3-0 Me përbërje Glikolid, diaksanone dhe trimetilen karbonati, me luspa në një drejtim rreth gjithë trupit të fijes dhe me lak në fund, gjatësi 23cm, age 5/8, 27mm, taper point

120 Suture Sintetike e absorbueshme 180 ditë, USP 2-0 Me përbërje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa në një drejtim rreth gjithë trupit të fijes dhe me lak në fund, gjatësi 45cm, age 1/2, 26mm, taper point

121 Suture Sintetike e absorbueshme 180 ditë, USP 3-0 Me përbërje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa në një drejtim rreth gjithë trupit të fijes dhe me lak në fund, gjatësi 45cm, age 3/8, 19mm, reverse cutting

122 Suture Sintetike e absorbueshme 180 ditë, USP 3-0 Me përbërje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa në një drejtim rreth gjithë trupit të fijes dhe me lak në fund, gjatësi 45cm, age 1/2, 17mm, taper point

123 Suture Sintetike e absorbueshme 180 ditë, USP 0 Me përbërje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa në një drejtim rreth gjithë trupit të fijes dhe me lak në fund, gjatësi 60cm, age 1/2, 37mm, taper point

157 MESH PVDF/PP Mesh e përbërë me dy komponente 88% PVDF dhe 12% polypropylene (PP) 10cm x15 cm ose ekuivalent

165 Stapler rrethor 25mm / 28mm / 31mm Stapler njëpërdorimësh rrethor 28mm, gjatësia e boshtit 22 cm dhe me kapëse 4.8mm në formë drejtëkëndore, anvili të jetë me mekanizëm tilt

173 Elektroda me majë Maryland, njëpërdorimëshe, për mbylljen e enëve të gjakut, 23cm Elektroda me majë Maryland, njëpërdorimëshe, për mbylljen e enëve të gjakut deri në/përfshirë 7 mm, 23cm. Prerje (devaskularizimi i organeve), i rrotullueshëm 350 gradë, gjatësi nofulle 20mm, prerje 18mm me thikë të integruar të pavarur nga ngjitja.

174 Kanjule ultrasonike standarde Gjatësia 78-80mm, diametri OD 2.5-2.7, 23Khz

175 Kanjule ultrasonike makro Gjatësia 75-78mm, diametri OD 3.2-3.5, 23Khz

176 Kanjule ultrasonike per Ind Rezistent Gjatësia 78-80mm, diametri OD 2.7-2.9, 23Khz

177 Set tubash me lidhje te shpejte përfshirë kartrixhen

178 Celës dinamometrik për kanjule 23Khz

179 *Copë e absorbueshme ngjitëse* *Për hemostazë dhe ngjitje. Të jetë prej sfungjeri të thatë, por me mundësi konvertimi në formë xhelatine. I absorbueshëm në 14 -15 ditë. Të ketë të paktën 40 minikolona për cm<sup>2</sup>. Pa proteina të nxjerra nga gjaku. Permasa 8x5x1cm”, Komisioni Prokurimit Publik vëren se:*

III.6.7.1. Autoritetit Kontraktor me vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave i ka pranuar pjesërisht pretendimet e operatorit ekonomik ankimues duke ndryshuar këto kritere si më poshtë vijon:

27 *Gjuhëza për laringoskop me kamera* *Paketim steril, material polimer optik, ose ekuivalent Nr.2,3,4*

64 *Beze kirurgjikale aktive 7.5 cm x 7.5 cm* *Copë e thurur, me thithje të shpejtë për plagë, me përbërës polyakrylate (SAP) me veshje celuloze and solucion ringer, 7.5 cm x 7.5 cm ose ekuivalent*

69 *Beze me vazeline* *Beze me pomadë të thjeshtë (vazeline të bardhë, ose përbërje hidrokarbure/parafine me funksion ekuivalent) veshja e impreguar me vazeline dhe e destinuar për mbrojtjen e plagës është jo aderente për plagët. 7.5cm x10 cm +/-10%*

70 *Beze hidroxhel* *Beze e mjekësore hidrogel/hidropolimere me strukturë sfungjerore, me shtresë kontakti prej hidroxheli e mbështetur nga sfungjer i butë dhe e laminuar me film poliuritani, e përshkueshme nga ajri dhe eksudati. Përmasa 15cmx15 cm +/-10%*

71 *Beze për trajtimin e plagëve kronike* *Beze me argjend për trajtimin e plagëve kronike, si ulçerat e këmbës, ulçerat diabetike Shtresë sterile, jo-ngjitëse poliamidi i veshur me argjend, me pomadë jo-ngjitëse. shkrirja e pomadës: 35–45°C +/-2% Peshë e pomadës: minimumi 157 g/m<sup>2</sup> +/-2% Përmbajtja e argjendit minimumi 8.4%, 10 x 20 +/-2% ose ekuivalent*

73 *Beze me xhel* *Beze hidrocoloide me material mbështetës, vetëngjitëse dhe absorbente prej poliuritani gjysmë të përshkueshëm, rezistent ndaj baktereve, e cila shndërrohet në xhel gjatë kontaktit me eksudatin dhe krijon një mjedis të lagësht për plagën duke qenë fleksibël dhe të pershtatshme për vendosje sipas kontureve të trupit; 7,5 x 7,5 cm +/-10%*

74 *Beze silikoni* *Beze silikoni sterile, të butë dhe të përshkueshme, të bërë nga një rrjetë polietileni tereftalat (PET), e veshur në të dyja anët me xhel silikoni (me bazë polidimetilsiloksani). Me peshë të xhelit: 180–220 g/m<sup>2</sup> Hapja e poreve: ≥ 96% dhe përmasa 7,5 x 10 +/-10%*

119 Suture Sintetike e absorbueshme nga 90-110 ditë +/- **10%**, USP 3-0 Me përbërje Glikolid, diaksanone dhe trimetilen karbonati **ose ekuivalent**, me luspa në një drejtim rreth gjithë trupit të fijos dhe me lak në fund, gjatësi 23cm, age 5/8, 27mm, taper point

120 Suture Sintetike e absorbueshme 180 ditë +/-**10%**, USP 2-0 Me përbërje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni **ose ekuivalent**, me luspa në një drejtim rreth gjithë trupit të fijos dhe me lak në fund, gjatësi 45cm, age 1/2, 26mm, taper point

121 Suture Sintetike e absorbueshme 180 ditë +/-**10%**, USP 3-0 Me përbërje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni **ose ekuivalent**, me luspa në një drejtim rreth gjithë trupit të fijos dhe me lak në fund, gjatësi 45cm, age 3/8, 19mm, reverse cutting

122 Suture Sintetike e absorbueshme 180 dit +/-**10%**, USP 3-0 Me përbërje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni **ose ekuivalent**, me luspa në një drejtim rreth gjithë trupit të fijos dhe me lak në fund, gjatësi 45cm, age 1/2, 17mm, taper point

123 Suture Sintetike e absorbueshme 180 ditë +/-**10%**, USP 0 Me përbërje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni **ose ekuivalent**, me luspa në një drejtim rreth gjithë trupit të fijos dhe me lak në fund, gjatësi 60cm, age 1/2, 37mm, taper point

157 MESH PVDF/PP Mesh e përbërë me dy komponente **60% deri 88% PVDF dhe 12% - 40% polypropylene (PP) ose ekuivalente 8-10cm x10 cm -15 cm ose ekuivalent**

165 Stapler rrethor 25mm / 28mm / 31mm Stapler njëpërdorimësh rrethor 28mm, gjatësia e boshtit 22cm+/-**10%** dhe me kapëse 4.8mm në formë drejtëkëndore, anvili të jetë me mekanizëm tilt

173 Elektroda me majë Maryland, njëpërdorimëshe, për mbylljen e enëve të gjakut, 23cm Elektroda me majë Maryland, njëpërdorimëshe, për mbylljen e enëve të gjakut deri në/përfshirë 7 mm, 23cm. Prerje (devaskularizimi i organeve), i rrotullueshëm 350 gradë, gjatësi nofullë 20mm, prerje 18mm +/-**10%**, me thikë të integruar të pavarur nga ngjitja.

174 Kanjule ultrasonike standarde **ose ekuivalente** Gjatësia 78-80mm, diametri OD 2.5-2.7, 23Khz +/-**10%**

175 Kanjule ultrasonike makro **ose ekuivalent** Gjatësia 75-78mm, diametri OD 3.2-3.5, 23Khz +/-**10%**

176 Kanjule ultrasonike per Ind Rezistent **ose ekuivalent** Gjatësia 78-80mm, diametri OD 2.7-2.9, 23Khz +/-**10%**

177 Set tubash me lidhje te shpejte **ose ekuivalent** përfshirë kartrixhen **ose ekuivalent**

178 *Celës dinamometrik ose ekuivalent për kanjule 23Khz +/-10%*

179 *Copë e absorbueshme ngjitëse Për hemostazë dhe ngjitje. Të jetë prej sfungjeri të thatë, por me mundësi konvertimi në formë xhelatine. I absorbueshëm në 14 -15 ditë. Të ketë të paktën 30 minikolona për cm<sup>2</sup> ose ekuivalent.. Pa proteina të nxjerra nga gjaku. Permasa 8x5x1cm +/-10%*

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me pajisjen e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në të drejtë të autoritetit kontraktor të përcaktojë, specifikime teknike dhe parametra të caktuara, me qëllim performancën sa më të mirë të materialeve të cilat nuk bien ndesh me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik apo me parashikimet e nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e kritereve dhe/ose specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. K.P.P thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Kriteret e vendosura dhe/ose specifikimet teknike, duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në hartimin e kritereve dhe/ose specifikimeve teknike autoritet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi qoftë ato të dukshme qoftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast kriteret dhe/ose specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/mall/shërbim që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, dhe në hartimin e kritereve dhe/ose specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se kriteret

dhe/ose specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar.

Lidhur me pretendimet e ankimuesit dhe pas modifikimit të artikujve të mësipërm, KPP-ja gjykon se për specifikimet teknike të disa artikujve autoriteti kontraktor ka përfshirë shprehjen “ose ekuivalent”. Ky përcaktim është në përputhje me kuptimin e Nenit 4, Pika 7 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku specifkohet se: *“Ekuivalente” është malli ose shërbimi i ofruar me karakteristika të barasvlefshme me ato që janë përcaktuar në specifikimin teknik të objektit të prokurimit.*” Për disa artikuj të tjerë, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar hapjen e diapazonit mbi përmasat ose frekuencat me një marzh tolerance prej +/-10%.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ndryshimet e specifikimeve teknike për artikujt e mësipërm nga ana e autoritetit kontraktor janë hartuar në përputhje me nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe vlerësohen nga Komisioni si pranimit plotë i pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues.

**Sa më sipër, Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këto pretendime të operatorit ekonomik “SoLed” SHPK.**

III.6.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “SoLed” SHPK për

- ndarjen e artikullit numër 36 **“Sonde blakemore Nr. 16, 20 në lot të veçantë të produktit”**, në një lot të veçantë dhe të pavarur, me qëllim shmangien e efektit monopolist që ky produkt ushtron mbi të gjithë lotin të procedurës së prokurimit objekt - ankimi,
- për modifikimin e specifikimit teknik dhe ndarjen në lot të veçantë të artikullit **nr.75 “Set Dekompresimi dhe Drenazhimi transanal për Ileus”** me arsyetimin se duhet të trajtohet si një lot më vete, i ndarë nga artikujt e tjerë të procedurës, me qëllim që të shmanget kombinimi i padrejtë i produkteve me treg dhe karakteristika të ndryshme, të rritet pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë të specializuar, të garantohet konkurrenca reale dhe efektive, të sigurohet përdorimi efikas i fondeve publike dhe të shmanget varësia nga një burim i vetëm furnizimi. Vetëm nëpërmjet rishikimit të specifikimeve teknike dhe ndarjes së këtij artikulli në një lot të veçantë mund të garantohet respektimi i parimeve të konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe transparencës, duke krijuar kushte të barabarta pjesëmarrjeje për të gjithë operatorët ekonomikë, Komisioni i Prokurimit publik gjykon se edhe për këtë artikull, situata ligjore dhe teknike është shumë e ngjashme me rastin e Sondës Blakemore, por specifikimet e këtij seti paraqesin elementë akoma më flagrantë të paracaktimit të produktit dhe kufizimit të konkurrencës.
- ndarja në lot më vete të artikujve **nr.158 MESH PVDF për inkontinences urinare dhe nr.159 MESH PVDF Hiatus** me arsyetimin se keto produkte identifikojnë praktikisht produkte të një prodhuesi të vetëm, furnizimi i tyre lidhet me një kanal të vetëm të autorizuar dhe mungesa e aksesit në këto produkte pengon pjesëmarrjen e

*operatorëve të tjerë ekonomikë. Nga verifikimet e kryera rezulton se prodhues të tjerë ndërkombëtarë ofrojnë produkte me funksion të ngjashëm klinik, të bazuara në materiale alternative si polypropylene apo materiale të tjera sintetike, të cilat përdoren për të njëjtat indikacione kirurgjikale. Megjithatë, edhe këto produkte në tregun shqiptar shpërndahen përmes distributorëve ekskluzivë, gjë që kufizon më tej mundësinë e sigurimit të tyre nga operatorë të tjerë ekonomikë.*

Komisioni vëren se:

III.6.8.1. Autoritetit Kontraktor me vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nuk e ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik duke argumentuar ndër të tjera se ..... “Sa i përket ndarjes në lote, referuar ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Konirrollin” i ndryshuar çdo përpjekje për ndarjen artificiale të një objekti funksionalisht të pandashëm është vetëm e paarsyeshme ekonomikisht dhe teknikisht. Prandaj, e vetmja rrugë e sigurt dhe e ligjshme është prokurimi si një i tërë i pandashëm, me përshkrim të bazuar në performancë dhe me garantimin e të gjitha parimeve të prokurimit publik të respektuara në mënyrë të plogfë. Ndarja në lot e një objekti të integruar teknikisht, për shkak të mungesës së kushtit themelor të “mundësisë për prokurim të veçantë”, do të çonte procedurën e prokurimit publik duke shkaktuar një deformim të tregut dhe duke ulur në mënyrë të ndjeshme aspektet e ofrimit për produkte të nevojshëm që nuk kanë interes. Gjithashtu, referuar edhe parimit të proporcionalitetit, ajo pengon ndarjen kur masa tejkalon qëllimin dhe kur ekzistojnë alternative më pak kufizuese. Detyrimi për sigurinë e plotë për materialet mjekësore (MDR 2017ZZ45) e bën ndarjen jo vetëm të paarsyeshme, por edhe juridikisht të rrezikshme. Opsioni i procedurës së vetme është i vetmi i ligjshëm dhe i qëndrueshëm që respekton të gjitha kërkesat ligjore dhe teknike.

Ne aspektin teknik vendosja e suksesshme e një tubi Sengstaken-Blakemore kërkon përgatitje të plotë dhe akses në pajisje specifike. Meqenëse procedura zakonisht kryhet në kushte urgjente, të kesh një komplet ose listë kontrolli të paramontuar mund të zvogëlojë vonesat dhe të përmirësojë sigurinë procedurale. Të gjitha materialet duhet të organizohen dhe testohen përpara futjes për të siguruar integritetin funksional, veçanërisht komponentët e balonës. AK vlerëson që prokurimi duhet të kryhet si një i tërë i pandashëm, me procedurë të vetme, duke garantuar përgjegjësi të unifikuar, siguri maksimale dhe përmbushje të plotë të detyrimeve ligjore. Blerja në paketë të vetme mundëson çmime më të ulëta për shkak të volumit të blerjes.

III.6.8.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.*

III.6.8.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.6.8.4. Neni 39 i ligjit nr.162/2020 Për prokurimin publik parashikohet shprehimisht se:

- 1. Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.*
- 2. Autoriteti ose enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa ose për të gjitha lotet. Edhe kur ofertat mund të dorëzohen për disa ose të gjitha lotet, autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, nëse numri maksimal i loteve për ofertues deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve sesa numri maksimal, autoriteti ose enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen.*
- 3. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti ose enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, pasi të kenë specifikuar në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.*

III.6.8.5. Neni 42 i VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet shprehimisht se: *1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve. 2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.*

III.6.8.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, KPP konstaton, se objekti i këtij prokurimi është blerja nga ana e autoritetit kontraktor materialeve mjekimi kirurgjikale. Autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të garantojë përdorimin me efikasitet të fondeve. Ndarja e procedurës në lote tepër të vogla ose atomizimi i saj (për çdo artikull specifik si Sonda Blakemore, Seti i Dekompresimit, apo Meshet) rrit kostot administrative, rrezikon dështimin e loteve të veçanta për mungesë ofertash dhe vështirëson menaxhimin e kontratave spitalore. Ligji parashikon se autoriteti kontraktor mund ta ndajë kontratën në lote, por kjo është një e drejtë dhe jo një detyrim absolut. Vendimi bazohet në fizibilitetin ekonomik dhe teknik. Nëse artikujt kirurgjikalë ose konsumatorë mjekësorë kanë natyrë të ngjashme funksionale (p.sh. pjesë e materialeve të mjekimit apo kirurgjisë), grupimi i tyre në një lot të vetëm është i ligjshëm. Ligji mbron konkurrencën e lirë, por nuk garanton që specifikimet teknike apo lotet duhet t’i përshtaten portofolit tregtar të një operatori ekonomik specifik Fakti që një operator nuk ka akses në një produkt nuk do të thotë se tregu është monopolist, por tregon kufizimet e vetë operatorit në marrëdhëniet tregtare me prodhuesit. Artikulli Nr. 36 (Sonde Blakemore Nr. 16, 20) dhe Nr. 75 (Set Dekompresimi transanal) janë produkte të cilat nuk përdoren të izoluara, por janë pjesë e urgjencave gastrointestinale dhe kolorekto-anale. Nga pikëpamja e menaxhimit spitalor, sigurimi i këtyre artikujve brenda të njëjtit lot garanton që ekipi mjekësor të ketë një paketë të plotë dhe të njëtrajtshme mjetesh për të njëjtën procedurë ndërhyrjeje (p.sh. ileus ose hemorragji nga varicet e ezofagut). Ndarja e tyre në lote të veçanta rrit rrezikun teknik që njëri spital të ketë setin e dekompresimit por të mos ketë sondat e duhura për shkak të vonësive nga distributorë të ndryshëm. Furnizimi nga i njëjti lot garanton vijueshmëri dhe përgjegjësi unike për dërgimin e mallit.) Pretendimi për Artikujt

Nr. 158 dhe Nr. 159 (MESH PVDF) se materiali PVDF identifikon një prodhues të vetëm rrëzohet nga vetë konstatimi i tregut: ekzistojnë alternativa sintetike si polypropylene me indikacion të plotë të ngjashëm klinik. Autoriteti Kontraktor specifikon nevojën bazuar në udhëzuesit klinikë të kirurgjisë urologjike/abdominale. Fakti që në tregun shqiptar këto materiale shpërndahen përmes distributorëve ekskluzivë është një dinamikë e lirë e tregut privat dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të prodhuesve. Autoriteti Kontraktor nuk mund të detyrohet të ndryshojë strategjinë e prokurimit (duke ndalur ose copëtuar lotet) vetëm për të rregulluar marrëdhëniet e brendshme tregtare midis distributorëve vendas. Konkurrenca garantohet në nivel ndërkombëtar të markave, ku çdo operator shqiptar ka të drejtë të kontrakttojë me prodhues të tjerë globalë që ofrojnë materiale ekuivalente.

### **Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron**

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës e paraqitur nga operatori ekonomik “SoLed” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE për secilin lot), Mallra”, me nr. REF-89789-06-11-2026, me objekt: “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme dhe kirurgjikale për nevoja spitalore” e ndarë në dy lote”, me fond limit 2,723,256,110.67 (dy miliardë e shtatëqind e njëzet e tre milionë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dhjetë presje gjashtëdhjetë e shtatë lekë) lekë pa tvsh lekë pa TVSH ose 28,650,774.44 (njëzet e tetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër presje dyzet e katër) euro pa TVSH, “LOT 2 - Blerje materiale mjekimi konsumi kirurgjikale MM2”, me nr. REF-89793-06-11-2026 me fond limit 1,316,642,915.80 (një miliardë e treqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë nëntëqind e pesëmbëdhjetë presje tetëdhjetë lekë) lekë pa tvsh ose 13,852,108.53 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetë presje pesëdhjetë e tre) euro pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar në datën 13.07.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “SoLed” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE për secilin lot), Mallra”, me nr. REF-89789-06-11-2026, me objekt: “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme dhe kirurgjikale për nevoja spitalore” e ndarë në dy lote”, me fond limit 2,723,256,110.67 (dy miliardë e shtatëqind e njëzet e tre milionë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dhjetë presje gjashtëdhjetë e shtatë lekë) lekë pa tvsh ose 28,650,774.44 (njëzet e tetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër presje dyzet e katër) euro pa TVSH, “LOT 2 - Blerje materiale mjekimi konsumi kirurgjikale MM2”, me nr. REF-89793-06-11-2026 me fond limit 1,316,642,915.80 (një miliardë e treqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë nëntëqind e pesëmbëdhjetë presje tetëdhjetë lekë) lekë pa tvsh ose 13,852,108.53 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetë presje pesëdhjetë e tre) euro pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar në datën 13.07.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a..
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rishpalljen e saj të ketë parasysh modifikimin e dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “SoLed” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
7. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**  
**Nertil Kanina**

**Anëtar**  
**Edvin Simo**

**Kryetar**  
**Ismail Shehu**